

Nuk ndalen skandalet e Belinda Ballukut, zbardhet skema si u zhvatën 130 milionë euro në Ministrinë e Energjisë, ja si fondet devijoheshin për t'u shpallur humbje në rrjet



Faqe 6

Argita Maltezi merr komandën dhe i lëshon ultimatumin grupit të Gazment Bardhit të veshin bluzën me sloganin “Lironi Berishën”, ditë të zeza për renegatët e Lulzim Bashës, kush nuk i bindet urdhrit nuk bëhet deputet

Faqe 5



Kreshnik Spahiu nxjerr prapaskenat “bombë”: Ja emri që do të vendosë Sali Berisha në krye të Partisë Demokratike dhe si amerikanët ia dogjën planin ‘B’ që në vitin 2021

Faqe 3

Myslim Murrizi zbardh të fshehtat tronditëse brenda PD, ja pazari që po bëhet me PS poshtë tavolinës për zgjedhjet e 2025 dhe pse jam kundër idesë së Sali Berishës për qeveri teknike

Faqe 2

Ish-kryeministri Viktor Ponta zberthen prapaskenat e rekrutimit të spiunit rumun si këshilltar nga kryeministri Edi Rama, ja e vërteta përfshirjes në trafik drogë me kartelin meksikan “Sinaloa”

Faqe 4

Ja çfarë do të ndodhë pas 1 korrikut me rritjen e pagave dhe pensioneve, ekspertja e njohur e ekonomisë jep informacionet e fundit, zbulohen kategoritë që përfitojnë

Faqe 9

Bosnja dhe Hercegovina në alarm, Rusia ka hyrë shumë thellë në Ballkan, si Dodik ka ndryshuar plotësisht pas një udhëtimi, zbulohet çfarë ndodhi në takimin e tij me Putinin

Faqe 10

Presidenti Bajram Begaj dhe kupola e bazës detare të implikuar në skandalin e aferave me pronat publike kanë pranuar jashtë kamerave se SPAK ka gjetur “gjilpërën në kashtë”, ja si oligarkët japin gradat në ushtri, Artur Meçollari plas skandalet e rënda

Faqe 7

Vetë firmosnin e vetë vulosnin, ja si Arqile Bollano i mori tokën një mësuesi në Himarë, zbardhen të tjera detaje nga dosja e SPAK dhe skema si abuzuan me ligjin me ish-kryebashkiakun Jorgo Goro

Faqe 8

Nikolin Gurakuqi: Opera moderne “Zëri njerëzor” e kompozitorit francez Francis Poulenc, që e solla në skenë për Ditën e Muzikës

Faqe 18

KOMENT & ANALIZË

Faqe 15-17

Nga Pandeli BARDHI

Ky sistem, një “Shpellë” e kohës së antikitetit

Nga Bardhyl BEJKO

Referendum kryeministor pas referendumit zgjedhor?!

Nga Qamil GJYREZI

Demokratët euroatlantikë një realitet i ri për Shqipërinë

RAJON & BOTË

Dështon sërish Macron, e djathta ekstreme “mbretëron” në Francë, sondazhet favorizojnë Le Pen, shpresa e fundit e presidentit është 7 korriku, ja truku i socialistëve për të sabotuar fitoren e RN

Faqe 13

Demokratët në panik, Joe Biden mund të largohet në fund të verës, pse tërheqja e tij do të shkaktonte kaos në SHBA, ja kush do të përballej me Trump nëse presidenti heq dorë nga gara

Faqe 12

Rusia nuk do ta përballonte dot aktivizimin e nenit 5, lufta e drejtpërdrejtë me NATO-n do të ishte katastrofike, ja si Moskë po përdor agentët e spiunazhit dhe sulmet hibride për të zhytur Evropën në kaos

Faqe 11

politikë

Murrizi: Vota e diasporës duhet të jetë kalë beteje i opozitës dhe nuk di pse stonon qëndrimi i fortë

Myslim Murrizi zbardh të fshehtat tronditëse brenda PD, ja pazari që po bëhet me PS poshtë tavolinës për zgjedhjet e 2025 dhe pse jam kundër idesë së Sali Berishës për qeveri teknike

Rigels SELIMAN

Ish-deputeti i PD, Myslim Murrizi ka nxjerrë disa detaje tronditëse brenda Partisë Demokratike. Në një intervistë televizive në emisionin "Top Talk" në "Top Channel", zoti Murrizi ka thënë se opozita ka për detyrë të denoncojë publikisht aferat e qeverisë dhe pastaj t'i marrë e t'i bëjë dosje e t'i çojë te SPAK-u. Sipas tij ata flasin me Damian Gjijnurin poshtë tavolinës dhe në kamera dalin e thonë ndryshe për të ruajtur statusin që i tremben votës së emigrantëve, që nuk duan lista të hapura, që nuk luftojnë që të ketë vlerë të barabartë për mandat. Ai e quan gjithë këtë situatë hipokrizi. Murrizi nuk është dakord edhe për protestat që organizon PD.



-Pse e kërkojnë?

Sepse duan të ruajnë një status quo një grusht vemjesh që kërkojnë të vijin në Kuvend pa votë. Vota e diasporës duhet të jetë kalë beteje i opozitës dhe nuk di pse stonon qëndrimi i fortë, i qartë, i opozitës për votën e diasporës. Unë nuk besoj që shpirtërisht ndoshta e kanë qef të gjitha palët votën e diasporës për një arsye se diasporën nuk mund ta blesh, nuk mund ta intimidosh dhe nuk mund ta mashtrosh as me lekë dhe as për një vend pune. Diaspora është rebele jo vetëm te ne por në çdo vend të botës pasi shih jo traun por qimen te qeveria. Diaspora është votë ndëshkuese.

-Qeveri teknike po kërkon opozita dhe madje këtë kërkesë e ka përfshirë bashkë me votën e diasporës të projekt rezoluta që përfshin edhe bashkimin e opozitës. Vlen qeveria teknike, a shmang manipulimin e votave një qeveri teknike, tre mujore për mbajtjen e zgjedhjeve?

Jo!

-Po për çfarë po kërkohet atëherë?

Shqipëria ka prodhuar 3-4 qeveri të tilla nga halli. Unë jam kundër qeverive teknike, pasi ne Shqipëri nuk ka njerëz teknik, por jemi në gen të politizuar. Ne nuk kemi teknikien, pasi realisht nuk kemi shoqëri civile, ajo është e helmuar qëkur blihen me paratë e ambasadave qoftë Holandeze, qoftë Amerikane, etj... qëkur krijohen në gen.

-Data 11 korrik do të sjellë protestën kombëtare të Partisë Demokratike. A vlen më të kërkohet bashkimi?

Bashkimi ndodh në mënyrë natyrale, nëse ndjehet shpirtërisht që janë opozitar me qeverinë. Nuk mund të ndodh me lutje, lëshime postesh të padëshiruara, ndryshe jep efekt të kundërt sepse ofendohen dhe përçmohen ata të cilët të kanë qëndruar apo militantët apo stoikët e besnikët tuaj, flas të linjës, pse ti dorëlëshuarin e kut, e çfarë po jep? Po jep aksionet e këtyre që të kanë qëndruar. Çfarë po vuan sot kjo opozitë? Dorë lëshimin dhe dhënien në mënyrë të pamerituar të aksioneve të shumë demokratëve, të cilët i qëndruan opozitës më të egër, 1997-2005 dhe pushteti i 2005-ës u doradavit te Luli, te Beneti, te Majlinda, te Grida, te Andi, e

me radhë. Te këto që nuk i sheh gjëkund më që aty. E pse duhet të bëhet një eksperiment i tillë. Unë jam kundër dhe si unë e shumë të tjerë të cilët duhet të mbajnë 34 vjet çizmet në qafë për të mbjellur aksionet e mia dhe t'ja japin Lulzim Bashës. Basha tha se ma besoi mua partinë se pa që isha shumë i epur për të bërë beteja për vatanin, për Shqipërinë. Ça beteja, ku qe beteja e këtij, te Rruga e Kombit që ia mbylli Ben Kraja se e çoi me vonesë, Beni i SPAK-ut. Nuk flet PD-ja për këtë pjesë. Ky ishte jashtë dhe i hypte balonës ditën që kishte gjyqin. Vetëm për këtë Ben Kraja nuk duhet të kalonte vettingun. Që nuk pati kohë të mjaftueshme, siç e thotë Kodi i Procedurës Penale e për të çuar dosjen për Bashën në Gjykatë të Lartë, pasi e çoi jashtë afatit. Ça beteje ka bërë ky, te ministria e Brendshme, që as e mori vesh njeri ku dhe sot ta shposh në hundë, në njoftë një drejtor policie nga 12 që ka gjithsej Shqipëria. Ça beteje bëri Majlinda Bregu, ca beteje bëri Benet Beci 8 vjet me PD e 8 vjet me PS, 14 vite te Fondi Shqiptar i Zhvillimit e 2 vite te KESH-i. E provoi për mandat deputeti, e pa se nuk kishte tendera, e shkoi atje ku ka tendera, te Bashkia. Kujt do t'i lutet më kjo opozitë që thotë hajdeni te ne? Kujt? PS? Nuk vjen PS-ja te ti. Kujt? Hysni Milloshiti, i cili ta vdek. Kujt do t'i lutet? Komunistave të rinj, Arlind Qorri, nuk vjen te ti.

-Protesta e 11 korrikut, pse bëhen protesta konstante çdo javë te Bashkia e Tiranës dhe nuk bëhen protesta Kombëtare, por bëhen rrallë e tek...

Këtë e kam kërkuar në

një mbledhje që u bë me përfaqësuesit. Unë nuk i quaj protesta me thënë të drejtën, se nëse vjen dhe bëhet me regji, e bën listën Flamuri, Albana apo Laeri e flet ajo vajza për Himarën, flet një nga të rinjtë që do t'i atashohet PD-së. Kjo është një far tubimi. Protesta ka tjetër sens dhe qytetarëve të vjedhur, të dhunuar, të detyruar që të lënë këtë vend nga kjo qeveri dhe kështu duhet të jetë edhe nesër kur të jetë PD-ja në pushtet. Protestë bëjnë francezët kur i vënë flakën Parisit, bëjnë grekët kur djegin Athinën, bëjnë gjermanët kur bllokojnë apo italianët e rumunët. Protestë me banderola e muzikë e pastaj me rregji e ca pagonishte pas himnit e pastaj fjalën e ka Hasani e pastaj Hyseni. Kjo nuk është protestë, unë kërkova në fjalën time në mbështetje dhe në solidaritet me arrestimin e padrejtë të Berishës, kërkova 20 shkurtin. U bë ai 20 shkurti por nuk ishte protestë por ishte tubim. Tani opozita nuk ka mision tjetër përveçse të thërrasë në tubime mbështetësit e saj më së pari, për të parë veten se ku është. Dhe ky është mision i vështirë i të qenurit opozitë. Te denoncojë publikisht aferat e qeverisë dhe pastaj t'i marrë e t'i bëjë dosje e t'i çojë te SPAK-u. Nëse këto kanë mision që duhet të flasin me Damian Gjijnurin poshtë tavolinës dhe dalin e thonë ndryshe para kamerave për të ruajtur statusin që i tremben votës së emigrantëve, që nuk duan lista të hapura, që nuk luftojnë që të ketë vlerë të barabartë për mandat, atëherë kjo është hipokrizi.

Berisha: 11 korriku fton shqiptarët të fillojmë betejen e madhe, betejen e përmbysjes së narkoshtetit

Kryetari i Partisë Demokratike, Sali Berisha u ka bërë ftesë qytetarëve që të bashkohen në protestën e 11 korrikut. "Miq, këta nuk janë njerëz. Të gjitha këto janë të denoncuara nga KLSH. Por ato të gjitha janë hedhur në koshat e plehrave nga mafiozë, nga aksionerë kryesorë të Bursës së Vdekjes së shqiptarëve. Edi Rama, Ilir Beqaj, Ogerta Manastirliu. Miqtë e mi, shpresa e vetme

jeni ju. Shpresa e vetme janë qytetarët. Në një vend ku nuk ka drejtësi, vepron revolta, vepron zemërimi. Në një vend ku vidhet mbi jetën e njerëzve, ku vidhet ushqimi i fëmijëve, ilaçet e të sëmurëve nga qeveritarët, revoltë, revoltë dhe vetëm revoltë është zgjidhja. Ndaj dhe 11 korriku fton shqiptarët të fillojmë betejen e madhe, betejen e fitores. Betejen e përmbysjes së narkoshtetit. Qeverisë teknike,

zgjedhjeve të lira. Miqtë e mi, edhe njëherë këto zhvillime dramatike, këto të dhëna dramatike, duhet të jenë frymëzim për çdo shqiptar për t'u ngritur me guximin e tij dhe bërë drejtësinë ndaj këtyre kriminelëve që nuk kanë ligj, nuk kanë moral, nuk kanë mëshirë dhe nuk kanë asnjë të drejtë të qeverisin më tej", deklaroi Berisha këtë fundjavë gjatë fjalës në tubimin qytetar.

Analisti: Pritshmëria nga SPAK-u është shumë e lartë

Kreshnik Spahiu nxjerr prapaskenat “bombë”: Ja emri që do të vendosë Sali Berisha në krye të Partisë Demokratike dhe si amerikanët ia dogjën planin ‘B’ që në vitin 2021

Rigels SELIMAN

Analisti i njohur, Kreshnik Spahiu ka komentuar zhvillimet e fundit politike. Në një reagim për gazetën “SOT”, zoti Spahiu theksoi se amerikanët i kanë menduar me themel planet për të nxjerrë nga sistemi ish-kryeministrin Sali Berisha. Sipas tij, shpallja e Argita Berishës “non-grata” në vitin 2021 dogji planin “B” të Sali Berishës për t’ia kaluar partinë vajzës së tij. Nga ana tjetër, Kreshnik Spahiu ka bërë një deklaratë të fortë, ku shprehet se Edi Ramës i intereson që të ketë Berishën kryetar të PD, ose Argitën. Sipas tij, Rama i ka dhënë vulën ose i ka shkelur syrin për t’i dhënë vulën se i intereson që të ketë një Berishë i cili sipas të gjitha ngjarjeve që do të ndodhin nuk do të jetë deputet i Parlamentit të ardhshëm të Shqipërisë dhe po përgatit që kjo parti t’i trashëgohet vajzës. Gjithashtu analisti Kreshnik Spahiu ka folur edhe për sulmet e opozitës ndaj Prokurorisë së Posaçme. Sipas tij, të ishe në një vend tjetër dhe të dilje të akuzoje për organizatë speciale dhe bandë kriminale SPAK-un, do përfundojë shumë keq. Më poshtë po pasqyrojmë reagimin e zotit Spahiu.

Situata brenda PD

Unë kam një qëndrim definitiv që Lulzim Basha duhet të krijojë



një forcë të re politike, të mati forcat me eksperiencën, grupimin, deputetët, si një formacion i ri. Kjo është një lojë më e ndershme, më e barabartë dhe i heq çdo lloj alibie Berishës kur të humbasë zgjedhjet në 2025-ën të mos ketë mundësinë që të thotë humba, por më kishin vjedhur vulën, selinë, buxhetin e partinë. Sali Berisha e ka sot PD, logon, ka atë parti që e mori me 1200 mijë votues dhe nëse humbet në 2025-ën, nuk ka më asnjë lloj justifikimi që të thotë se shteti e çau PD. Është e qartë që qeveria ka interes të ketë një opozitë të përcarë, ashtu siç është e qartë që Sali Berisha nuk do e kishte marrë vulën pa vullnetin politik të qeverisë. E them këtë se vetë Berisha thotë se këto janë gjykatat e korruptuara të Edi Ramës, vetë Berisha thotë që këto janë organ-

izatat kriminale të Edi Ramës. Pyetja është se këto bandat e Edi Ramës, pse ia dhanë vulën Sali Berishës? Dikush mund të thotë që i takonte, por pse gjykata Britanike nuk ia jep të drejtën Berishës, pse gjykata e Parisit nuk ia jep të drejtën Berishës, pse gjykata e Uashingtonit nuk ia jep për Gërdecin të drejtën familjes Berisha? Pse Berisha fiton vetëm në Gjykata e Edi Ramës e humbet në Francë, Britani, Amerikë e çdo vend të botës. Ai ka mundësi që u korruptoka Apeli i Anglisë dhe nuk u korruptoka Apeli i Shqipërisë. A ka mundësi të dali një demokrat dhe të na e thotë? Dhe kjo ka vetëm një përgjigje se në qoftë se kjo është e vërtetë, Edi Rama atëherë i ka dhënë vulën ose i ka shkelur syrin për t’i dhënë vulën se i intereson që të ketë

një Berishë i cili sipas të gjitha ngjarjeve që do të ndodhin, nuk do të jetë deputet i Parlamentit të ardhshëm të Shqipërisë dhe po përgatit që kjo parti t’i trashëgohet vajzës. Edi Rama ka interes shumë të madh që përballë të ketë një person ‘non-grata’, qoftë babain a qoftë të bijën. Duke patur të bijën e të atit lidere të opozitës, Edi Rama ndjehet shumë i favorizuar. Sipas llogarive të tij, Edi Rama ka përballë një person i cili është shpallur ‘non-grata’ nga SHBA dhe Britania e Madhe. Siç ju e dini, vetëm vajza e Putinit dhe e Berishës janë shpallur ‘non-grata’ dhe nuk mund të jetë lapsus se SHBA nuk bëjnë të tilla lapsuse në problemet familjare, të hyjnë në tre breza por e kanë bërë qëllimisht për të djegur planin B të Berishës. Sa i shpallën familjen ‘non-grata’, praktikisht përpara se të shpallnin atë sepse nuk donin të hapej praktika që Iliri ia lë gruan partisë, ky ia lë vajzën dhe del i marrjes peng i demokracisë dhe prandaj justifikuan se ka marrë peng shtetin demokratik me familjen e tij. Çfarë ndodh këtu? Partia Demokratike, përmbysi komunizmin dhe ishte një aset

që Amerika investoi në të, Britania, BE kanë kontribut ndaj saj. Nuk mundësh ta marrësh dhe ta kthesh në një biznes familjar sepse ti pengon zhvillimin e një partneri strategjik siç është Shqipëria dhe krijon probleme në rajon nëpërmjet ndikimeve që ka spionazhi rus në vendin tonë”, deklaroi ai.

Sulmet e opozitës ndaj SPAK

Pritshmëria nga SPAK-u është shumë e lartë dhe kjo është sfida që ka sepse kur pritshmëria e publikut është shumë e lartë,

rezikon o të hysh në

histori për sukses

ose të dështosh

shumë rëndë

nëse nuk jep

rezultat për ato

çështje. Ata të

cilët pretendo-

jnë që SPAK-u

është i njëan-

shëm dhe po

ngarkon opozitën

më shumë, do i thoja

se deri sot në qershor

2024 nuk rezulton asnjë dosje

penale që Prokuroria Speciale të

ketë dërguar për gjykim ndaj një

subjekti i cili është i përfshirë në

opozitën shqiptare. Opozita po i

bën një presion të jashtëzakon-

shëm SPAK-ut. Të ishe në një

vend tjetër dhe të dilje të akuzoje

për organizatë speciale dhe bandë

kriminale SPAK-un, do përfundojë

shumë keq.

“Edi Rama ka interes shumë të madh që përballë të ketë një person ‘non-grata’, qoftë babain a qoftë të bijën. Duke patur të bijën e të atit lidere të opozitës, Edi Rama ndjehet shumë i favorizuar. Sipas llogarive të tij, Edi Rama ka përballë një person i cili është shpallur ‘non-grata’ nga SHBA dhe Britania e Madhe...”

Ardhja e ambasadorit të ri të SHBA, Kreshnik Spahiu: Berishës e Metës do iu duket lule Yuri Kim

Të gjithëve na ka mbetur në mendje emri i ish ambasadores amerikane në Tiranë, Yuri Kim. Do të jetë e vështirë të harrohet jo vetëm si emër, por më shumë për rezistencën e tejskajshme të një gruaje ndaj përbaltjes më të egër të organizuar ndonjëherë ndaj një diplomati të huaj në Republikën e Shqipërisë. Një organizim perfekt e në bateri baltë hedhësish që kalonin me një sinkronizim harmonik sa nga politikanët të opozitës se Berishës, te mediat pranë tij, te analistët me një eksperiencë edhe të gjatë në median e shkruar dhe televizive. Është interesante të mësohet tani, ndërkohë që ambasadorja Yuri Kim është në Uashington DC, se si e përjetoi në të vërtetë atë “egërsi” tipike. Albanologu i mirënjohur kanadez Robert Elsie (sot prehet në Theth), për

gazetaren Rudina Xhunga, pas pyetjes së saj se përse nuk jetoi asnjëherë në Shqipëri, u përgjigj: Sepse unë jam shumë i brishtë dhe ju jeni shumë të egër! Ju dini të mbroheni, por unë këtu jam si një lepur... Pra, ne dimë të jemi tepër të egër me ata shqiptarë, por sidomos me ata të huaj, që “nuk na shkojnë pas midesë”. Dhe ambasadorja Yuri Kim përkoi në Tiranë në një kohë që Shtetet e Bashkuara shpallën “non grata” më të egrin e të egërve në lëmin e mendimit ndryshe, në atë pikë që ai nuk di se ç’është mendimi ndryshe, nuk e ka idenë se ç’do të thotë Demokraci. Por Yuri Kim me siguri sot e ka një përgjigje për baltën e koordinuar të atyre muajve: Nuk më keni prekur as edhe një grimcë! Jeni asgjë para misionit dhe përkushtimit tim.

Yuri Kim, si e huaj, tregoi se nuk ishte aspak “lepur”. Dhe kjo politikë e aleatëve tanë më të ngushtë e bëri diferencën dhe vazhdon ta bëjë këtë diferencë edhe tani në Shqipëri, edhe pse disa bëjnë sikur nuk e kuptojnë. Report TV” në një intervistë me ish zv/kreun e KLD-së, Kreshnik Spahiu, e pyeti atë për rolin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Ruisë dhe Bashkimit Europian në Shqipëri, duke qenë Spahiu i angazhuar gjatë karrierës së tij dhe me organizata të rëndësishme ndërkombëtare që kanë vepruar në Shqipëri. Pra si është sot marrëdhënia jonë me këta të huaj dhe shtetet që përfaqësojnë tek ne. “SHBA është garanti i sovranitetit, pavarësisë dhe paqes ne shume vende të botës. Pa SHBA nuk do kishte shtet Kosovar. Pa SHBA nuk do kishte Ukraine.

Pa SHBA nuk do ekzistonit shume shtete. Pa SHBA edhe BE do ishte e pasigurt. Kombe të vegjël apo shtete të dobëta si Shqipëria e kanë sovranitetin dhe paqen e kushtëzuar nga partnerët strategjikë. Pa SHBA, Shqipëria do rrëshqiste në luftë civile në 1997. Ky fakt është i pamohueshëm. Shqiptarët janë kombi më pro amerikan në botë dhe Amerika është shteti më pro shqiptar në Ballkan. Ekzistenca jonë varet nga Amerika. Më gjeni një popull në botë që Amerika t’i njohë si dy shtete me një popullsi të vogël 5 milionë banorë të dyja si Shqipëri-Kosovë? Kjo ka ndodhur vetëm se Amerika kërkon fuqizimin e shqiptarëve. Në planetin tonë ka kombe me 100 milionë banorë që s’ju njihet as e drejta shtet-formuese dhe as autonomia lokale, dhe Amerika

nuk i përkrah. Duhet të kuptojmë që SHBA na ka privilegjuar në raport me të tjerët. Korriku do jetë një kapitull i ri. Ardhja e ambasadorit të ri amerikan David J. Kostelancik do hapë një fazë të re. Ai është nivel i lartë përfaqësimi dhe ka lidhje të forta me Shqipërinë. Ardhja e tij është mision historik për ndërrimin e elitave politike në Shqipëri, thyerjen e establishmentit vjetër, ndëshkimin e zyrtarëve të lartë dhe mbështetjen e elitave të reja politike. Ata që janë gëzuar kur u largua Yuri Kim, do bëhen shumë pishman kur të përballen me David J. Kostelancik. Pas disa muajve Berishës dhe Metës do ju duket lule Yuri Kim duke krahasuar me rolin aktiv dhe pa kompromis që do ketë David J. Kostelancik”, deklaroi ndër të tjera Spahiu.

politikë

Viktor Ponta: Të gjithë e dinin se Coldea ishte këshilltar i Edi Ramës

Ish-kryeministri Viktor Ponta zbërthen prapaskenat e rekrutimit të spiunit rumun si këshilltar nga kryeministri Edi Rama, ja e vërteta përfshirjes në trafik drogë me kartelin meksikan "Sinaloa"

Rigels SELIMAN

Ish-kryeministri rumun, Viktor Ponta ka komentuar skandalin ku është i përfshirë gjenerali i shërbimit sekret të Rumanisë, Florian Coldea. Ky i fundit, po ashtu këshilltar i kryeministrit Edi Rama, rezultoi se ishte i përfshirë në trafik drogë me kartelin Sinaloa. Gjatë intervistës për "RealitateaPLUS", Ponta u shpreh se ai e dinte që Florian Coldea kishte lidhje me Edi Ramën. Ish-kryeministri rumun theksoi se Ramën nuk e shqetëson se çfarë ndodh me hetimet për Coldean në Rumani, kjo sepse sipas tij kryeministri i Shqipërisë ka lidhje të forta në rrafshin ndërkombëtar, veçanërisht në Amerikë. "Nuk e di pse Rama kishte nevojë për këshilltarin Coldea. Por jam absolutisht i bindur se të gjithë në Rumani e dinin që ai ishte këshilltar i Edi Ramës. E dija dhe unë dhe ja kam konfirmuar kush më ka pyetur. Ju mendoni se Coldea mund të shkonte në Shqipëri si këshilltar pa u miratuar nga Presidenti i Akademisë", deklaroi ai ndër të tjera, duke aluduar se emërimi i tij si këshilltar është miratuar nga shërbimet sekrete rumune. Prej javësh historia Gjeneralit Florian Coldea është kryefjale lajmeve në Rumani, pasi nga hetimet ka rezultuar se ishte pjesë e një rrjeti që merrej me shpërndarjen e kokainës nga Amerika Latine në Shqipëri e më pas në Rumani. Mediat rumune më shumë se dy javë më parë, raportuan se emri



i Coldeas është shfaqur edhe në median shqiptare përpara disa vitesh. Coldea dyshohet se është përfshirë në një rrjet të trafikut të kokainës direkt nga karteli i frikshëm i Sinaloas meksikane. Sipas gazetës rumune, EVZ, gjenerali rumun ishte rekrutuar në këtë rrjet nga Dorian Duçka. Ndërmjetësja e kësaj historie të frikshme trafiku ishte e dashura e gjeneralit, e quajtur Marina Pandarof. Gazeta ka publikuar edhe një foto ku shfaqet gjenerali

së bashku me Dorian Duçkën dhe të dashurën e tij, të cilën mediat e etiketojnë si "biondja fatale".

Kush është në realitet Coldea?

Ndërkohë kujtojmë se Mihail Florian Coldea është një gjeneral rumun, i cili shërbeu si zëvendësudrejtor i Shërbimit të Inteligjencës Rumune. Nga 20 korriku deri më 4 tetor 2006, ai ishte kreu i përkohshëm i Shërbimit Informativ Rumun, nga dorëheqja e Alexandru

Radu Timofte nga kjo detyrë deri në emërimin e George Maior. Gjatë mandatit të George Maior, ai ishte zëvendësi i tij i parë. Pas mbarimit të fakultetit, ai punoi në Inspektoratin për Parandalimin dhe Luftimin e Terrorizmit në Shërbimin Informativ Rumun, duke mbajtur një sërë postesh drejtuese. Në periudhën 1996-2005 ka marrë pjesë në një sërë misionesh, aksionesh dhe operacionesh komplekse të kryera në një profil antiterrorist në bashkëpunim me partnerë të huaj të SRI. Më 27 korrik 2005, Florian Coldea u ngrit në gradën e nënkolonelit dhe u emërua me dekret të Presidentit të Rumanisë në pozicionin e zëvendësudrejtorit të parë të Shërbimit Informativ Rumun (dhe zëvendësues ligjor i drejtorit), me gradën i sekretarit të shtetit, duke filluar nga 1 gusht 2005. U gradua në gradën kolonel më 24 mars 2006. Ndërmjet 20 korrikut dhe 4 tetorit 2006, ai shërbeu si drejtor i përkohshëm i Shërbimit Informativ Rumun, pas dorëheqjes së Alexandru Radu Timofte nga kjo detyrë. Aktualisht po hetohet nga Drejtoria Kombëtare e Antikorrupsionit në Rumani për korrupsion. Kryeministri Edi Rama pa asnjë transparencë ka emëruar si këshilltar të jashtëm. Coldea është referuar si drejtuesi i një linje trafiku ndërkombëtar të kokainës, që transportohej nga Meksika në Shqipëri dhe më pas nga Shqipëria në Rumani.

Reagon Rama

Nga ana tjetër, në përgjigjen për BIRN, kryeministria i mohoi dhe i ironizoi akuzat për lidhjet e Coldea me kartelet të trafikut të narkotikëve. "Po ne jemi mësuar me këto estrada dhe s'kemi asnjë lloj shqetësimi për budallallëqet që lidhin rolin e zotit Coldea si këshilltar i jashtëm me telenovelën meksikane të kanalit të ujrave të zeza politike e mediatike të Tiranës që është derdhur së fundmi edhe në gotën mediatike rumune", thuhet në reagim. Ndërkaq sipas Agjencisë Kombëtare të Shtypit në Rumani Agerpress, kryeministri aktual Marcel Ciolacu, u shpreh i shqetësuar që Coldea pas punës në shërbimin e inteligjencës Rumune, kishte punuar si konsulent për të tretë. Kryeministri i Rumanisë, citohet të ketë premtuar ndryshime ligjore, për të ndaluar situata të ngjashme. Nga ana e saj MIA nuk iu përgjigj pyetjes së BIRN nëse kjo përbënte shqetësim për sigurinë e vendit. Në përgjigje theksohet se Coldea kishte punuar si konsulent për disa qeveri dhe lavdërohet si një "faktor kyç për kalimin e SRI-së nga Shërbimi Sekret Komunist në një nga shërbimet më prestigjioze të inteligjencës në Europën Lindore dhe NATO". Sakaq kryetari i grupit parlamentar të PD-së, Gazment Bardhi, njoftoi deputetët e opozitës në Kuvend do të kërkojnë përgjigje nga kryeministri i vendit Edi Rama se përse e ka punësuar si këshilltar të jashtëm, ish-agentin e shërbimeve sekrete rumune, Florian Coldea-n, i cili ka rezultuar me lidhje të forta me trafikun ndërkombëtar të drogës.

Kryeministri Rama premton dhënien fund të problematikës me tapitë dhe paralajmëron faljen e gjobave për ndërtimet pa leje

Pritjes i erdhi fundi dhe të paktën 200 familje në Theth tashmë kanë marrë dje certifikatat e tyre të pronësisë. I pranishëm nw takim ku u shpërndanw certifikatat, kryeministri Edi Rama premtoi se problematikës me tapitë në veri do t'i jepet fund njëherë e mirë. Ndërkohë, kreu i qeverisë lajmëroi se do të falen të gjitha gjobat që janë vendosur për ndërtime pa leje, duke thënë se nuk kanë qenë abuzive, por për shkak të shtrëngimit që ka ligji duke qenë se Thethi futet në zonën e mbrojtur. Shigjetime pati edhe për demokratët që kanë drejtuar historikisht Shkodrën, duke thënë se në kohën e tyre vëmendja e bashkisë për Thethin ka qenë zero. "Ka një masë shumë të madhe gjobash si rezultat i

ndërhyrjeve apo ndërtimeve aty ku keni pasur shtëpinë e vjetër apo truallin tuaj, që janë bërë për shkak të nevojës për të krijuar ekonomi përmes turizmit. Dhe që nuk janë ndërtuar sipas ligjit sepse shtrëngimi i legjislacionit për këtë zonë që figuron si zonë e mbrojtur natyrore e ka bërë të pamundur, qeveria do t'i falë gjithë gjobat. Nuk janë tipikisht ndërtime të bëra abuzivisht për t'iu shmangur ligjit, janë ndërtime të bëra nga nevoja. Në kushtet e pamundësisë ligjore, njerëzit kanë vazhduar t'i bëjnë. Kjo s'është thotë që kush do vërë një gru pa leje më tutje do tolerohet, kjo do të thotë që në atë fazë kur kjo ka ndodhur s'ka pasur vëmendje nga bashkia, zero", deklaroi dje Rama. Tashmë që

çështja e pronave po shkon drejt zgjidhjes, kreu i qeverisë i bëri thirrje emigrantëve që të kthehen dhe të investojnë në Theth. Për të ndihmuar guximtarët në investime, Rama tha se qeveria ka gati edhe planin. Gjatë ndalesës në Theth, Rama ironizoi opozitën duke thënë se ajo merret me sherrret, ndërsa punët i bën qeveria. "Atyre të PD u ka rënë sakica në mjaltë. Se për punë kanë sherrin, kurse punët e tyre i bëjmë ne", theksoi Rama. Për t'i shërbyer edhe turizmit, që në zonat e veriut e veçanërisht në Theth po përjeton rritje të shpejtë përgjatë viteve të fundit, qeveria ka përgatitur edhe një plan investimi për të përmirësuar infrastrukturën dhe Rama thotë se edhe fondit është gati.

Kur mund t'u ndalojë policia, ndryshimet në ligj përcaktojnë rregullat e reja për kontrollat

Ligji për kontrollat e policisë së shtetit ndaj personave që dyshohen se kanë shkelur kodin penal pritet që të ndryshojnë. Projektligji i depozituar në Parlamentin e Shqipërisë përcakton rastet dhe kushtet në të cilat një person duhet ndaluar apo kontrolluar nga efektivet e Policisë së Shtetit. Neni 18 parashikon se nëse një person dyshohet për përfshirje në ngjarje kriminale, gjendet në një zonë të ndaluar apo të rrethuar nga policia apo nëse akuzohet për shkelje administrative, efektiveve i jepet e drejta që të kontrollojë identitetin e personit. Gjithashtu në rast se një person i dyshuar nuk mban mjet identifikimi apo lëviz me identitet të rremë, uniformave blu i jepet e drejta të

publikojë pamje të personit për të mundësuar identitetin e tij me anë të personave të tjerë. Ndërkohë në projektligjin e ri neni 19 parashikon dhe rregullat e ndalimit të një personi. Një person ndalohet përkohësisht kur ka identitet të rremë, por jo në rastet kur ka pamundësi shëndetësore apo është me aftësi të kufizuara. Gjithashtu një ndalim i përkohshëm ka një afat kohor prej 5 orësh deri në sqarimin e çështjes. Ndërsa rastet kur dyshohet për ngjarje kriminale, akuzat për shkelje administrative, rastet e akteve të terrorizimit apo edhe armëmbajtjet pa leje i japin të drejtën policisë që të ndalojë personin me një afat kohor më të gjatë deri në sqarimin e çështjes.

Thellohet sherri brenda PD

Argita Malltezi merr komandën dhe i lëshon ultimatumin grupit të Gazment Bardhit të veshin bluzën me sloganin “Lironi Berishën”, ditë të zeza për renegatët e Lulzim Bashës, kush nuk i bindet urdhrin nuk bëhet deputet

Rigels SELIMAN

Tashmë është e qartë se Argita Malltezi është trashëgimtarja politike e ish-kryeministrit Sali Berisha në krye të Partisë Demokratike. Zoti Berisha nuk ka më kohë për të testuar besnikërinë e atyre që iu bashkuan betejës së tij kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Prokurorisë së Posaçme (SPAK), ndaj i duhet një pasardhës si e bija. Ky hap mbyll çdo derë për dinamizëm politik në PD dhe më të rrezikuarit janë grupi i Gazment Bardhit, të cilit gazeta “SOT” ka mësuar se zonja Malltezi i ka lëshuar edhe disa ultimatumet që t’i binden. Konkretisht mësohet se zonja Berisha ka dhënë urdhër ndaj grupit të Bardhit, pra deputetëve që njihen si renegatët e Lulzim Bashës që deri në protestën e 11 korrik duhet të veshin bluzën “Lironi Berishën”, pasi në të kundërt nëse ata nuk binden, nuk do t’i kandidojë në zgjedhjet parlamentare të vitit 2025. Kjo do të thotë se renegatët e Lulzim Bashës, i presin ditë të zeza për, sepse kush nuk i bindet urdhrin nuk bëhet deputet.

Prapaskenat

Ndërkohë, nëse rekursi i Lulzim Bashës në Gjykatën e Lartë sa i takon vulës së Partisë Demokratike nuk mundëson të kundërtën, PD e Berishës kthehet në një pronë private, e cila kalon nga “non-grata” tek “non-grata”, pasi si ish-kryeministri, ashtu edhe vajza e tij, janë sanksionuar nga Uashingtoni. Qartazi Partia Demokratike kthehet në një formacion anti-amerikan, anti-drejtesë, në



shërbim të halleve të Berishës dhe familjes së tij. Qartësia e familjes së kryeministrit për rolin e tyre në PD është shfaqur tashmë mediatikisht, por edhe me hapa praktike brenda partisë së tyre familjare. Ajo është mishëruar edhe nga vendimet në organizimin partiak, ku strukturat janë një miks fundamentalistësh të Berishës dhe njerëz në librin e pagave të të birit, Shkëlzenit, ish-drejtorë tatimesh dhe doganash, të pasuruar në pushtet dhe gati të hapin thesin e plaçkës të vjedhur për t’i shërbyer betejës së “non-gratës”.

Pasojat

Por mbyllja e çdo shtegu nga ana e familjes Berisha ka lënë pa fjalë deputetët oportunistë si Gazment Bardhi dhe grupi i tij. Ata tashmë kanë çelësat e kashtës dhe presin në radhë me shpresën e një emri në listë. Frika e tyre është lexuar qartë nga familja Berisha. Ata nuk kanë më nevojë për grupin e deputetëve që iu bashkuan kohët e fundit, pasi kanë lista që Berishët duan të bëjnë është një listë besnikësh që vepron verbërisht në shërbim të Doktorit. Nisur nga kjo, përmes

Argitës, Berisha ka hedhur poshtë propozimet e Bardhit për një kandidat për kryeministër nga diaspora. Po ashtu po kërkojnë që t’i vendosin edhe më shumë nën provë, duke testuar me PS-në, mundësinë e lënies së listave të hapura, siç parashikon vendimi i Kushtetueses, duke i kërcënuar deputetët si Bardhi, Gjekmarkaj dhe Tabaku, pasi ata e dinë që pa lista të mbyllura dalin dot deputetë. Prandaj dhe protesta e 11 korrikut, e thirrur nga Berisha kundër SPAK dhe SHBA, është testi i radhës i deputetëve. Tani duhet të veshin bluzën “Lironi Berishën”, si deklaratë publike besnikërie, që kalon nga poshtërimi. Rama dhe Berisha nuk duan të bëjnë reformë zgjedhore, nuk duan as lista të hapura dhe as votën e diasporës, por talljen me vartësit e tyre, është mënyra që ata kanë zgjedhur për të treguar se duan të mbajnë në këmbë sistemin e ndërtuar në 2008-ën. Një sistem të korruptuar, që sot ndodhet nën sulmin e SPAK. Betejën e vërtetë nuk e kanë me njëri tjetrin, por me drejtësinë e re që u ka shpëtuar nga duart.

Spiropali: Opozita të na bashkohet në Komisionin për Sundimin e Ligjit, Antikorrupsionin dhe Dezinformimin

Ministrja për Parlamentin, Elisa Spiropali, i ka bërë dje thirrje opozitës të marrë pjesë në Komisionin e Posaçëm Antikorrupsion, ndërsa theksoi se Kuvendi nuk është arenë e fjalës pa fre. Ajo deklaroi se Shqipëria 2030 në Bashkimin Evropian nuk është slogan elektorale, por angazhim kombëtar plotësisht i realizueshëm. “Sot, në Ditën Ndërkombëtare të Parlamentarizmit, uroj të mësojmë nga historia. Ajo na ka dëshmuar se debatet më të forta dhe më jetëgjata janë ato me fjalët më të zgjedhura, se

Kuvendi nuk është arenë e fjalës pa fre, po freri i çdo lloj abuzimi me fjalën, se të jesh përfaqësues i popullit tënd nuk është vetëm detyrë partie, por mbi të gjitha e gjithçka detyrë Shqipërie, dhe se funksionet ligjvënëse, monitoruese e mbikëqyrëse të Kuvendit nuk janë fjalë goje, por detyra që marrin vlerë vetëm kur kanë për qëllim të vërtetën. Shqipëria 2030 në Bashkimin Evropian nuk është slogan elektorale, por angazhim kombëtar plotësisht i realizueshëm. Uroj që opozita të kuptojë e të brendësojë rëndësinë e saj

duke parë përtej penxhereve e hekurave që ia pamundësojnë vështrimin e horizonteve më të gjera e të na bashkohet në Komisionin e Posaçëm për Thellimin e Reformave për Mirëqeverisjen, Sundimin e Ligjit, Antikorrupsionin dhe në Komisionin për Dezinformimin, duke dëshmuar përgjegjësi e pjekuri në këtë prag mbylljeje të sesionit parlamentar. Sesioni tjetër, një hap më pranë zgjedhjeve, uroj të mos shtojë nxehtësinë, por cilësinë e punës së Kuvendit tonë të përbashkët”, shkruan Spiropali.

“Bandit, faqezi”, Berisha “shpërthen” ndaj kreut të SPAK: Kryen hetime me urdhër të Ramës

Kryetari i Partisë Demokratike, Sali Berisha ka shpërthyer në akuza dhe fyerje ndaj kreut të SPAK Altin Dumanit, gjatë fjalës së mbajtur nga dritarja e shtëpisë së tij ku po vuan masën “arrest shtëpie”. Berisha e akuzoi Dumanin për rastin e Fredi Belerit, i cili sipas tij edhe pse një gjykatës me integritet e ka urdhëruar të hetojë procesin e mbledhjes së të dhënave për Belerin, kreu i SPAK nuk e ka nisur hetimin. Ky hetim, siç thotë ish-kryeministri rrëzon piramidën e mashtrimit të ngritur ndaj tij dhe se Dumani nuk i kryen këto hetime, me urdhër të kryeministrit Rama. “Këto ditë mediat publikuan të dhëna se në muajin prill, një gjykatës e përgjegjshme para ligjit dhe

me integritet ka urdhëruar Dumanin e partisë, këtë faqezi që nuk ka ligj dhe as kushtetutë, të hetojë të gjithë procesin e mbledhjes së të dhënave për Belerin, hetim i cili rrëzon nga maja në themel, piramidën e mashtrimit të ngritur ndaj tij. Me urdhër të Edi Ramës, Dumani nuk zbaton urdhrin e gjykatësit, sillet si bandit, si horr që nuk ka ligj e moral. Po natyrisht çfarë mund të presë njeriu nga një njeri që qëndron në post, në kundërshtim me kushtetutën, që nuk ka votat sipas përcaktimit të kushtetutës për të marrë atë post. Por e merr si kukull, si marionetë e shpërfytyruar e të tjerëve, e mafias, e mafias shqiptare ndërkombëtare”, thotë Berisha.

Bylykbashi: Nuk na duhen junta prokurorësh, Struktura e Posaçme bën dhe shou


Deputeti i PD, Oerd Bylykbashi, ka komentuar skandalin te Onkologjiku dhe punën që ka bërë deri tani SPAK. Bylykbashi tha në një media se askujt nuk i duhen juntat e prokurorëve. Ai shtoi se Struktura e Posaçme bën edhe shou dhe diçka e tillë është një aspekt që nuk i pëlqen. Sipas Bylykbashit, kreu i SPAK Altin Dumani duhet të flasë më pak dhe të bëjë më pak shou. “Është e tmerrshme kur e dëgjon skandalin e Onkologjikut. Pavarësisht skandalit, besoj se ka dhe mjekë, që janë të ndershëm dhe bëjnë punën e tyre ndershmërisht. Uroj që ky skandal mos të dëmtojë punën e mjekëve që punojnë me djersë. Në lidhje me masat e sigurisë për këta mjekë, që disa thonë se janë disi të buta, mund të them se njerëzit kanë humbur besimin te drejtësia. Edhe pjesa që të arrestosh shumë njerëz, vetëm për të thënë se po bën drejtësi, nuk është gjë e mirë.

Duhet ta kundërshtojmë idenë që drejtësia vetëm arreton. Le t’i ikim drejtësisë popullore, drejtësia të veprojë siç duhet, me prova. Ne iu futëm reformës në drejtësi, që mos kapej, por sot reforma në drejtësi është e kapur politikisht. Prokuroria e Krimeve të Rënda unë besoj se ka qenë më e mirë sesa SPAK. Diferenca është se ata nuk ndiheshin. SPAK bën dhe shou të madh mediatik. Pse duhet që SPAK të ekspozojë veten sikur janë heronjtë që do na shpëtojnë? Askujt nuk i duhen juntat e prokurorëve. SPAK ka çuar në gjykim zyrtarë të lartë për shpërdorim detyre dhe SPAK është ende pak në raport me pritshmëritë. Do kisha pritur që Dumani të flasë më pak. Nuk më pëlqejnë prokurorët që bëjnë shou. SPAK të bëjë më shumë punë sesa fjalë. Presion ata do kenë gjithmonë. Nuk janë heronjtë e fëmijëve tanë, duhet të bëjnë punën e vet”, deklaroi Bylykbashi.

Blerja e energjisë, KLSH alarm sos: Po shkelet ligji

Nuk ndalen skandalet e Belinda Ballukut, zbardhet skema si u zhvatën 130 milionë euro në Ministrinë e Energjisë, ja si fondet devijoheshin për t'u shpallur humbje në rrjet

Abuzimet e 3 drejtorëve të KESH, OST e OSHEE janë shtuar me 130 milionë Euro në vitin 2023. Ministrja e Infrastrukturës dhe Energjetikës, Belinda Balluku u shpreh se gjatë vitit 2023 u mbyll me prodhimin më të lartë të energjisë, ndërsa Ministri i Financave, Ervin Mete, tha se ka dalë me fitime. Por sipas të dhënave që Qeveria shpalos, rezultojnë se gjatë vitit 2023 është deklaruar humbje e prishme 370 milionë Euro në sektorin e energjisë. Pra, prodhim energjie nga HEC-et shtetërore, ka për të plotësuar nevojat dhe KESH shet energjinë e tepërt në bursë, por ky sektor del me humbje 370 milionë Euro për vitin 2023, që është 130 milionë Euro më tepër se humbja e vitit 2022. Sepse shefat e KESH që prodhon energjinë, të OST që e transmeton dhe OSHEE që e shet te konsumatori, janë treshja “energjetike” që ngrenë dyshime të arsyeshme se devijimet e fondeve të shpallen si humbje në rrjetë”, raporton emisioni “Vetting” në “News 24”. Termi humbje, ka kuptimin që humbet diçka, ndërsa në rastin konkret, ish- drejtori i KESH, Ergys Verdho, drejtori i OST, drejtori OSHEE, quajnë humbje faturën prej 370 milion euro. Kjo vlerë është deklaruar nga KESH e OST, në shkresat që i kanë dërguar Enti Rregullator të Energjisë, të cilit i kërkojnë t'u zgjatet afati i humbjeve deri në fund të vitit 2023, mbasi janë shkaktuar si pasojë e emergjencës për energji, prej krizës botërore nga lufta në Ukrainë. Kryetari i ERRE, Petrit Ahmeti me Vendim Nr. 296, datë 19 tetor 2023, ka miratuar deklarimin KESH e OST për 160 milionë Euro humbje, duke firmosur dakordësinë për përbalimin nga buxheti i shtetit në përshtatje me mundësitë. Ndërsa 210 milionë Euro që OSHEE i ka deklaruar



si humbje në rrjet, ka nisur t'i justifikojë Ministria e Energjisë të cilët letrat kanë vulosur humbjet, duke “përpiluar enkas” raportet teknike dhe 50% e shumës do të rimbursohen nga buxheti i shtetit.

KLSH alarm sos: Po shkelet ligji

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) është shprehur se në kushtet kur blihet energji me çmim të lartë në fakt kemi të bëjmë me keqmenaxhim të procesit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me “Rregullat e përgjithshme të organizimit të aktivitetit tregtar nga Korporata Elektro-energjetike Shqiptare SHA”, ku përcaktohet: “Tregtimi i energjisë elektrike duhet të synojë përdorimin me efikasitet, të ardhurave, optimizimin e portofolit të KESH me qëllim përmbushjen e detyrimit për shërbim publik”. Aktualisht këstet e detyrimeve të pashlyera të OST sh.a për huat afatgjata për vitin 2022 (pricipal + interes) janë në vlerën 5,494,007,241.13 lekë. Siç edhe theksohet më sipër, këto detyrime të akumuluar për periudhën 2021-2022 si për energjinë ashtu dhe huat afatgjata janë rakorduar dhe pranuar nga palët, por të pashlyera. Situata lidhur me dividendin e KESH sh.a. ndaj Ministrisë

së Infrastrukturës dhe Energjisë. Situata e llogarive të pagueshme është përkeqësuar gjatë periudhës 2022, duke u thelluar në vlerën 13,158,133,277 lekë, në zërin e furnitorëve për energji elektrike. Rritja e kësaj difference ka ardhur si pasojë e blerjeve për energji elektrike që KESH ka kryer në treg me çmimet e bursës dhe ia ka shitur Furnizuesit të Shërbimit Universal me tarifat e miratuara nga ERRE, duke absorbuar diferencën e çmimit. Një tjetër pikë që konsiderohet si shkelje nga ana e KLSH është trajtimi me dieta për punonjësit ku duhet të ishte respektuar kuota 300 lekë/vakt ditë pune ndërkohë që kanë vijuar të mbeten 500 lekë vakt/ditë pune. “Nga auditimi i dokumentacionit të listë pagesave për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022 rezultoi se dieta për trajtim ushqimor është paguar në masën 500 lekë vakt/ditë pune, ndërkohë që duhet të paguhej 300 lekë/ditë. Nga llogaritja e listë pagesave të periudhës 01.01.2021 – 31.12.2022 rezultoi se ky përfitim është në masën 170,018,888 lekë, nga 102,011,333 lekë që duhej të ishte pra është paguar më tepër shuma prej 68,007,555 lekë e cila konsiderohet shpenzim pa efektivitet për

buxhetin e shoqërisë”, thuhet në raport. KLSH ka nënvizuar edhe dëmin që i ka ardhur KESH nga largimet nga puna ku një pjesë çështjesh janë fituar në gjykatë teksa ka të tjera që ende vijojnë. “Nga auditimi konstatohet se lidhur me proceset gjyqësore në të cilat shoqëria është palë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se për periudhën objekt auditimi janë humbur 81 çështje gjyqësore në Apel, nga ku janë humbur 3 çështje gjyqësore në Gjykatat e Shkallës të Lartë dhe në Gjykatat e Apelit, duke e detyruar institucionin të paguajë vlerën 2,375,484 lekë si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbartimore.

- Nga auditimi konstatohet se lidhur me proceset gjyqësore në të cilat shoqëria është palë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se për periudhën objekt auditimi janë humbur 81 çështje gjyqësore në apel, nga ku janë humbur 3 çështje gjyqësore në Gjykatat e Shkallës të Lartë dhe në Gjykatat e Apelit, duke e detyruar institucionin të paguajë vlerën 2,375,484 lekë si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbartimore. Për periudhën objekt auditimi, janë në proces gjykimi 7 çështje gjyqësore në Gjykatat e Shkallës së Parë Tiranë, me vlerën 1,810,437 lekë si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbartimore. Në total, vlera 4,185,921 lekë shpenzime pa efektivitet për buxhetin e shoqërisë.

- Sipas kontratës “Nëderhyje për mirëmbajtjen e sistemeve të CO₂ në HEC Fierzë dhe HEC Komani”, është përdorur fondi rezervë, ndërkohë që kemi të bëjmë me kontratë me çelësa në dorë. Vlera e fondit rezervë në shumën 2,750,000 lekë konsiderohet si shpenzim pa efektivitet, pasi procesi i komandimit mund të realizohet edhe me 4 panele shtet, ishte parashikuar. Nuk ka një analizë sipas të cilit të identifikohet nevojat e shpenzimit për vendosjen e paneleve, apo trajtimin i punonjësve që angazhohen në procesin e komandimit në

Dokumenti Përmbartimor

Për periudhën objekt auditimi, janë në proces gjykimi 7 çështje gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, në vlerën 1,810,437 lekë si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbartimore. Në total, vlera 4,185,921 lekë, konsiderohet shpenzim pa efektivitet për buxhetin e shoqërisë”, nënvizon KLSH. Por nuk baron me kaq Verdho në 2024 është promovuar në detyrë, duke u vendosur drejtori i Përgjithshëm i Hekurudhës, mbete për t'u parë nëse abuzimet do t'i marr përsëri me vete edhe në këtë drejtori.

Hapet për qarkullim aksi Thumanë-Kashar, me pagesë 2.1 euro për mjet, Rama: Do zhvillojë turizmin

Duke nisur nga dje aksi Thumanë-Kashar hapet për qarkullimin e mjeteve. Kryeministri Edi Rama ka ndarë pamjet se si duket ky aks, ndërsa qarkullimi i makinave do të lejohet prej orës 19:00. Rama shkruan se ky aks do t'i shërbejë zhvillimit të mëtejshëm të turizmit. “MIRËMËNGJES dhe me këtë fluturim mbi Thumanë-Kashar për të shijuar atë që është ndërtuar në tokë, një aks rrugor që na shërben të gjithëve dhe zhvillimit të mëtejshëm të turizmit duke qenë i aksesueshëm për të gjithë nga sot prej orës 19:00, ju uroj të diel të mbarë”, shkroi dje Rama. Kalimi në këtë rrugë do të jetë me pagesë, vlera e të cilës do varet nga lloji i mjetit, por që nuk do të jetë më poshtë se 2.1 euro. Kjo tarifë do të përlllogaritet çdo vit, dhe kompania private do mund ta rrisë atë në varësi të luhatjeve të kursit

të këmbimit lekë euro. Por do të ketë edhe rrugë alternative, dhe kalimi do të jetë pa pagesë për qytetarët. Autostrada e kategorisë A, me shpejtësi të lejuar deri në 140 kilometra në orë, pritet të lehtësojë ndjeshëm trafikun sidomos në sezonin turistik, për shkak të fluksit të turistëve që vijnë nga Rinasi. Aksi Thumanë-Kashar është një nga më të rëndësishmit e “Korridorit blu” që lidh veriun me jugun, me vlerë totale 226 milionë euro, kurse në 35 vitet e kohëzgjatjes së kontratës, koncesionari pret të fitojë 1.3 miliardë euro. Nga viti 2024 deri në vitin 2031 kompania private fitimin e ka të garantuar, pasi është parashikuar që në rast se do të ketë një rënie të nivelit të të ardhurave, buxheti i shtetit do subvencionojë humbjen dhe nga buxheti i shtetit janë vënë në dispozicion 22.8 milionë euro garanci.

Hapja e autostradës Thumanë-Kashar, revoltohet Berisha: Rama taksë banorëve

Kryetari i Partisë Demokratike, Sali Berisha ka reaguar dje në rrjetet sociale për inaugurimin e 27 kilometra rrugë të nisur nga qeveria e Ramës plot 11 vite më parë. Berisha ka shprehur vlerësimin për çdo kilometër rrugë që ndërtohet në këtë vend, por ka denoncuar dhe diskriminimin ekstrem, ndëshkimin që Edi Rama u bën banorëve të veriut. “Të dashur qytetarë dhe qytetarë, sot Rilindja e Edi Ramës inaguron pas 11 vitesh në pushtet, 27 kilometrat e para autostradë të nisura dhe përfunduara prej saj. Por unë duke shprehur vlerësimin tim për çdo kilometër rrugë që ndërtohet në këtë vend, jam sot para jush për të denoncuar diskriminimin ekstrem, ndëshkimin që Edi Rama u bën banorëve të veriut nga Thumana deri në Vermosh dhe Valbonë, duke vendosur aty një taksë për ardhjen e tyre në Tiranë. Theksoj këtu se për qarkun e Kukësit, qarkun më të varfër të kontinentit, i cili është rreth 38-40 vite mbrapa me të ardhura me Tiranën, kjo është taksë e dytë që

ata duhet të paguajnë pas taksës së Rrugës së Komit. Por nga ana tjetër kjo taksë, është një ndëshkim për të gjithë turistët dhe vizitorët që vijnë nga Kosova, të cilët së bashku me ata që vijnë nga Mali i Zi, Muriqani dhe Hani i Hotit dhe nga Evropa në këto akse, përbëjnë mbi 70% të turistëve që vijnë në Shqipëri. Për vizitorët nga Kosova kjo taksë e rrit në 17 Euro shtesë vizitën apo udhëtimin e tyre turistik në Shqipëri. Shumë kjo që nuk ekziston në asnjë vend tjetër sado të madh të kontinentit Evropian. Ndaj dhe une ju bëj thirrje banorëve të qarqeve të veriut të ngrihen kundër këtij diskriminimi anti-shqiptar, anti-kushtetues të Edi Ramës me taksën që ka vendosur ndaj tyre. Kjo sepse sot aktualisht në të gjitha zonat e tjera të Shqipërisë nga Tirana në Leskovik, në Qafë Botë, në Kakavijë lëvizet në autostrada dhe superstrada pa asnjë taksë. Pra është një diskriminim që ju të dashur banorë të zonave të veriut nuk duhet ta pranoni kurrsesi”, shkroi Berisha.

Artur Meçollari akuza Begajt

Presidenti Bajram Begaj dhe kupola e bazës detare të implikuar në skandalin e aferave me pronat publike kanë pranuar jashtë kamerave se SPAK ka gjetur “gjilpërën në kashtë”, ja si oligarkët japin gradat në ushtri, Artur Meçollari plas skandalet e rënda

Elmas BOGDANI

Kapiteni i rangut të parë, Artur Meçollari, njëherësh ish-zëvendëskomandant dhe komandant në detyrë i Forcës Detare ka nxjerrë detaje të forta për hetimet e SPAK, kundër disa prej zyrtarëve më të lartë me në krye presidentin Bajram Begaj në lidhje me aferat në ushtri. Meçollari “fik” karrierën e Begajt, ku thotë se vetë Presidenti dhe kupola e bazës detare kanë pohuar përfshirjen në skandalin e aferave me pronat publike, ku theksojmë se në kohën kur kanë ndodhur abuzimet me pronat e ushtrisë, Begaj ka qenë Shef i Shtabit të Përgjithshëm. Ai është shprehur se jashtë kamerave, Presidenti dhe kupola e ushtrisë kanë thënë se SPAK ka gjetur “gjilpërën në kashtë”, si dhe secili prej zyrtarëve është paraqitur njëherë të paktën në dyert e Prokurorisë së Posaçme. Komandant i Forcës Detare nuk e ka lënë me kaq, ka plasur skandalet njëri pas tjetrit pasi ai ka deklaruar se oligarkët e pronave ndërhyjnë në ushtri dhe madje japin gradat, duke bërë kështu të cenohet siguria kombëtare, marrëdhënia me NATO-n, gjithashtu dhe operacionaliteti i Forcës Detare. “Kupola e bazave detare. Mungon Bajrami. Të paktën secili prej tyre është paraqitur një herë në SPAK. Në foto dalin të qeshur, por kur janë jashtë kamerave pranojnë se



SPAK ka gjetur dhe gjilpërën në kashtë. Baza Detare e Sarandës, 4 ha nën sekuestro preventive. Në interes të oligarkëve. Baza detare e Shëngjinit, 66,4 ha nën sekuestro preventive. Në interes të oligarkëve. Prona 219 Porto Romano prej tre vitesh e zaptuar 5,2 ha dhe ndërtim pa leje nga Porti MBM. Në interes të oligarkëve. Oligarkët e pronave japin dhe gradat në ushtri. Hyn në ushtri për t'i shërbyer Atdheut, por në fakt ju shërben oligarkëve dhe shërbëtorëve të tyre në drejtim të ushtrisë. Prandaj gjendja e personelit është kjo që është. Do bëhet dhe më keq. Sipas vendimit të gjykatës kontrata dhe dorëzimi i Bazës Detare të Sarandës “ka cënuar siguria kombëtare, marrëdhëniet me NATO-n, si dhe misioni dhe operacionaliteti i Forcës Detare”, shkruan ai në rrjetet sociale.

Meçollari “hap” biografinë e Begajt

Kapiteni i rangut të parë dhe ish-numri dy i Forcës Detare veç skandaleve ku protagonist

ishte Begaj, në shkrimin e tij ka treguar edhe ‘arsyen’ pse është emëruar President, kjo pasi sipas tij nuk ka folur dhe ka mbajtur sekret “bëmat” e “shokëve” të tij në profesionin e errët, çka ka sjellë një shtet që është nga më të korrupuarit në Evropë. Meçollari ndër të tjera ka zëbërthyer “arritjet” e punës së Presidentit, ku sipas tij falë zyrtarëve të shtetit, por dhe falë Begajt kemi një sistem sigurie ku informacionet vidhen vetë nga shteti, një shëndetësi që vret njerëz, ku ka përmendur skandalin e pak ditëve më parë në Onkologjik si dhe një sistem mbrojtje që jep falas një bazë detare për oligarkët. “Përse na duhet të paguajmë një President dhe stafin e tij? Sepse ai është unitet i popullit, jo pjesë e qeverisë; sepse është Komandant i Përgjithshëm i FA. Sepse është Kryetar i Këshillit të Sigurisë Kombëtare; sepse është kreu i Shtetit dhe mbi palët dhe për më tepër Bajrami është ushtarak dhe doktor. Bajrami nuk ka folur

dhe mos prisni të flasi për shumë çështje të rëndësishme që kanë cënuar sigurinë kombëtare në dy vitet e fundit. Sepse, prandaj u emërua. Falë edhe Bajramit kemi: një sistem shëndetësor jo human dhe që vret me vullnet jetën njerëzore (Onkologjiku); një sistem sigurie ku vetë shteti vjedh informacionet kritike të sigurisë së tij dhe qytetarëve (TIMS) dhe nuk dihet ku i shet. Ndoshta edhe armikut; një sistem mbrojtje që jep falas një bazë detare për oligarkët duke cënuar sigurinë kombëtare dhe marrëdhëniet me NATO-n; një vend anëtar i NATO-s që ndryshon destinacionin e portit më të madh, atij të Durrësit, duke injoruar konceptin strategjik të NATO-s; një shtet që është prej vitesh një nga më të korrupuarit të Europës dhe NATO. Dhe në fund krahasoni Bajramin me Moisiun”, shkruan Meçollari.

Paralajmëron Artur Meçollari: Serbia do të sulmojë Kosovën

Veç detajeve të reja për zyrtarët shqiptarë, gjithashtu kapiteni Artur Meçollari më anë të një postimi në rrjetet e tij sociale ka paralajmëruar se Kosova do të sulmohet shumë shpejt nga Serbia, pasi kjo e fundit po fuqizon kapacitetet ushtarake, por po pret fitoren e Rusisë në luftën me Ukrainën dhe krijimin e precedentit, ku shtetet mund të marrin territoret që pretendojnë. Sipas Meçollarit, fitorja e Ukrainës kundrejt sulmeve ruse i intereson dhe është thelbësore për gjithë Europën. Komandanti në detyrë i

Forcës Detare nga ana tjetër tha se objektivi final i Rusisë është rikthimi i Marrëveshjes së Jaltës dhe ristrukturimi i skemës së sigurisë europiane. “Asnjë marrëveshje me Rusinë nuk duhet të bëhet në dëm të integritetit territorial të Ukrainës. Ajo do të krahasohet me Marrëveshjen e Mynihut të shtatorit 1938 midis Gjermanisë, Mbretërisë së Bashkuar, Francës dhe Italisë. Marrëveshja e Mynihut në emër të paqes lejoi Gjermaninë të pushtojë një pjesë të Çekosllovakisë. Ajo në vend që të garantonte paqen, nxiti Luftën e Dytë Botërore. Serbia sot i ka kapacitetet ushtarake dhe po i fuqizon ato që të sulmojnë Kosovën, por pret fitoren e Rusisë në Ukrainë dhe krijimin e precedentit, që çdo shtet mund të përdori forcën për të marrë territoret që pretendon. Rusia ka si objektivi final rikthimin e Marrëveshjes së Jaltës dhe ristrukturimin e skemës së sigurisë europiane. Ulja e fuqisë ushtarake të Rusisë, eliminimi i çdo kërcënimi rus dhe fitorja e Ukrainës janë thelbësore për Europën dhe paqen e së nesërme Prandaj sot Ukraina po lufton për të gjithë Europën. Ashtu sikurse populli shqiptar, dhe çdo popull evropian, nuk pranon dhe nuk do të pranojë kurrë koncesione territoriale në emër të paqes, edhe Ukraina nuk ka pse të pranojë. Një paqe e qëndrueshme vjen vetëm me fitoren e Ukrainës”, thotë Artur Meçollari.

Ministri Hasani “përplaset” me Lajçak: Përqendrohuni tek dialogu Kosovë-Serbi, do jemi të lumtur nëse do ketë rezultate

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Iglj Hasani në fjalën e tij në Forumin e Dubrovnikut, theksoi se ne, në Ballkanin Perëndimor duhet të fillojmë të sjellim në tryezë zgjidhje, të gjejmë një mënyrë për të ecur përpara nga të gjitha problemet që na pengojnë, çka do të sjellë më shumë prosperitet, paqe dhe siguri për këtë rajon. “Sa i përket Shqipërisë, vijoi ai, nuk ekziston asnjë “pasiguri” apo “dysim”. Dhe as justifikim

për ata që duan të bllokojnë. Ne po i përmbushim detyrat tona të shtëpisë për të filluar negociatat për kapitujt dhe nuk duhet të lejojmë asnjë individ të hyjë në axhendën dypalëshe të një vendi. Shqipëria dhe partnerët e saj kanë investuar shumë në reformën e sistemit të drejtësisë dhe ajo ka filluar të krijojë besim me vendimet e saj. Njerëzit kanë nevojë për shpresë dhe ne do të përpiqemi të sjellim shpresë, përmes rezultateve. Në këtë

Forum kanë marrë pjesë diplomatët e rajonit, dhe emisari i BE-së Miroslav Lajçak e Ndihmës Sekretarin për Evropë James O'Brien. Kryediplomati Hasani i është referuar konferencës së parë Shqipëri BE të vitit 2022, për çeljen e negociatave. “Ndihem i obliguar që të përgjigjem në pyetjen që i bëri ministrit Hasani. Dua të them se ky proces është absolutisht i bazuar në merita. Ka shumë politikë dhe gjeopolitikë në fazën përgatitore, vendimi për

të dhënë statusin e kandidatit, ftesa për hapjen e negociatave për anëtarësim, por pasi të jeni në proces të anëtarësimit ju duhet të përmbushni kriteret, s'ka rrugë të shkurtër”, ka thënë Lajçak. Por, ndaj këtij konstatimi ka reaguar menjëherë kryediplomati shqiptar. “Nuk thash asnjëherë rrugë të shkurtra..megjithë respektin ti je për dialogun Beograd-Prishtinë. Kështu që dua të jem i qartë në një gjë. S'kemi kushte për kushtet që na janë vënë. Le

të jem i qartë për këtë”, ka thënë Hasani. Lajçak reagoi duke thënë se “nuk jam duke polemizuar me ty Iglj”. I menjëherëshëm ishte reagimi i Hasanit i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë i kërkoi që të merret me dialogun Kosovë-Serbi, madje me ironi duke ia përmendur rezultatet. “Po, po, por rri te dialogu, do të jemi të lumtur nëse ke ndonjë rezultat, do të mbështesim, do të mbështesim vazhdueshëm siç kemi bërë...por rri te dialogu”, tha Hasani.

aktualitet

■ Dosja nga Prokuroria e Vlorës është transferuar në SPAK

Vetë firmosnin e vetë vulosnin, ja si Arqile Bollano i mori tokën një mësuesi në Himarë, zbardhen të tjera detaje nga dosja e SPAK dhe skema si abuzuan me ligjin me ish-kryebashkiakun Jorgo Goro

Nëntë vite më parë, një punonjës i rëndësishëm i bashkisë Himarë, i quajtur Arqile Bollano, që sot mban postin e kryetarit të komanduar të bashkisë Himarë, ndërtoi një listë emërore për disa banorë të zonës, të cilët duhet të trajtoheshin me tokë nga bashkia Himarë. Ndërtimi i kësaj liste argumentohej me faktin se këto familje nuk ishin trajtuar me tokë bujqësore në vitin 1991-1992, por për shkak se ishin përdorues faktik të disa ngastrave toke, këto sipërfaqe duhet ti njiheshin nga ana e Bashkisë Himarë. Në kohën e paraqitjes së listës së përfituesve në Bashki, Arqile Bollano ishte pjesë e grupit të punës në bashkinë Himarë, ku kryente plotësimin e procedurave që do shpallnin emrat përfitues të tokës, shkruan "Ora News". Pikërisht në këtë listë, ishte dhe emri i Arqile BOLLANOS, njeriut kryesor që drejtonte grupin e punës për trajtimin e personave me tokë nga ana e bashkisë së Himarës.

Dosja

Sipas dosjes hetimore del se Bollano vetë firmoste, vetë verifikonte dhe më pas vetë



rezulton të jetë përfitues i dy ngastrave me tokë me një sipërfaqe totale prej 4900 m² në zonën e Himarës. Bollano, përfitoi pronësinë mbi dy sipërfaqet e tokës, ku tek njëra prej tyre prona e fituar nga zyrtari i bashkisë, u mbivendos në pothuajse 80 për qind mbi pasurinë e një mësuesi në Himarë. Një fakt i tillë është provuar dhe përmes një akti-ekspertimi topografik të kryer nga prokuroria që ka ndjekur rastin. Rezultoni se firmëtar final për përfitim të këtyre dy ngastrave nga zyrtari Arqile Bollano dhe personave të tjerë, rezultoni të jetë kryetari i asaj kohe, Jorgo Goro, aktualisht në burg për akuzën e "Shpërdorimit të detyrës" lidhur

me rastin e tokës të përfitur në zonën e Himarës nga Artan Gaçi, burri i deputetes së PS, Olta Xhaçka. Por ky rast kundër Jorgo Goros, është vetëm një episod i dokumentuar nga Prokuroria e Vlorës dhe më pas transferuar në Prokurorinë e Posaçme SPAK. Pasi një rast i dytë akoma dhe më i rëndë që përfshin Jorgo Goron dhe vetë kryetarin e komanduar të Himarës, Arqile Bollano, pritet të thellojë skandalin e rrëmbimit të pronave publike dhe private në zonën bregdetare. Sipas dosjes hetimore, Jorgo Goro, në cilësinë e kryetarit të bashkisë Himarë, ka firmosur për përfitim të dhjetëra mijë metra katror tokë nga disa familje bujqësore. Praktika është

përpiluar dhe argumentuar në formën se këto familje bujqësore nuk janë trajtuar me tokë gjatë vitit 1991-1992. Dhe për shkak se këto familje dispononin dhe kishin në përdorim faktik disa ngastra me sipërfaqe toke në zonën e Himarës, këto toka duhet t'i njiheshin nga bashkia. Mes përdoruesve faktikë në listën e përfituesve është dhe Arqile Bollano, aktualisht kryetar i komanduar i bashkisë Himarë. Por nga verifikimet e kryera nga prokuroria, ka rezultuar se në periudhën e përpilimit të kësaj praktike, 2015-2016, Bollano ishte pjesë e grupit të punës që ka ndërtuar listën e përfituesve.

Çfarë thotë ligji?

Ndërkohë nga një verifikim i kryer nga prokuroria, ka rezultuar se Arqile Bollano, nuk duhet të përfitonte pronësinë mbi dy ngastrat e tokës, pasi ai rezultoi në librin e fermerit se është trajtuar me tokë në vitin 1991. Ligji e përcakton qartë se familjet bujqësore që janë trajtuar me tokë nga komisionet e ndarjes së tokës, përjashtoheshin nga përfitimi, edhe nëse ishin përdorues faktikë të një sipërfaqe toke. Kjo pasi pjesën takuese.

Por kjo gjë nuk është mbajtur parasysh, sikundër nga ana e kreut të bashkisë Himarë, Jorgo Goro, nuk është marrë asnjë masë për të kryer verifikime në teren nëse tek këto sipërfaqe toke, ka mbivendosje ose jo, nëse mbi këto sipërfaqe toke ka ndërtime me leje ose pa leje, nëse për këto sipërfaqe toke ka apo jo pretendentë të tjerë të pronësisë, nëse është e rregulluar marrëdhënia mes kufitarëve, etj. Për shkak të këtyre shkeljeve të njëpasnjëshme dhe nisur nga pozita juridike e Arqile BOLLANOS, i cili mban funksionin e kryetarit të komanduar të bashkisë Himarë, prokuroria e Vlorës vendosi të shpallë moskompetencën dhe dosjen t'ia kalojë për hetime të mëtejshme prokurorisë së posaçme SPAK. Tashmë është kjo prokurori që po ndjek rastin duke bashkuar çështjen e dosjen e Jorgo Goros, kryetarit të bashkisë Himarë të arrestuar. Arqile Bollano, është kryetari i tretë që përfundon në SPAK, pas arrestimit të Fredi Belerit dhe Jorgo Goros. Ndërsa kryetarja e komanduar e kësaj bashkie, Blerina Bala, ka dhënë dorëheqjen.

Lejuan ndërtime të paligjshme në Shirokë, Prokuroria e Shkodrës dërgon në gjyq për shpërdorim detyre 9 zyrtarë të IMT-së dhe Kadastrës

Prokuroria e Shkodrës dërgoi për gjykim 9 zyrtarë dhe ish-zyrtarë të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit dhe Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, për shpërdorim detyre në bashkëpunim. Punonjësit e IMT Shkodër, Ergys KARRAMETAJ dhe Mirsad HALLUNAJ, akuzohen se me veprimet dhe mosveprimet e tyre, në kundërshtim me ligjin, kanë lejuar ndërtimin në mënyrë të paligjshme të një objekti dy-katësh në zonën e Shirokës, duke mos e evidentuar dhe kallëzuar në prokurori, edhe pse provohet se kanë pasur dijeni të plotë për të. Ndërkohë, punonjësit e Kadastrës së Shkodrës, Ardian DODANI, Besmir LEKAJ, Erlëta BALA, Fatjon TAHIRI, Iira SHQARRI, Suad SMAKAJ dhe Besmir VUKAJ, akuzohen se kanë mundësuar legalizimin e disa objekteve të ndërtaura pa leje në të njëjtën zonë, ku ndërkohë, për shkak të statusit dhe mbrojtjes së veçantë,

legalizimi i objekteve informale në këtë zonë, është i ndaluar me ligj. Kallëzimi në prokurori ndaj punonjësve të IMT Shkodër është bërë nga një grua, e cila pasi ka konstatuar ndërtimin e paligjshëm të një objekti dy-katësh që ndërtohej në një sipërfaqe toke të pretenduar si në pronësi të familjes së saj. Sipas saj punonjësit e IMT-së nuk kishin marrë masa për pengimin e ndërtimit edhe pse ishin njoftuar vazhdimisht nga ajo. Prokuroria e Shkodrës dërgoi për gjykim 9 zyrtarë dhe ish-zyrtarë të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit dhe Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, për shpërdorim detyre në bashkëpunim. Punonjësit e IMT Shkodër, Ergys KARRAMETAJ dhe Mirsad HALLUNAJ, akuzohen se me veprimet dhe mosveprimet e tyre, në kundërshtim me ligjin, kanë lejuar ndërtimin në mënyrë të paligjshme të një objekti dy-katësh në zonën e Shirokës, duke

mos e evidentuar dhe kallëzuar në prokurori, edhe pse provohet se kanë pasur dijeni të plotë për të. Ndërkohë, punonjësit e Kadastrës së Shkodrës, Ardian DODANI, Besmir LEKAJ, Erlëta BALA, Fatjon TAHIRI, Iira SHQARRI, Suad SMAKAJ dhe Besmir VUKAJ, akuzohen se kanë mundësuar legalizimin e disa objekteve të ndërtaura pa leje në të njëjtën zonë, ku ndërkohë, për shkak të statusit dhe mbrojtjes së veçantë, legalizimi i objekteve informale në këtë zonë, është i ndaluar me ligj. Kallëzimi në prokurori ndaj punonjësve të IMT Shkodër është bërë nga një grua, e cila pasi ka konstatuar ndërtimin e paligjshëm të një objekti dy-katësh që ndërtohej në një sipërfaqe toke të pretenduar si në pronësi të familjes së saj. Sipas saj punonjësit e IMT-së nuk kishin marrë masa për pengimin e ndërtimit edhe pse ishin njoftuar vazhdimisht nga ajo.

Ndërtoi pa leje në zonën e plazhit Dhërmi, në hetim 53-vjeçari

Një 53-vjeçar do të procedohet penalisht pasi ndërtoi pa leje një 'beach-bar', në vijën bregdetare në Dhërmi. Raportohet se në bashkëpunim me Policinë Bashkiake dhe IMT Himarë, hapësira e plazhit është rikthyer në gjendjen fillestare. "Operacionet policore 'Coastline' dhe 'Plazhi i lirë' do të vijojnë intensivisht në qarkun Vlorë, me qëllim rikthimin e hapësirave publike dhe ndëshkimin sipas ligjit të çdo shtetasi që prek këto hapësira dhe i shfrytëzon ato në mënyrë të paligjshme", thuhet në njoftimin e policisë.

Arrestohet në Pogradec një 25-vjeçar nga Tirana, ja arsyeja

Një 25-vjeçar është arrestuar në flagrancë në aksin rrugor Korçë-Pogradec në afërsi të fshatit Vërdovë, Pogradec, pasi po transportonte në drejtim të Tiranës 17 emigrantë me qëllim kalimin e paligjshëm të kufirit. Autori me inicialet R.H., banues në Kodër-Kamëz, Tiranë transportonte emigrantë nga Vendet e Treta, me automjetin furgon tip "Opel" kundrejt fitimit, njoftoi dje policia. Efektivët sekuestruan në cilësinë e provës materiale automjetin dhe një celular. Materialet procedurale kaluan Prokurorisë së Korçës.

Kultivoi bimë narkotike në Selishtë, në pranga 36-vjeçari, në hetim edhe kryeplaku

Një 36-vjeçar është arrestuar dje në flagrancë, pasi dyshohet se ka kultivuar të bimë narkotike, brenda një zone të pyllëzuar në fshatin Selishtë. Në hetim është vënë edhe kryeplaku i fshatit dhe specialisti i pyjeve në këtë fshat të cilët akuzohen për shpërdorim detyre, informoi sot policia. Efektivët e policisë kanë asgjësuar dhjetëra bimë kanabisi dhe mjete pune që shërbenin për këtë aktivitet kriminal. Materialet i kaluan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.

■ Nunaj tregon detaje nga skema e sigurimeve shoqërore

Ja çfarë do të ndodhë pas 1 korrikut me rritjen e pagave dhe pensioneëve, ekspertja e njohur e ekonomisë jep informacionet e fundit, zbulohen kategoritë që përfitojnë

Xhoana VRANIÇI

Ekspertja e njohur e ekonomisë, Teuta Nunaj ka nxjerrë disa informacione të rëndësishme në lidhje me rritjen e pagave që do të ndodhë më 1 korrik, pra sot. Teksa janë zbuluar kategoritë që përfitojnë, zonja Nunaj ka thënë në një intervistë televizive për "SCAN TV", se rendimenti i punonjësve në administratën publike nuk është i njëjtë. Sipas saj, ka shumë individë të cilët janë shumë pasiv, por ka dhe individë të cilët janë shumë aktiv të cilët kryejnë më shumë se një punë. Në këtë këndvështrim të kësaj analize, ajo gjykon se është e pamjaftueshme kjo rritje dhe ndaj në këtë rast gjithmonë duhet parë për të mos u lënë pa u rregulluar.

Rritja e pagave

Teuta Nunaj ka folur edhe për rrezikun që mund të sjellë financimi i rritjes së pagave bazuar pikërisht tek rritja ekonomike. E pyetur nëse përbën kjo rrezik sepse mund të supozohet të ndodhë një krizë, sikurse ka ndodhur në të kaluarën dhe ky financim nuk vjen më nga rritja ekonomike, ajo tha se kjo nuk është një rritje që i përket vetëm një viti ushtrimor. "Në arsyetimin tuaj ka një logjikë ekonomike, por kur flasim për rritje të pagave është një rritje që nga ky moment dhe është në vazhdimësi, për çdo vit për individët që janë të punësuar në administratën publike. Pra nuk është një rritje që i përket vetëm një viti ushtri-



mor. Pra, nuk është në formën e shpërblimit që qeveria e jep më formën e shpërblimit, që këtë vit qeveria e jep dhe vitin tjetër nuk e jep. Kështu që automatikisht janë kosto apo shpenzime publike që gjenerohen ndër vite. Nëse ne do ta marrim ngushtësisht në aspektin pra meqenëse kemi rritje të të ardhurave ose të të hyrave publike, automatikisht qeveria gjykon në këtë rast pasi ne do të bëjmë dhe një rritje. Por, nga ana tjetër, në këtë rast, duke qenë se këto rritje, janë realisht të kufizuara, pavarësisht se mund të duken rritje të mëdha, 20 mijë lekë +, por sërish janë më të kufizuara sepse aty kanë brenda edhe atë normë inflacioni. Pra, paga e punonjësit, përpara një viti ose sot, blen më pak njësi mall sesa e njëjta pagë që është blerë 5 vite më parë po të marrim parasysh krizën e 2019-ës. Minimalisht kjo pagë shkon

në ato nivele sa i përket njësisë së blerjes, pra në vetvete jo paga në lekë por paga kundrejt blerjes së një njësie, pasi paga përdoret e nuk lihet aty e të shtohet si vlerë. Në këtë këndvështrim, të këtij rasti themi se kjo rritje page është shoqëruar me këtë indeksim sepse dhe qeveria ka mbledhur më shumë të ardhura si pasojë e TVH-së së lartë. Çmimi më i lartë i produktit, automatikisht ka prodhuar tatime më të larta dhe kur flasim për një ekonomi në zhvillim, këto paga janë në rritëm rritje që nuk i cenojnë parametrat makro-ekonomik të vendit", tha ajo.

Rritja e pagave sipas kategorive

Teuta Nunaj ka folur edhe për kategoritë që kanë përfituar rritje page. -Mësues (nivel i mesëm, i lartë) është 79 mijë bëhet - 98.5 mijë. Mësues (nivel i mesëm, i ulët) është 75. 8 mijë bëhet - 96 mijë -Mësues cikli fillor është 72.4 mijë dhe bëhet 95.2 mijë. Mjeket +20 mijë Infermierët +15 mijë. Administrata shëndetësore +15-20%. E pyetur nëse një reformë e tillë duhej ndërmarrë në këto momente, pavarësisht se inflacioni është ngadalësuar dhe jemi drejt mbylljes së një periudhe me inflacion të lartë, ajo tha se gjithë këto mungesa të rritjeve ndër vite, ku të mbledhim të gjithë inflacionet na japin këtë rritje page. "Aktualisht në këtë rast kemi të bëjmë me një rritje që dhe ju vetë e cekët disi të lartë në vlerë por duhet të kemi një gjë në konsideratë të cilën e vijum në analizë. Në gjithë këto vite nuk është bërë asnjë rritje page në administratën publike dhe asnjë indeksim page për normë inflacioni në administratën publike dhe nëse ne do të kishim

një indeksim page për normë inflacioni, automatikisht nuk do të kishim rritje page. Pra, të gjitha këto mungesa të rritjeve ndër vite, ku të mbledhim të gjithë inflacionet na japin këtë rritje page. Kështu që në këtë këndvështrim analize ne nuk do të themi që është një rritje e cila ka ardhur që thjesht po e rris por është një rritje si pasojë e indeksimeve. Nëse ne do të mbledhim të gjithë normat e indeksimeve të inflacionit të 10 viteve, ne do të shohim në këtë rast që produkti në fund do të jetë i njëjtë ose me diferenca shumë pak të vogla. Edhe pse mund të duket një rritje e lartë, sërish në këtë rast jemi në të njëjtat nivele dhe duhet theksuar që kjo rritje bëhet më me pak bruto", tha ekspertja.

Pensionet

Gjithashtu Znj.Nunaj ka folur edhe për skemën e sigurimeve shoqërore që ka nisur të shfaqet në performancë pozitive. Sipas saj, pensionet do të rriten. "Absolutisht që po pasi ne thamë se të ardhurat e një punonjësi, gjenerohen dhe tre të ardhura të tjera në këtë rast, si kontributet e sigurimeve shoqërore-shëndetësore dhe njëkohësisht tatimet. Sa më të larta pagat, aq më të shumë shpenzojnë individët por në këtë rast, aq më shumë të ardhura futet në buxhetin e shtetit. Skema e pensioneëve në këtë rast ka krijuar një varësi shumë të madhe nga ana e shtetit dhe kjo performancë e mirë ka një meritë vetë skema e mbledhjes së të ardhurave por ka një meritë në këtë rast si performancë pozitive".

shpenzimeve për pension por nuk e zgjidh problemin e skemës sepse hendeuku vijon të jetë ende shumë i lartë. Duke qenë hendeuku i lartë, financimi nga buxheti i shtetit është edhe më i lartë sepse zëri i kontributeve është një zë buxhetor. Nga buxheti i shtetit bëhet pagesa e pensioneëve. Në anën tjetër në këtë rast një rritje të ndjeshme në këtë rast, të këtyre kontributeve ndihmon jo vetëm në të ardhmen për pensionet të jenë disi dhe më të larta por thamë që zvogëlohet ky hendeuku për t'i dhënë mundësinë në këtë rast që të ndikojë në sektorin privat që të ketë një rivlerësim të pagave të punonjësve", tha ajo.

Forcat e Armatosura dhe zjarrfikësit

Po ashtu ekspertja e ekonomisë ka komentuar edhe pagat te sektori i Forcave të Armatosura, p.sh., një gjeneral ka një pagë rreth 190 mijë lekë dhe zbret në varësi të gradave e deri tek ushtari në 710 mijë lekë. E njëjta tendencë në rritje është dhe përsa i përket forcave zjarrfikës. E pyetur nëse tashmë kemi të bëjmë me një profesion më dinjitoze duke marrë parasysh dhe rreziku që ndikon, ajo tha se

Skema e pensioneëve në këtë rast ka krijuar një varësi shumë të madhe nga ana e shtetit dhe kjo performancë e mirë ka një meritë vetë skema e mbledhjes së të ardhurave por ka një meritë në këtë rast si performancë pozitive

këtë rast nëse ne flasim për cilësim rreziku. "Aktualisht në këtë rast nëse ne flasim për cilësim rreziku, siç e cekët ju krahas të gjithë sektorit të ushtrisë në të gjitha nivelet, krahas sektorit të zjarrfikësve si dhe sektorit të policisë së burgjeve dhe policia e shtetit janë sektor të cilët kanë dy element. E para kanë rrezikun në nivel më të lartë dhe e dyta vështirësinë e punës e kanë në nivel më të lartë. Nëse marrim sektorin e burgut ai punon brenda një burgu, pavarësisht se shkon në punë, por në vetvete 8 orë i kalon aty brenda dhe masa e riskut dhe rrezikut është më e madhe, ndaj gjykohet në këtë rast që këta punonjës duhet ta kenë dhe shumë herë më të lartë rrogën në mënyrë që dinjiteti i tyre gjithmonë dhe më i lartë", përfundoi ajo.

Gonxhja: Nga 1 korriku, rritje me 35 % e pagave për specialistët e administratës

Nga 1 korriku 4,112 punonjës të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, si dhe institucioneve të varësisë së MEKI, do të përfitojnë rritje të pagave. Ministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Blendi Gonxhja tha këtë fundjavë se politika e rritjes së pagave mbart një buxhet shtesë prej 517 milionë lekë, për të gjithë punonjësit, për vitin 2024. "Paga mesatare për specialistët në administratën publike (MEKI) do të jetë 113,333 lekë/muaj, duke shënuar një rritje prej 35% krahasuar me vitin 2023. Ky përmirësim motivon mbi 4,000 specialistë

të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe institucioneve të varësisë", theksoi Gonxhja. Gonxhja bëri të ditur se edhe për 555 punonjës mbështetës, do të ketë një shtesë pagash deri 8,000 lekë/muaj. "Ky është një hap i rëndësishëm drejt një administrate publike më të motivuar dhe më efikase", tha Gonxhja. Vendimet e fundit të qeverisë për rritjen e pagave avancojnë fazën e dytë të politikës së rritjes së pagave, e cila ka nisur në vitin 2023, fazë nga e cila përfitojnë rreth 135 mijë punonjës të administratës shtetërore.

rajon

Posterat rindezin tensionet në veri, Sveçla kërcënon: Nëse Vuçiç vjen, do të arrestohet

Mëngjesin e djeshëm në komunat në veri të Kosovës janë shfaqur disa postera me imazhin e presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiç. Në posterat ku shihet Vuçiç, shkruhet: "Komandant Suprem, ju presim". Këto postera janë shfaqur në katër komunat veriore, Leposaviç, Zubin Potok, Zvečan dhe veri të Mitrovicës. Posterat janë vendosur në muret e ndërtesave, shtëpive, lokaleve dhe hapësira të tjera publike.

Lidhur me këtë ka reaguar edhe ministri i Brendshëm i Kosovës, Xhelal Sveçla, që ka paralajmëruar se nëse Vuçiç është nisur drejt Kosovës pa kërkesë ose lajmërim, ai do të arrestohet. "I paskan ngjitur tinëz gjatë natës disa postera në veri të Kosovës. Aty thonë që po e presin presidentin e Serbisë të vijë duke e quajtur atë 'komandant'. Nëse është nisur pa kërkesë te Ministria jonë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, edhe ne

po e presim të vijë dhe mandej mund ta vizitoni në burg, ku ai i ka tashmë disa miq të tij", ka shkruar ministri në profilin e tij në Facebook. Për këtë rast ka reaguar edhe Policia e Kosovës. Zëvendës drejtori i Policisë për rajonin e veriut, Veton Elshani ka deklaruar se është hapur hetim për veprën penale "Nxitje e Urrejtjes". "Në disa lokacione të komunave në veri të vendit janë shpërndarë pamflete me foton e Presidentit të Serbisë.

Pas konsultimit me Prokurorin e Shtetit është hapur rasti "Nxitje e Urrejtjes", ka thënë Elshani. Kryeministri i Serbisë Millosh Vuçević, tha se askush në Prishtinë nuk ka asnjë të miliontën e kapacitetit politik, forcës intelektuale dhe moralit të Aleksandër Vuçiçit. "Komentet e një të vetëshpallurit të një shteti të rremë për presidentin Vuçiç dëshmojnë një shkallë jashtëzakonisht të lartë zillie dhe urrejtjeje", tha Vuçević.

Paralajmëron kryediplomati i BiH

Bosnja dhe Hercegovina në alarm, Rusia ka hyrë shumë thellë në Ballkan, si Dodik ka ndryshuar plotësisht pas një udhëtimi, zbulohet çfarë ndodhi në takim me Putinin

Marsela SHYTIA

Rusia është shumë e pranishme në Ballkanin Perëndimor, paralajmëroi të shtunën shefi i diplomacisë së BiH Elmedin Konakoviç, por gjithashtu tha se Bashkimi Evropian nuk ka qenë kurrë më aktiv në këtë fushë. Konakoviç ishte një nga folësit në panelin për Ballkanin Perëndimor në Forumin e Dubrovnikut. Ai e filloi prezantimin e tij duke treguar një foto të Milorad Dodik me Vladimir Putin në qershor të këtij viti në Moskë. Konakoviç tha se para udhëtimit të tij në kryeqytetin rus, Dodik votoi për një pjesë të reformave evropiane në Bosnje dhe Hercegovinë, por se pas atij udhëtimit ai "sillet ndryshe". Marrëveshja e Dejtonit, "Great 1995" për të ndaluar luftën, sot mundëson "të gjithë të bllokojnë gjithçka", dhe Republika Srpska nën kontrollin rus po bën të njëjtën gjë, tha Konakoviç. "Sot, shumë Moska është e pranishme në Bosnje dhe Hercegovinë. Shumë Rusi në Ballkanin Perëndimor. Ky është një problem për të gjithë ne", paralajmëroi ai. Kreu i diplomacisë së BiH beson se Marrëveshja e Dejtonit duhet të "përditësohet", por se për këtë nevojiten të tre partitë dhe dy të tretat e parlamentit.

Takimi me Putin

I frymëzuar nga shtrëngimi i duarve me Putinin asokohe, Dodik deklaroi se shekulli i 21-të



do të ishte "shekulli i bashkimit të serbëve". Pra, RS jo vetëm që do të dalë nga Bosnja dhe Hercegovina, por do të bashkohet edhe me Serbinë. Një javë para takimit, rreth 7,000 serbë u mblodhën në Asamblesën Gjithëserbe në Beograd, vendas dhe ata nga Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut. Kjo asamble e lartë, e udhëhequr nga presidenti serb Aleksandar Vuçiç dhe presidenti i Republikës Srpska, Milorad Dodik, me pjesëmarrjen e qeverive, klerikëve, shkencëtarëve dhe figurave kulturore, synonte të gjente një përgjigje se si të "mbronin" serbët, gjuhën dhe kulturën e tyre dhe të siguronin mbijetesën. Megjithatë, nuk sqaroi se nga kush saktësisht serbët kishin nevojë për mbrojtje.

Synimet e Dodik

Për më shumë se një muaj, "mbrojtësit" e serbëve, duke

u përgatitur për kuvendin, përhapën pretendime të rreme se rezoluta e Asamblesës së Përgjithshme i "markon" serbët si një komb "gjenocidal", miratimi i saj do të "shkatërronte" RS-në, kultura dhe gjuha serbe ishin "kërcënuar". Kjo festë e nacionalizmit serb përfundoi me miratimin e Deklaratës për Mbrojtjen e të Drejtave Kombëtare dhe Politike dhe Ardhmërinë e Përbashkët të Popullit Serb me 49 objektiva. Dokumenti doli të ishte i çuditshëm, kontradiktor dhe, më e rëndësishmja, i rrezikshëm. Duket se të gjithë pjesëmarrësit ishin të kënaqur pasi bota serbe pothuajse u zyrtarizua, ose më mirë, filloi. Por jo Milorad Dodik. Në fund të fundit, as në Deklaratë dhe as në fjalime nuk kishte vend jo vetëm për thirrjet për shkëputjen e RS nga Bosnja dhe Hercegovina dhe bashkim-

in me Serbinë, por edhe për ndonjë mbështetje për këtë.

Rrezik për "Stuhia 2"

Megjithatë, Konakoviç beson se situata është më e mirë sot dhe se Bashkimi Evropian ka ndryshuar politikën e tij drejt zgjerimit, fatkeqësisht për shkak të sulmit rus ndaj Ukrainës. "Në dy vitet e fundit BE-ja ka qenë shumë më aktive në vend se sa në dy dekadat e fundit dhe kjo mundësi duhet të shfrytëzohet", theksoi ai. Përfaqësuesi evropian për dialogun ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, Miroslav Lajçak, u pajtua me të, duke thënë se BE-ja është "serioze për të ardhmen evropiane" të rajonit dhe se për këtë arsye po ndërmerr hapa konkretë në formën e një plani të ri të rritjes. flet për integrim gradual apo theksim te reformat. "BE po përgatitet të pranojë anëtarë të rinj nga Ballkani Perëndimor, gjë që nuk ishte rasti pesë vjet më parë", tha ai. Konakoviç tha se Kroacia luajti një rol kyç në vendimin e BE-së për hapjen e negociatave të anëtarësimit me Bosnjën dhe Hercegovinën në mars të këtij viti dhe se ai është krenar për marrëdhëniet midis Zagrebit dhe Sarajevës që kur ishte në pushtet. Në panel ka nxjerrë celularin edhe ministri e Jashtme e Kosovës, Donika Gërvalla-Schwarz, e cila ka treguar kopertinën e tabloidit serb Informer, pro-qeveritar në Beograd, ku shkruhet se "Kroatët po përgatiten për Stuhia 2".

Sulmi terrorist, Vuçiç paralajmëron arrestime

Presidenti serb Aleksandër Vuçiç tha se do të ketë arrestime pas sulmit përpara ambasadës izraelite në kryeqytetin Beograd. Një person në Beograd u qëllua për vdekje pasi sulmoi një pjesëtar policie me hark dhe shigjetë përpara ambasadës izraelite të shtunën. Vuçiç e quajti incidentin sulm terrorist plotësisht të paramenduar. Polici, i identifikuar si Millosh Jevremoviç, përdori armën e tij në vetëmbrojtje ndaj sulmuesit, i cili vdiq për shkak të plagëve të marra. Jevremoviç punon si roje e përhershme e sigurisë në ambasadë. Vuçiç tha se sulmi nuk erdhi si befasi, duke pretenduar se rezoluta e fundit e Asamblesës së Përgjithshme të OKB-së e miratuar muajin e kaluar, e cila caktoi 11 korrikun si ditë përkujtimore të gjenocidit të Srebrenicës, krijoi një objektiv në Serbi. Rezoluta, të cilën Vuçiç e kishte kundërshtuar më parë si shumë të politizuar, dënonte gjithashtu mohimin e gjenocidit të vitit 1995 në qytetin e Srebrenicës, ku muslimanët boshnjakë u vranë pavarësisht pranisë së trupave paqeruajtëse holandeze, ndërsa forcat serbe u përpoqën të push-tonin territorin. Presidenti serb tha gjithashtu, se autoritetet do të zgjidhin shumicën e aspekteve të çështjes deri të martën.

Lajçak: Autorët e Banjskës të mbajnë përgjegjësi

I dërguari special i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë-Serbi, Miroslav Lajçak, ka marrë pjesë në Samitin e Dubrovnikut, ku ishte edhe ministri e Jashtme e Kosovës, Donika Gërvalla. Kjo e fundit kërkoi të dinte qëndrimin e tij për sulmin në Banjskë dhe faktin se Milan Radoiçiq, po lëviz i lirë në Serbi. Lajçak tha se pozicioni i Bashkimit Evropian është i qartë, ku sipas tij, të gjithë ata që i kryen aktet kriminale në Banjskë të Zveçanit duhet të mbahen përgjegjës. "Pozicioni i BE-së ka qenë i formuluar dhe është i qartë që ata që i kanë kryer aktet kriminale në shtator të vitit 2024 duhet të mbahen përgjegjës. S'ka imunitet për ta dhe BE-ja e përsërit këtë edhe në takime bilaterale", tha Lajçak. Gjithashtu, ndihmës Sekretari amerikan i Shtetit, James O'Brien, tha se SHBA dhe Bashkimi Evropian presin, pasi sipas tij, u është premtuar që Radoiçiq të kalojë në një proces të plotë ligjor në Serbi. Nga ana tjetër, ministri e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Donika Gërvalla, në Forumin e Dubrovnikut, ka kritikuar qasjen e Bashkimit Evropian (BE) për sulmin terrorist në Banjskë të Zveçanit. Ministri Gërvalla ka thënë se atje ka ndodhur një akt i hapur agresioni kundër Republikës së Kosovës.

b o t e

SHBA prezanton Manta Ray, ja ç'mund të bëjë "bisha" e re nënujore

Javët e fundit, Shtetet e Bashkuara kanë prezantuar një dron të veçantë detar të zhvilluar posaçërisht për të forcuar mbrojtjen e tyre detare të vendosur në Paqësor. Quket Manta Ray, mund të përfaqësojë të ardhmen e luftës së nëndetëseve dhe është prodhuar nga Northrop Grumman. Një prototip i hershëm i UAV u testua disa herë në brigjet e Kalifornisë Jugore. Modulariteti dhe aftësia për të ndryshuar ngarkesën në varësi të misionit u

renditën ndër pikat e forta të tij. Tashmë kanë dalë zëra të tjerë që na lejojnë të kuptojmë më mirë "bishën" amerikane. Sidomos nga pikëpamja e madhësisë, duke qenë se disa imazhe satelitore kanë përjetësuar Manta Ray në një port, duke e bërë automjetin të ngajë me një lloj anije kozmike nga hapësira. Sajt The War Zone, për shembull, shkroi se modeli Manta Ray i përjetësuar në një port amerikan "duket si diçka që sapo u ul në Tatoonine", duke

aluduar në anijet kozmike që në sagën e filmit fantastiko-shkencor Star Wars u ulën në planet e Tatoonine. Imazhet satelitore të marra në nëntor 2023 dhe prill 2024 tregojnë dronin të ankoruar në bazën detare Port Hueneme, duke e bërë atë në të vërtetë të ngajë me një anije kozmike. Manta Ray u zhvillua nën një program të Agjencisë së Projekteve të Kërkimit të Avancuar të Mbrojtjes (DARPA), i fokusuar në demonstrimin e një kategorie

të re të platformave detare pa pilot me qëndrueshmëri shumë të gjatë, potencialisht të afta për të kryer një sërë misionesh të ndryshme. Hapësira e krahëve të dronit është afërsisht 45 këmbë dhe ka një gjatësi të përgjithshme prej 33 këmbësh në krahasim me atë që mund të shihet në të njëjtat foto. Për krahasim, automjeti nënujor Echo Voyager i Boeing (UUV), është 51 këmbë i gjatë dhe është gjithashtu shumë më i ngushtë.

Qëllimet e Kremlinit

Rusia nuk do ta përballonte dot aktivizimin e nenit 5, lufta e drejtpërdrejtë me NATO-n do të ishte katastrofike, ja si Moska po përdor agjentët e spiunazhit dhe sulmet hibride për të zhytur Evropën në kaos

Marsela SHYTIA

Kur dikush u përpoq, dhe dështoi, të digje një garazh autobusi në Pragë në fillim të këtij muaji, sulmi i pasuksesshëm i zjarrvënies nuk tërhoqi shumë vëmendje. Derisa, kryeministri çek Petr Fiala zbuloi se ishte "shumë e mundshme" që Moska qëndronte pas saj. Akuza nxiti alarmin midis zyrtarëve të sigurisë dhe qeverive, sepse disa incidente të ngjashme kanë ndodhur në të gjithë Evropën muajt e fundit. Muzeu i Pushtimit në Riga ishte shënjestër e një sulmi me zjarr në shkurt. Një magazinë në Londër u dogj në mars dhe një qendër tregtare në Varshavë u përfshi nga flakët në maj. Policia në Gjermani arrestoi disa persona të dyshuar për planifikimin e shpërthimeve dhe sulmeve me zjarrvënie në prill dhe autoritetet franceze nisën një hezim antiterror pasi arrestuan një prodhues të dyshuar të bombave, i cili u plagos në një shpërthim të dështuar në fillim të këtij muaji. Sulme të shumta hakerimi dhe incidente spiunazhi janë raportuar në vende të ndryshme evropiane. Në të njëjtën kohë, Bashkimi Evropian ka akuzuar Rusinë dhe Bjellorusinë për armatim të migracionit duke shtyrë azilkërkuesit nga vendet e treta në kufijtë e saj. Sulmet në dukje të rastësishme kanë një gjë të përbashkët: sipas zyrtarëve



lokalë, të gjithë janë të lidhur me Rusinë. Këto incidente përbëjnë atë që ekspertët e sigurisë thonë se është lufta hibride e Rusisë ndaj Perëndimit.

Frika e NATO-s

Rod Thornton, një lektor i lartë në studimet e mbrojtjes në King's College në Londër, tha se Rusia po përdorte një fushatë sabotimi si një alternativë ndaj një lufte të plotë me NATO-n, e cila do të ishte katastrofike për Rusinë. "Është prej kohësh një pjesë e doktrinës ushtarake ruse të përpqesh dhe të shmangësh përpjekjen për t'u përballur me NATO-n në një fushë beteje, sepse ata e dinë se do të humbin ndaj forcave të NATO-s," tha ai. "Ajo që ata po bëjnë është ndërmarrja e aktiviteteve që janë nën pragun e konfliktit të armatosur, kështu që ata nuk po nxisin një përgjigje të Nenit 5 nga NATO," shtoi ai. Neni 5 është parimi

themelor se një sulm ndaj një anëtarit të NATO-s është një sulm ndaj të gjithë anëtarëve. Është thirrur vetëm një herë – pas sulmeve terroriste të 11 shtatorit në SHBA nga Al Kaeda. Thornton tha se duke i mbajtur qëllimisht sulmet nën pragun e konfliktit të armatosur, Rusia shpreson të mbjellë më shumë ndarje brenda NATO-s, sepse nuk ka një plan se si të veprojë.

Krimi kibernetik

Shumica e sulmeve të zbuluara deri më tani kanë qenë relativisht të vogla, duke sugjeruar se qëllimi i Rusisë nuk është të shkaktojë dëmin më të madh të mundshëm sa të frikësojë popullsinë vendase. Shumë nga sulmet shoqërohen nga një fushatë dezinformuese e krijuar për të larguar fajin nga Rusia, thonë studiuesit. Kjo është shumë ajo që ndodhi pas sulmit të dështuar me zjarrvënie në Pragë, sipas

hulumtimit nga Elves Çeke, një grup aktivistësh vullnetarë që monitorojnë, analizojnë dhe luftojnë fushatat e dezinformimit që shfaqen në internetin çek. Fushatat e dezinformimit duket se shkojnë krah për krah me sulmet kibernetike. Shumë vende në të gjithë Evropën kanë pësuar sulme të mëdha gjatë muajve të fundit. Autoritetet në Finlandë dhe Estoni thanë se sinjali GPS po bllokohej rregullisht, duke shkaktuar ndërprerje në fluturimet. Megjithatë Thornton tha se këto incidente ka të ngjarë të jenë vetëm fillimi.

Nënvlërësimi i Rusisë

NATO prej muajsh ka paralajmëruar për sulmet jokonvencionale të Rusisë ndaj Perëndimit, duke thënë se Moska po përdor spiunazh, sulme kibernetike, ndërhyrje në zgjedhje, dezinformim dhe sabotim duke u përpjekur të destabilizojë bllokun dhe të dobësojë vendosmërinë e saj për të ndihmuar Ukrainën. Por deri vonë, liderët evropianë hezitonin të drejtonin gishtin drejtpërdrejtë në Kremlin. Sipas analistëve, Moska është trimëruar gjatë viteve të fundit, sepse rrallëherë është mbajtur përgjegjëse. Sipas tyre, Evropa dhe i gjithë komuniteti ndërkombëtar që dëshiron stabilitet global, ata duhet të kuptojnë se Rusia është në luftë me Evropën dhe se ata do të vazhdojnë të përshkallëzohen nëse nuk veprohet menjëherë.

Zelensky: Na duhen më shumë armë me reze të gjatë

Pasi një sulm raketor vrau shtatë persona, përfshirë dy fëmijë, presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky ka rinovuar apelin e tij për më shumë armë me reze të gjatë dhe mbrojtje ajrore për Ukrainën. Sulmi rus në qytetin e Vilniansk, pranë qytetit juglindor të Zaporizhzhia, plagosi gjithashtu 31 të tjerë, thanë zyrtarët ukrainas. Në total, të paktën 11 civilë u vranë dhe 37 të tjerë u plagosën në sulmet me raketa në të gjithë Ukrainën të shtunën, raportoi Reuters. "Qytetet dhe komunitetet tona vuajnë çdo ditë nga sulme të tilla ruse", shkroi Zelensky në një postim në Telegram. Por ai shtoi se kishte "mënyra për ta kapërcyer këtë", duke përfshirë "shkatërrimin e raketave ruse, goditjen me aftësi reale me reze të gjatë dhe rritjen e numrit të sistemeve moderne të mbrojtjes ajrore". Ai postoi imazhe nga Vilniansk që tregonin një krater të madh pranë një ndërtese që digjet si dhe disa trupa të shtrirë në tokë. Prokurori i Përgjithshëm i Ukrainës Andriy Kostin tha se dy raketa goditën qytetin, duke dëmtuar infrastrukturën, një dyqan dhe ndërtesa banimi. Ministria ruse e Mbrojtjes nuk e ka komentuar publikisht sulmin. Kostin tha gjithashtu se katër persona u vranë dhe shtatë të tjerë u plagosën.

ISIS ka vrarë mbi 4,000 njerëz në Siri për 5 vjet

Xhihadistët e organizatës Shteti Islamik (ISIS) kanë vrarë pothuajse 4,100 njerëz në territorin e Sirisë pasi humbën bastionin e tyre të fundit në atë vend në vitin 2019. Këto janë të dhënat e publikuara dje nga Observatori Sirian për të Drejtat e Njeriut. ISIS kishte kapur zona të gjera të Sirisë dhe Irakut në vitin 2014, duke e shpallur veten një "kalifat" dhe duke imponuar sundimin e tij me terror brutal, përpara se mbretëria e tij të shembej si një shtepi letrash në vitin 2019, nën sulme nga drejtime të shumta, nga SHBA dhe forcat aleate kurde. Pasi humbën territoret që mbanin, xhihadistët e mbetur u tërhoqën në shkretëtirën e madhe siriane, nga ku vazhdojnë të nisin sulmet vdekjeprurëse, duke synuar kryesisht ushtrinë siriane, por edhe forcat kurde. Anëtarët e ISIS-it kanë "vlarë rreth 4,100 njerëz në mbi 2,550 operacione" në zonat e kontrolluara si nga regjimi i Damaskut ashtu edhe nga vetëqeverisja gjysmë-autonome kurde që nga viti 2019, sipas një rrjeti të gjerë joqeveritar me bazë në Britaninë e Madhe. Shumica e viktimave i përkisnin forcave ndërluftuese, ose ushtrisë dhe ndihmësve të saj, ose fraksioneve të udhëhequra nga kurdët por numri përfshin gjithashtu të paktën 627 civilë.

b o t e

Përparim në lindje, rusët pushtojnë dy fshatra të tjerë ukrainas, ja cili është plani

Rusia tha dje se kishte marrë nën kontroll dy fshatra të rinj në Ukrainën lindore, të vendosura në sektorë të ndryshëm të vijës së frontit. Ministria e Mbrojtjes deklaroi në raportin e saj të përditshëm se forcat ruse kishin marrë vendndodhjen e Spirna-s, jo shumë larg qytetit të Luhansk, i cili tashmë është nën kontrollin e Moskës. Novooleksandrivka, afër Otçeretinës, u kap gjithashtu. Fakti që të dy vendet janë të vendosura

në zona të ndryshme të vijës së frontit ilustron përpjekjen gjithëpërfshirëse të palës ruse për të kapur të gjithë Donbasin, zonën industriale të Ukrainës ku po zhvillohen luftimet kryesore. Në prill të këtij viti, Ukraina miratoi një ligj që i lejon asaj të rekrutojë 25 dhe 26-vjeçarë. Më parë, ajo mund të kishte vetëm 27 vjeç e lart. Ata që nuk i përgjigjen thirrjes së ushtrisë mund të humbasin patentën e shoferit dhe shteti mund të

ngrijë llogaritë e tyre bankare dhe t'u konfiskoje pronën. Të shtunën, trupat ruse pushtuan umi, jo shumë larg qytetit minerar Toretsk. Rusia po fiton ngadalë terren pas kundërsulmit të dështuar të Ukrainës verën e kaluar dhe rënies së Avdiivka në shkurt. Ukraina po përballet me mungesë rekrutësh dhe armësh për shkak të vonësive perëndimore në dërgimin e armëve dhe municioneve. Në fillim të


majit, Rusia nisi një ofensivë në Kharkiv, në Ukrainën verilindore, dhe shpejt mori disa pozicione, përpara se përforcimet të mbërrinin në Ukrainë dhe të ndalonin përparimin rus. Sakaq, edhe numri i sulmeve raketore të Moskës në qytetin e Vilniansk, në rajonin e Zaporizhzhia, gjithashtu u përkeqësua. Guvernatori i rajonit Ivan Fedorov foli për shtatë vdekje, duke përfshirë tre fëmijë dhe 36 të plagosur.

Parashikimi i republikanëve

Demokratët në panik, Biden mund të largohet në fund të verës, pse tërheqja e tij do të shkaktonte kaos në SHBA, ja kush do të përballej me Trump nëse presidenti heq dorë nga gara

Marsela SHYTIA

Mëngjesin pas performancës katastrofike të debatit nga presidenti Joe Biden, editoriale dhe opinione u shfaqën nëpër platformat kryesore të lajmeve si kërpuhda, duke i kërkuar Bidenit t'i jepte fund ofertës së tij për rizgjedhje. Një nga ato që mori më shumë vëmendje u shkrua nga kolumnisti i "New York Times", Thomas Friedman. Friedman është me ndikim, mik me Biden dhe shpesh mbështet qëllimet politike të administratës së Bidenit. Performanca ka qenë një temë diskutimi kudo. Shumë janë duke pritur me ankth raundin e parë të madh të sondazheve publike pas debatit për të përcaktuar hapat e tyre të ardhshëm. Sondazhet nga CNN dhe 538/Ipsos të kryera menjëherë pas debatit zbuluan se shumica e vëzhguesve të debatit mendonin se Trump ia kalonte Bidenit. Por vlerësimet e favorizimit të dy burrave mbetën kryesisht të pandryshuara, ashtu siç bëne pas dënimit të Trump mbi akuzat në Nju Jork se ai mori pjesë ilegalisht në një skemë të parave të heshtura për të ndikuar në zgjedhjet e 2016-ës. Ndërsa një pjesë ka kritikuar performancën e Joe Biden kundër Donald Trump, të tjerët po pyesin se çfarë do të ndodhte nëse Biden vendos të largohet si flamurtar i partisë në minutën e fundit.



Largimi i Biden

Nëse Joe Biden tërhiqet, delegatët nga 50 shtete do të duhet të kërkojnë një zëvendësues sa më parë. Ata me shumë gjasa do të mbledhen për një konventë nominuese dhe do të emërojnë zyrtarisht një kandidat. Kandidati zgjidhet në bazë të votimit. Zëvendës-presidentja Kamala Harris, Guvernatori i Kalifornisë Gavin Newsom, Guvernatori i Michiganit Gretchen Whitmer dhe Guvernatori i Pensilvanisë Josh Shapiro janë ndër emrat që mund të përfaqësojnë partinë. Ndërkohë, senatori amerikan Ted Cruz (R-Texas) ka parashikuar se ish-Zonja e Parë Michelle Obama do të zëvendësojë Joe Biden. Duke folur në podkastin e tij, Cruz tha: "Shanset janë rreth 80% që Partia Demokratike do të heqë Joe Biden dhe do ta zëvendësojë atë me Michelle Obama sepse Biden performoi kaq katastrofë

sonte sa demokratët në të gjithë vendin janë në rënie të plotë dhe të lirë dhe panik i plotë." Kjo ka ndodhur më parë, në vitin 1968, kur Presidenti Lyndon Johnson tronditi kur vendosi të largohej. Ai e bëri njoftimin në mes të Luftës së Vietnamit.

Skenari katastrofik

Demokratët amerikanë janë të detyruar të "kapen" pas presidentit. "Joe Biden do të jetë kandidati demokrat, pikë. Fundi i historisë. Votuesit kanë votuar. Ai fitoi me shumicë dërrmuese". Kjo është përmbytja e një emaili dërguar mbështetësve nga zëvendës-drejtori i fushatës zgjedhore të presidentit amerikan, Rob Flaherty, pas performancës kontroverze në duelin e parë televiziv me Donald Trump përpara zgjedhjeve. "Nëse Biden do të tërhiqet - thekson Flaherty - kjo do të çonte në javë të tëra kaosi, grindjesh të

brendshme dhe kandidatët që luftojnë në një përleshje brutale në skenën e konventës, ndërsa Donald Trump do të kishte kohë të fliste, i pakundërshtueshëm, me votuesit amerikanë". E gjithë kjo, vazhdon ai, "do të ishte në shërbim të një kandidati që do të hynte në zgjedhjet e përgjithshme në pozicionin më të dobët të mundshëm me zero dollarë në llogarinë e tij bankare".

Parashikimi i republikanëve

Sipas Steve Bannon, ish-këshilltarit të Trump, "një fitore dërrmuese" pritet në nëntor për ish-republikanin. "Ne jemi të sigurt se mund ta mposhtim Bidenin. Dhe ne do ta mposhtim atë, do të marrim Senatin dhe vendet në Dhomë," tha Bannon në një intervistë. Pavarësisht besimit të Bannon se Trump dhe republikanët do të jenë fitimtarë në nëntor, disa nga parashikimet e tij të mëparshme zgjedhore kanë dalë të gabuara. Në vitin 2018, Bannon tha se ai priste që republikanët do të kishin "një fitore befasuese" dhe "do të drejtonin tavolinat në Dhomën e Përfaqësuesve". Por në vend të kësaj, demokratët morën 40 vende. Bannon tha edhe se ai nuk beson se Trump duhet të pranojë të debatojë sërish për Bidenin, por në kohën kur të vijë debati i dytë presidencial në fund të shtatorit, "ai nuk do të jetë aty", duke shprehur sigurinë se Biden do të largohet.

Vijojnë protestat në Tel Aviv, kërkohet lirimi i pengjeve

Mijëra protestues u mbledhën në Tel Aviv për të kërkuar që qeveria izraelite të bëjë më shumë për të siguruar lirimin e pengjeve që ende mbahen nga Hamasi në Gaza. Me fotot e disa prej izraelitëve të zënë rob gjatë agresionit të Hamasit në Izrael tetorin e kaluar, ata kërkonin lirimin e të afërmeve të tyre. Protestuesit kanë kërkuar gjithashtu një armëpushim të menjëhershëm për t'i dhënë fund më shumë se tetë muajve të luftimeve në Gaza, të cilat kanë vrrarë pothuajse 38,000 palestinezë dhe të paktën 318 ushtarë izraelitë. Megjithatë ka edhe një element të fortë anti-qeveritar në demonstratat javore me shumë protestues që kërkojnë që kryeministri Benjamin Netanyahu të thërrasë zgjedhje të reja dhe të japë dorëheqjen. Disa e akuzojnë atë se i jep përparësi mbijetesës së tij politike mbi jetën e pengjeve izraelite. "Vazhdimi i kësaj lufte nënkupton vrasjen e pengjeve nga qeveria izraelite. Gjaku është në duart tuaja. Herë pas here, Netanyahu e ka sabotuar këtë marrëveshje në momentin e së vërtetës, duke u mburrur me zërin e tij ose përmes një qeverie pa emër. zyrtar, duke thënë se ai nuk do të pranojë t'i japë fund luftës, nuk duhet lejuar që të sabotojë këtë marrëveshje", tha Snir Daan.

Laburistët drejt fitores, në Britani pritet rotacion politik

Deri të enjten e ardhshme, do duhet të ndodhë diçka e jashtëzakonshme nga ata që mendohet se do fitojnë zgjedhjet, laburistët që t'i humbasin ato, siç sugjerojnë me kokëfortësi sondazhet e deritanishme të opinionit publik në Britaninë e Madhe. Këto zgjedhje mund t'i humbasin vetëm laburistët e opozitës, nëse gabojnë vetë, pasi konservatorët në pushtet që prej 14 vjetësh, duket se kanë humbur shpresën se do mbijetojnë me tej në pushtet. Edhe pas debatit të fundit mes kryeministri Sunak dhe kryeministrit në hije, Sir Kier Starmer, debat që rezultoi pa fituar, 50-50, faktikisht diferenca mes partive kryesore konservatoreve dhe laburistëve, është me rreth 20 përqind, çka do të thotë një shumicë parlamentare prej mbi 200 deputetesh me shumë për laburistëve të opozitës, që ish kryeministri Boris Johnson e quan Starmagedon electoral, fitoren e udhëheqësit të opozitës Sir Kier Starmer. Halli më i madh për konservatorët, partia më e vjetër politike në Britani dhe e dyta më e vjetra në botë, është kërcënimi që u vjen nga krahu akoma me i djathtë se ata në politiken britanike, pikërisht partia "Reforma" ose ish-partia e Brexit e cila ka sërish në krye të saj babain e saj, Nigel Farage.

b o t ë

www.sot.com.al

Irani shkon në balotazh, ja cili kandidat ka më shumë gjasa të bëhet president

Irani shkon në balotazhin presidencial midis kandidatit reformist Massoud Pezeshkian dhe ultra-konservatorit Said Jalili, të cilët mund të pasojnë Ebrahim Raisin. Sipas raporteve të pjesshme të publikuara nga Ministria e Brendshme iraniane, asnjë kandidat nuk ka marrë më shumë se gjysmën e votave dhe politikani azerbajxhanas që mbështet detentimin me SHBA dhe kryenegociatorin bërthamor do të përballen me njëri-tjetrin në

raundin e dytë, i cili do të mbahet më 5 korrik. Nga 14 zgjedhjet presidenciale të mbajtura që nga Revolucioni Islamik i vitit 1979, vetëm një deri më tani është vendosur në raundin e dytë, në vitin 2005. Nga 19 milionë fletëvotime të numëruara, Pezeshkian kishte marrë 8,30 milionë vota dhe Jalili, 7,19. Të dy janë dukshëm përpara presidentit të Parlamentit, konservatorit Mohamad Baquer Ghalibaf, me 2.68 milionë vota. Shumë më

tej ishte kandidati i katërt, Mostafa Pourmohammadi, i vetmi fetar në garë, i cili mori vetëm 158,314 vota. Megjithatë, pati rekord negativ për sa i përket pjesëmarrjes: vota regjistroi një pjesëmarrje prej vetëm 40% të atyre që kishin të drejtë vote, pothuajse 9 pikë më pak se ato të mëparshmet në vitin 2021 dhe më e ulëta që nga themelimi i Republikës Islamike në vitin 1979. Dje autoriteti më i lartë i Republikës Islamike, Aya-

tollah Ali Khamenei, i kishte ftuar votuesit që "ta marrin seriozisht votimin dhe të marrin pjesë në të". Kundërshtarët, veçanërisht ata nga diaspora, në vend të kësaj bënë thirrje për bojkot të votimeve. Autoritetet shpresonin për pjesëmarrje të fortë, ndërsa zgjedhjet presidenciale të vitit 2021, për të cilat asnjë kandidat reformator apo i moderuar nuk ishte lejuar të konkurronte, u shënuan me abstencion rekord.

■ Pjesëmarrje rekord në votime

Dështon sërish Macron, e djathta ekstreme "mbretëron" në Francë, sondazhet favorizojnë Le Pen, shpresa e fundit e presidentit është 7 korriku, ja truku i socialistëve për të sabotuar fitoren e RN

Marsela SHYTIA

Partia Rassemblement National (RN) e ekstremit të djathtë ka fituar raundin e parë të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në Francë, sipas sondazheve të para, të publikuara menjëherë pas mbylljes së qendrave të votimit. Sipas një sondazhi të publikuar nga rrjeti francez TF1, RN ka marrë 34.5% të votave, me aleancën e kraut të majtë të mbledhur me ndërkohë Fronti i Ri Popullor (NPF) pas me 28.5% dhe blloku i Ansambllit qendror të Presidentit Emmanuel Macron nga i dyti me 22.5%. Qendrat e votimit u hapën në orën 6 të mëngjesit me kohën lokale dhe u mbyllën në orën 18:00 në qytetet më të vogla dhe 20:00 në qytetet e mëdha. Macron thirri zgjedhjet e parakohshme më 9 qershor si përgjigje ndaj fitimeve të mëdha të RN në zgjedhjet evropiane, në të cilat 373 milionë qytetarë nga 27 vende që i përkasin bllokut të Bashkimit Evropian votuan për parlamentin e tij evropian prej 720 vendesh. Pjesëmarrja franceze në atë sondazh ishte më pak se 50% e elektoratit, por Macron tha se rezultati përbënte "një rrezik" për Francën. Ai mendonte se nuk mund të sillej sikur asgjë të mos kishte ndodhur dhe për këtë arsye po e kthente topin në fushën e popullit francez me zgjedhje të përgjithshme.

Pjesëmarrje rekord

Ai ka lëshuar një nga zgjedhjet më vendimtare në Francë që nga Lufta e Dytë Botërore, duke vënë përballë një bllok të kraut të djathtë kundër emigrantëve, ligjit



dhe drejtësisë të udhëhequr nga RN kundër një aleance të nxituar të kraut të majtë. Në orën 17:00 me orën lokale, Ministria e Brendshme njoftoi shkallën e pjesëmarrjes prej 59.39%, 20 pikë përqindjeje më e lartë se raundi i parë i zgjedhjeve presidenciale në 2022. Grupet e sondazheve sugjerojnë se kjo do të jepte një normë eventuale midis 67.5% dhe 69.7%, që do të ishte një nga pjesëmarrjet më të larta në historinë e fundit të zgjedhjeve franceze. Francezët votuan për 577 anëtarët e asamblesë së përgjithshme ose parlamentit të vendit. Ai do të pasohet nga një raund i dytë më 7 korrik, për vendet ku nuk ka shumicë të qartë, ku fitues do të jetë kandidati me më shumë vota.

E ardhmja e Macron

Cilido qoftë rezultati i zgjedhjeve, Macron mund të qëndrojë si president deri në skadimin e mandatit të tij në vitin 2027, dhe ai ka thënë se nuk do të japë dorëheqjen. Por një fitore e Rally Kombëtare, me koalicionin e Macron që mund të bjerë në vendin

e tretë, është një humbje e madhe për liderin 46-vjeçar, duke i dhënë fund eksperimentit të tij politik pro-Evropës dhe pro-biznesit. Nëse RN fiton një shumicë, Macron do të duhet të ndajë pushtetin me Bardella 28-vjeçare dhe nuk do të jetë në gjendje të bëjë shumë për të parandaluar miratimin e ligjeve nacionaliste të miratuara nga Parlamenti. Përndryshe, nëse zgjedhjet rezultojnë në një parlament të varur, do të jetë e vështirë të arrihet shumë nga çdo gjë. Edhe aleatët e Macron kanë shprehur zhgënjim të thellë, duke thënë se shpërbërja e Parlamentit erdhi në kohën më të keqe të mundshme.

Reagimet

Ndërkohë sekretari i parë i Partisë Socialiste Franceze, Olivier Faure, duke komentuar rezultatet e para të raundit të parë të zgjedhjeve legislative, deklaroi se do të tërheqë kandidatët sapa të ketë rrezik për një fitore të Kuvendit Kombëtar. "Është një rezultat historik. Për herë të parë e djathta ekstreme mund të

qeverisë", nënvizon Faure në TF1. "Pyetja që i bëjmë vetes është: a u japim atyre kompetenca të plota apo jo?", pyeti Faure. "Pozicioni i socialistëve është jashtëzakonisht i qartë: nuk do të ketë askund një kandidat për sa kohë që ekziston rreziku për të zgjedhur një kandidat të ekstremit të djathtë. Nuk do të ketë përjashtim," shtoi ai.

Reziqet për Francën dhe BE

Franca është një nga anëtarët fillestarë të Bashkimit Evropian, ekonomia e saj e dytë më e madhe dhe një forcë shtytëse në çështjet e BE-së. Partia RN nuk kërkon më largimin nga blloku, por shumë nga propozimet e saj janë në kundërshtim me politikën e BE-së. Një Francë më euroskeptike mund të pengojë bashkëpunimin franko-gjerman, të minojë integrimin dhe në përgjithësi ta bëjë më të vështirë politikbërjen. Një shqetësim tjetër është se si një fitore e ekstremit të djathtë mund të ndryshojë politikën e unionit në Ukrainë. Le Pen tashmë po sfidon qëndrimin e Macron në politikën e jashtme dhe mbrojtjen franceze, duke sugjeruar që presidenti të luajë një rol më nderi si komandant i përgjithshëm i forcave të armatosura. "Çfarë arrogance!" tha Macron të premten në Bruksel, duke reaguar ndaj komenteve të Le Pen në një intervistë për gazetën Le Télégramme që u botua një ditë më parë. Politikantët e ekstremit të djathtë flasin "sikur të ishin tashmë atje" në qeveri, tha ai, raportojo Associated Press. "Por francezët nuk kanë zgjedhur ende", tha ai. Tani zgjedhjet dhe Macron mesa duket nuk do të jetë aspak i kënaqur.

SHBA dhe BE thirrje Hezbollahun: Tërhiq!

Ndërmjetësuesit amerikanë, evropianë dhe arabë po ushtrojnë trysni për të mos lejuar që sulmet e përshkallëzuara ndërkufitare mes Izraelit dhe militantëve të Hezbollahun në Liban të kthehen në një luftë më të gjerë në Lindjen e Mesme, të cilës bota i druhet tashmë prej disa muajsh. Shpresat po shuhën për një armëpushim mes Izraelit dhe Hamasit në Gazë, gjë që do të çonte në uljen e sulmeve të Hezbollahun dhe aleatëve të tjerë të Iranit. Duke patur parasysh një gjë të tillë, zyrtarë amerikanë dhe evropianë po i dërgojnë mesazhe paralajmëruese Hezbollahun, grup që është treguar se është më i fuqishëm se Hamasi, që të mos sulmojë ushtrinë e fuqishme izraelite, thonë diplomatët të ndryshëm. Ata po paralajmërojnë se Hezbollahu duhet të marrë parasysh faktin se Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ose edhe ndonjë vend tjetër, nuk do të jenë në gjendje të frenojnë udhëheqësit izraelitë nëse vendosin të zbatojnë planet, tashmë të përgatitura, për një ofensivë në Liban. Intensiteti i sulmeve mes Izraelit dhe Hezbollahun u duk se ra javën e kaluar. Por një ish-diplomat amerikan në Lindjen e Mesme thotë se izraelitët duket se ende po përgatiten në rast "se konflikti mund të marrë përmasa të tjera" së shpejti.

Rusia bën bilancin: Shkatërruar 30 dronë ukrainas

Forcat ruse kanë shkatërruar mbi 30 dronë të Ukrainës në zonën afër kufirit, tha Ministria ruse e Mbrojtjes ditën e djeshme. "Sistemet e mbrojtjes ajrore shkatërruan 15 dronë mbi rajonin Kursk, nëntë mbi Lipetsk, nga katër dronë mbi rajonet e Voronezhit dhe Brijanskut dhe nga dy mbi rajonin e Orjolit dhe Belgorodit", tha ministria ruse në një postim në Telegram. Guvernatori i Voronezhit, Aleksandar Gusev, shkroi po ashtu dje në Telegram, se forcat ajrore kanë shkatërruar "disa dronë ukrainas", duke shtuar se nuk raportohet për viktima apo dëme materiale. Të dyja palët përdorin dronë gjatë agresionit të paligjshëm, që Rusia nisi kundër Ukrainës në shkurt të vitit 2022. Gjatë këtij viti Ukraina ka intensifikuar sulmet e saj në territorin rus, duke shënjestruar edhe ndërtesat e energjisë që thotë se furnizojnë ushtrinë ruse, por edhe qytetet dhe fshatrat në rajonet kufitare. Presidenti rus, Vladimir Putin, muajin e kaluar nisi një ofensivë të re tokësore në rajonin verilindor ukrainas të Harkivit. Ai tha se me këtë operacion synon të krijojë një "zonë të ndalimit" dhe të shtyjë prapa forcat ukrainase në mënyrë që të mbrojnë rajonin kufitar rus të Belgorodit nga granatimet e Ukrainës.

k r o n i k ë

Shumë nga personazhet e botës së krimit që kanë përdorur aplikacionin "Sky" janë maskuar përmes kodeve

Nga Ervis Martinaj tek Pëllumb Gjoka, ja gafat e "të fortëve" që sollën identifikimin e tyre në "SKY", zbardhen detaje nga dosja e SPAK

Shumë nga personazhet e botës së krimit që kanë përdorur aplikacionin "Sky" janë maskuar përmes kodeve dhe nofkave të vendosura, por sërish ata janë treguar të pakujdesshëm në komunikimet që kanë kryer me njëri-tjetrin. Disa kanë pasur një zhdërvjelltësi të plotë në kryerjen e bisedave, ndërsa disa të tjerë janë siguruar mirë, por sërish një gabim i vetëm ka sjellë zbulimin e plotë të tyre. Në dhjetëra e dhjetëra biseda, figurat e botës së krimit janë kujdesur të mos zbulohen por koha kaloi dhe ata filluan të bëjnë gabime në aplikacionin "Sky", pasi kanë ndërë një siguri të tepruar se ky aplikacion nuk do përgjohej ndonjëherë nga autoritet shqiptare. Por koha e solli që aplikacioni u zbrërthe nga autoritet Francese dhe Belge, duke sjellë dhe shpërndarjen e bisedave. Ervis Martinaj, njeriu më i kërkuar i Drejtësisë Shqiptare dhe njëherësh personi me fatin më mister rreth ekzistencës ose jo të tij, është zbuluar nga një mesazh i vetëm ngushëllimi. Shkodrani Bardhyl Mavraj me përdorues "2Q4RSM" i shkruan në 18 shkurt përdoruesit të kodit "NP8LS4": "...si je shok a je mirë, mora vesh për nusen e axhës. Ngushëllimet e mija, zoti ju forcoftë..." Ndërsa nga ana tjetër kodit "NP8LS4" i përgjigjet shkurt "...flm...". Nga verifikimet që ka kryer prokuroria e Posaçme SPAK dhe nga informacionet e siguruar në rrugë operative nga policia gjyqësore, Bardhyl Mavraj dhe Behar Brajoviq në këtë periudhë, ka pasur kontakte dhe bashkëpunim me biznesmenin Ervis Martinaj, shkruan "Ora News".

Verifikimet

Nga ana e SPAK është bërë verifikimi i Gjendjes Civile të Ervis Martinaj, babait të tij Mustafës dhe xhaxhait të Ervisit, Faik Martinaj. Sipas SPAK, Faik Martinaj ka qenë i martuar me Z.Martinaj, e cila ka nderuar jetë në 13 shkurt 2021. Z..., është gruaja e xhaxhait "axhës" së biznesmenit të lojërave të fatit Ervis Martinaj. Nisur nga ky verifikim por dhe nga përmbajtja e bisedave të tjera, me kontekst se bisedat për kryerjen e takimeve lireshin tek hotel "Arbëria" në Kurbin, SPAK ka krijuar bindjen e plotë se përdoruesi i kodit "NP8LS4" i përket përdoruesit, Ervis Martinaj. Një tjetër kod që ka folur zbuluar totalisht dhe ka qenë më i lehti për tu identifikuar nga SPAK, është ai me emrin "Alkatraz". Në fakt ky emër personifikon një nga burgjet më të egra në San Francisco të Amerikës. Përdoruesi i këtij kodit ka qenë më trimi, pasi fliste hapur dhe mburrej që ishte Nuredin Dumani. Mburja dhe identifikimi i tij, pasqyrohet jo vetëm tek emri i koduar "Alkatraz" por edhe



tek përdorimi tjetër i emrit të koduar "Toto Rinaa". Në 14 shkurt 2021, mbrëmjen e "Shën Valentinit" Bardhyl Mavraj bisedon me përdoruesin e kodit "XNLTP" "Alkatraz", ku ky i fundit i shkruan: "...vlla dua të them një fjalë për besnikrin time mos e ver dyshim koha tregon. Z'dua as ti t'jesh siklet, unë quhem Nuredin Dumani, "Luli" më njoftin datëlindja 1987/26/04...Dua të rrih i qet për çdo gjë, s'jam ke fjalët pork e veprat, zdo zhgënjehesh se unëboj ndrim...". Nga ana tjetër Bardhyl Mavraj i përgjigjet duke shkruar se: "...qosh me jetë vëlla, ishalla vetëm mir dëgjoj për ty por është kjo që nëse bahena me ba punë dhe me nimu njëri-tjetrin, s'do zhgënjehesh as ti. Për sa i përket ati Talos, të them unë personalisht skam asnjë info dhe se njof fare se smë ka pas interesu, por me pyt miq e shokë mase dhe na del diku, por konkrete është puna e këtij Dorit që folëm...". Pikërisht duke parë këtë përmbajtje, SPAK ka verifikuar të dhënat e Nuredin Dumani në Gjendjen Civile, ku rezultoi se ditëlindja e tij përputhet dhe me përmbajtjen e tekstit. Ndërsa Klaudor Haka, njeriu që vrojtonte për të vrrarë Kleanth Musabelliu është identifikuar nga një moment i vetëm, kur një skuadër e "Shqiponjave", e kanë arrestuar me një pistoletë në trup.

Kodet

Klaudor Haka, ka përdorur kodin C5FFC8 dhe në një moment në 16 korrik 2020 ai i dërgon një foto Pëllumb Gjokës, e cila tregon rrugën "Teodor Rusvelt" dhe orjenton në lidhje me banesën e mundshme të një personi që po vëzhgon. Në vazhdimësi Klaudor Haka, i shkruan Gjokës: "...kam një favor se jam në lagjen time dhe një xhiro me bo, kam 2-3 veta që i përshëndes...". Por teksa mundoheshin dhe bënin planin për të vrrarë Kleanthin, në 24 shtator 2020 Behar Bajri i shkruan Pëllumb Gjokës, duke i thënë: "...e kanë kapur Dorin me armë, a thu kemi mundësi me ja thy gjëlpanën... e kanë kap në

Tiranë tek "Liqeni i Thatë", postoblllok tek 1...". Nga ana tjetër Pëllumbi i shkruan Beharit: "...e kanë kap "Shqiponjat", ja kanë ba fotot sa e kanë kap...". SPAK, ka verifikuar dokumentet në komisariat Nr.1 në Tiranë, duke konstatuar se personi që është arrestuar nga policia në datën 24 shtator 2020 është Klaudor Hakaj. Nga ana tjetër Olti Bistri, është identifikuar gjatë një bisede që ka zhvilluar me Pëllumb Gjokën, duke i pohuar këtij të fundit se ndodhet jashtë shtetit pasi kishte marrë disa ditë lejë. Nga verifikimet e SPAK, rezultoi se Olti Bistri ka marrë lejë në muajin Mars në Drejtorinë e Policisë për të shkuar në Athinë. Kurse vetë biznesmeni Pëllumb Gjoka, i cili ka përdorur kodin "7142D9" është identifikuar nga vajza e hallës së tij, Lulë Zefi. Në të njëjtë bisedë është identifikuar dhe Ardit Hasanbegaj, i cili në datën 16 shkurt 2020 mbante postin e zv/drejtorit të Policisë Shkodër dhe përdorte kodin "DGLXJM". Në 16 shkurt 2020 Hasanbegaj i shkruan kodit 7142D9 duke i thënë: "...shoku, për një tokë në emrin tënd, ka ardhur një femër seç ka bërë një letër ankohej. Ishte ankuar lart dhe na çuan neve, por pa merak se tek mua vjen. Është vajza e një gruaje që ka bërë kontratë toke të një sipërfaqe 100 dynym, me sa më kujtohet. Ja kanë marrë nënës me mashtrim dhe mua që ankohej më kanë gjuajtur disa herë dhe kanë dashur të më vrasin. Dhe e kishte me ty. Është e martuar në Laç...". Kurse përdoruesi i kodit 7142D9 ia ka kthyer si më poshtë vijon: "...vëlla a është vajza e hallës time, është e çmendur, është e çmendur për zotin...". Por "DGLXJM" mes të tjerave i shkruante se: "...ti je në rregull, një të trembur 100 dynym, ç'të duhet. I ke futur edhe lejen e resortit tani, na lerë ne fukarenjve...". Nga verifikimet e kryera nga SPAK ka rezultuar se personi që kishte shkuar të bënte kallëzimin në policinë Shkodër, është pikërisht Lulë Zefi, e cila është vajza e hallës së biznesmenit Pëllumb Gjoka.

Tritol në makinë, plagoset vëllai i kreut të bandës së Mirditës, prej 20 vitesh asnjë gjurmë prej tij, në 2000 u dënua përjetë për vrasjen e një polici

Një 47-vjeçar në Mirditë mbeti i plagosur, pasi u sulmua me lëndë plasëse. Ngjarja ndodhi mëngjesin e së dielës në fshatin Malaj, ndërsa në shënjestër ishte Lodovik Syziu 47-vjeç, vëllai i kreut të bandës së Mirditës, Dritan Syziu. Lënda plasëse ishte vendosur në pjesën e pasme të automjetit të parkuar pranë banesës së 47-vjeçarit dhe shpërtheu sapo ky i fundit ndezi makinën. Nga shpërthimi Lodovik Syziu mori frakturë në disa pjesë të trupit dhe u dërgua me urgjencë për ndihmë mjekësore në Spitalin e Rrëshenit, nga ku mësohet se ndodhet nën kujdesin e bluzave të bardha jashtë rrezikut për jetën. Autorët dhe motivet e ngjarjes ende nuk dihen, por policia po heton në dy pista, të shkuarën kriminale të vëllait, por edhe ndonjë konflikt të 47-vjeçarit me banorë të zonës. Në dëshminë e parë të dhënë pasi ka marrë ndihmën mjekësore, Ledovik Syziu ka deklaruar se nuk ka asnjë dijeni për autorët apo shkaqet, por ndërkohë janë thirrur për t'u marrë në pyetje edhe familjarë të tij me qëllimin për të mësuar për ndonjë incident që mund të ketë patur i plagosuri. Por kush është Dritan Syziu? Dritan Syziu, njëhej ndryshe edhe si kreu i bandës së Mirditës i dyshuar si autor i disa ngjarjeve në Mirditë në vitin 1997, ndërsa prej tij prej gati rreth 20 vitesh nuk ka asnjë gjurmë. Syziu është dënua me burgim të përjetshëm pasi për një ngjarje që ka ndodhur më 28 qershor të vitit 2000, ku mbeti i vrrarë punonjësi i policisë, Gjon Paçuku. Këtë vrasje ai e ka kryer në bashkëpunim me 5 persona të tjerë. Por si ndodhi vrasja? Ishin orët e para të mëngjesit të 28 qershorit të vitit 2000 kur 6 të pandehurit e bandës së Mirditës, Dritan Syziu, Nikollë Syziu, Bardhok Syziu, Tonin Gjoka e Arjan Reçi vendosën që të grabisnin disa pjesë këmbimi për makina të një parkingu pranë ish-SMT-së së qytetit. Autorët pikasën nga roja dhe ky i fundit njofton Policinë. Menjëherë në vendngjarje erdhën efektivat e policisë, të cilët mendonin se kishin të bënin me një vjedhje modeste. Pasi kanë parkuar makinën jashtë ish-SMT-së, u kanë kërkuar anëtarëve të bandës që të dorëzohen. Por autorët kanë qëlluar me armë në drejtim të Policëve dhe aty mbeti i vrrarë efektiv Gjon Paçuku dhe u plagosën Nikollë Marku, Bardhosh Jaku e Ndue Çupi.

k o m e n t e & a n a l i z ë

www.sot.com.al

Sa s'është ende vonë... !

Nga Gjon NEÇAJ

N e do të na duhet të përballojmë të duhet mjaft vështirësi, të pësojmë edhe dështimet, shkruan Nazim Hikmet. Mendojmë se forcat politike në pushtet duhet të përcaktojnë dualitetin shtet-pushtet, në zbatim të ligjeve kushtetuese. Demokracia të mos prodhojë konflikte të panevojshme mes politikanëve, pushtetarëve dhe partive, por me vizionin përcaktues të hartojnë strategji të reja për zbutjen e varfërisë, që kurba e papunësisë të ulët, dëshirojmë që të ketë energji elektrike dhe ujë për çdo ditë, të ketë sa më pak sharje në Parlament e sa më shumë të ardhura për të varfrit, drejtësi për të gjithë, të mos ketë vrasje, vetëvrasje, krizma tritoli, kërcënime, përdhunime, as keqpërdorime dhe bindjet politike të mos përdoren për interesa të ngushta vetjake siç ka ndodhur dhe ndodh rëndom. Duke dialoguar me vetveten, deshifroj thënien e një rilindasit tonë të madh, se Shqipëria është

e shqiptarëve, e të gjithë jemi përgjegjës ndaj atdheut, ndaj kombit. Secili prej nesh ka një pjesë fajësimi që t'i nderojmë njësoj heronjtë e kombit, të kemi ekonomi të intensifikuar, tokë sa më shumë të punuar, pyje të gjelbëruara, ara të punuara, lumenj të pastër dhe një Shqipëri kryezonjë siç e kanë ëndërruar rilindasit këtu e para një shekulli. Milionat e eurove, duart e mbushura me orë të florinjta, zinxhirë, varëse qafe të gjyqtarëve, pushtetarëve e kuadrove drejtues të shtetit, po kaluam infinitin e përsëritur të korrupsionit, sovranit do të kthehet idhshëm ndaj tyre e do ua zënë frymën me varëset milionëshe të këtyre njerëzve që në emër të popullit, po montojnë një demokraci mjerane. E sovranit pret e pret jo vetëm reformën e thellë në sistemin e drejtësisë, por krejt kupolën ligjvënësë e qeverisë. Në sistemet demokratike grupet e caktuar shoqërore e kryesisht ato të përcaktuara politike, programet që shpallin në zgjedhjet elektorale, përcaktojnë ndryshimet pozitive të elektoratit, e ata sigurisht

i besojnë katërcipërisht se fushatat zhvillohen në kahjen pozitive të mirëqenies së sovranit, për të qenë një shoqëri e civilizuar po se po, por veçanërisht në nivelet ekonomike të Europës, ku synojmë të arrijmë. Duam që ky popull i shumëvujtur dhe i sflilitur ta shijojë vërtet lirinë demokratike, duke u bërë ballkon frymëzimi për Ballkanin e më gjerë. E siç shkruante këtu e vite më parë një publicist dhe akademik shqiptar, nuk ka liri të kriminalizuar, sikundër nuk ka demokraci të dhunuar, e respektivisht nuk ka patur as nuk do ketë liri komuniste në shoqërinë demokratike. Ndërsa unë dhe fqinjët e mi sot meditojmë për deputetët tanë, që për katër vjet nuk shkelin në zonën tonë. Ata vijin vetëm në fillim të fushatave, duke bërë mizën buall dhe detin kos me realizime dhe investime të fuqishme. Por të tillë kandidatë për drejtues vendorë nisen thjesht dhe vetëm nga interesa vetjake, e kjo tashmë është një "kambanë" për zgjedhjet e ardhshme vendore me ndarjen e re administrative, ku një çerekshekulli

radhazi kanë kandiduar, herë me një parti dhe herë me një tjetër. Pra aty ku shitet ideali dhe morali i tyre, aty qëndrojnë të krekosur në kolltukun e kryetarit dhe të këshilltarit. Edhe nëse fitojnë, përsëri do të mbeten lejfenë, ku historia e mëvonshme do t'i përjashtojë edhe nga jeta njerëzore, jo më nga elektorati i tyre i lodhur prej dy dekadash. E ajo ditë ndoshta do jetë jo e largët, e dashtë Zoti që votuesit të mos jenë mërzhitur e sflilitur, se Noli ka vdekur me kohë, e nuk ka kush të rrëfejë më për ta. Në këtë periudhë kohore prej mëse një shekulli shtet shqiptar, fatkeqësisht kombi ynë ka provuar disa sisteme shoqërore dhe politike. Sistemet politike, të cilat po i cekim më poshtë, jo çdo periudhë historike kanë sjellë prosperitet, por disa syresh edhe pasojë negative që ende sot rëndojnë mbi kurrizin e shqiptarëve të përvojatur. Për t'u theksuar është fakti se liderët politikë shqiptarë përgjithësisht s'kanë pushuar së reshturi për demokraci dhe mirëqenie sociale.

Ky sistem, një "Shpellë" e kohës së antikitetit

Nga Pandeli BARDHI

E kohës kur brenda saj kanë gjetur strehë të këqijit që sot, më shumë se kurë, kanë dalë mbi sipërfaqe, siç janë egërsia, antihumanizmi, mashtrimi, spekulimi, mungesa e dashurisë servilizmi, mercenarizmi, tradhtia, krimi, karrierizmi, pasurimi sa më shpejt, vjedhja, prostitucioni, mburaveclëku e fodullizmi, hakmarrja, urrejtja, etja për pushtet, e shumë të tjera si këto që e kanë zanafillën e tyre, qysh nga lashtësia. Nuk janë të reja këto fenomene, por "e reja" është ajo që, në këtë sistem të parët që i manifestojnë këto fenomene, janë shtetarët, në mungesë të shtetit Ligjor! "E reja" gjithashtu është ajo që qysh në themelet e këtij palo sistemi, nuk u hodh beton që të "çimentohej" demokracia, e ëndërruar aq shumë nga qytetarët. Në vend të "betonit", në themelet e tij u hodh vetëm llum, tashmë jo sipas komandës të një Njeriu të vetëm, si deri atëherë mbas pesëdhjetë vitesh, por sipas gustos të lloj lloj "drejtuesve" deri në atë kohë jo vetëm të pakënaqur nga sistemi i kaluar por edhe që me të drejtë apo pa të drejtë, nga prapësitë e sistemit të kaluar u vlonte urrejtja dhe hakmarrja për gjithçka ishte bërë deri në atë periudhë. Nga njëra anë e "hendekut", u hodhëm në anën tjetër edhe më të "errët" akoma, sepse tashmë, nuk kishte kush të na "frenonte" në këtë turraprap "demokratik" ku secili vepron sipas "ligjit" të vet. Kjo "shpellë", edhe mund të shembet lehtë, si objekt, por është shumë e vështirë, në mos e pamundur të fshihen të tëra të këqijit që kanë "burmimin" e tyre, pikërisht në këtë "ngrehinë" të kohëve të shkuara. Sistemet, Regjimet, Qeveritë, kanë ardhur e kanë ikur. Pavarësisht nga ndryshimi i emrit, në thelb, të gjitha kanë qenë të njëjta sepse "burimet" njerëzore, kanë qenë të këtyre "ujërave të ndotura"! Të paktë kanë qenë ata burra që kanë shkruar pasurinë e tyre për Shqipërinë në të kaluarën, kurse sot janë të kundërtat e tyre që nuk kanë lënë asnjë "gjethe" të këtij vendi pa e përvetësuar. Të gjithë shtetarët, sot, kanë etjen për pasuri mbi djersën e të tjerëve, mashtrimin dhe hipokrizinë mburaveclëkun e të tjera, që fshihen në këtë Sistem me emrin e bukur "Sistemi Demokratik", që jo vetëm i tillë nuk është por në thelb është më antihuman edhe nga diktatura, sepse vetë Diktatura, u kishte

prerë rrugën fenomene të tilla që po na mbysin. Diktatura e djeshme i mbajti të gjithë shtetasit në të njëjtin nivel që të mos "pipërinte" korrupsioni, droga, krimi i organizuar etj e ca më pak etja për të bërë pasuri e katandi brenda natës. Shikoni vetëm skemën se si është ndërtuar dhe konkluzionet, dalin vetvetiu. Skandalet, ndjekin njëri tjetrin, në të gjitha drejtimet, kudo e nga të gjithë krerët në pushtet e të gjitha niveleve. Këto skandale, janë të tilla që ende pa u shuar njëri, ka plasur tjetri. Këto skandale, nuk janë vetëm frenuese të arritjes së objektivave si gjoja në rritjen e mirëqenies. Sapo ato "shpërthejnë" turren të gjithë, politikanë, analistë, mediatikë, Mjekë Gjykatës e Prokurorë, Ministra e avokatë, sekserë etj, etj të gjithë bëjnë "humanin" dhe i "qajnë hallet" qytetarëve, kush e kush të "brockullisi" më shumë. Të gjithë këta e shumë të tjerë "mercenarë" i "hyjnë në themel" analizave dhe "habiten" se si na ndodhi kjo e ajo. Ky është falsitet, sepse në brendësi duhet të kuptojmë atë c'ka thotë populli që "Ujku, mjegull kërkon" që të fshihet. Ajo që këta "dijetarë" krerë të këtij Sistemi, nuk e kuptojnë apo bëjnë sikur nuk e kuptojnë, është që këto skandale, janë paaftësia e punës së tyre, paaftësia për t'i dalë të keqes përpara, dhe me kushtet që i kanë krijuar vetë, dalin e habiten "Si është e mundur"! Por ama, askush nuk e merr përgjegjësinë, por fajësojnë njërin apo tjetrin, opozitarët apo pozitarët. Jo, jo, të gjitha kanë virusin e pushtetit, si i vetmi "burim" ku buron pasuria, ku vidhet me firmë e me vilë. Po në fakt, cila është e vërteta? E vërteta është që të gjitha këta "diskutantë" non stop 24 orë, as më shumë e as më pak, u erdhin në derë edhe "punësimi" por edhe ajo që të përfitojnë nga këta të "majmur" nga skandalet që pasurinë ta ndajnë duke i bërë favore. I tërë "Ajsbergu" është nën ujë, e gjithçka bëhet për t'i shpëtuar drejtësisë me ndihmën shtetarëve pjesëmarrës në skandale, apo si Mjekja Alketa që "indinjohet" për shtrembërimin e surratit nga gazetarët, apo një Mjek tjetër i tipit "Buldozer" që kërkon të shpëtojë duke ja mbathur vrapit si "Lopa e Mecos" "tëpkë" si ai në Korçë vitin e kaluar. Këta Mjekë, nuk janë të tillë sepse shpirtin e Zi, nuk ja mbulon bluza e bardhë, që me ndërgjegje të plotë ndajnë nga jeta qytetarë që i kanë besuar jetën. Është e tmerrshme, kur "human" Mjek, kërkon të fitojë mbi gjakun e të sëmurit me kancer për

të shkuar në Ishujt Maldive. Sikur ky rast të ishte i vetmi, do të thonim që "Edhe ndodhin gjëra të tilla" Por nuk është as i pari dhe as i vetmi, por është i tërë Sistemi i kalbur që përditë e për orë pjell "krimba". zhuzhakë, "dordolecë" etj etj që nuk i lënë radhë një njeriu të vetëm të bëjnë diçka në të mirë të qytetarëve. Ja shikoni dhe dëgjoni shqetësimet dhe problemet që ndeshet mbarë njerëzimi sot, siç janë ekonomia, mirëqenia, luftërat e shumë halle të tjera që edhe ne, nuk bëjmë përjashtim. E veçanta jonë është që hall mbi hall, kemi atë që si do të bëjmë ne, kur të divorcohet Iliri me Monikën, është e vërtetë kjo apo është mashtrim. Diskurset vazhdojnë secili sipas "dymësë" së vet sipas parimit "Tralala zura një galë"! Kemi edhe një tjetër hall të madh: "A do i hiqet imuniteti Saliut dhe a do zbresë në tokë ky "UFO", shkaktar i sa e sa .fatkeqësive të këtij vendi. Sa për heqjen e mandatit, e "fjetën" mendjen që ja shpëtoi "Partia popullore (socialiste)"! Varfëria ekstreme, këtu, në këtë vend është ulur këmbëkryq, pikërisht nga këta politikëkanë të paskrupull. Kemi një shtet inegjist-ent dhe qeveritarë të pamëshirshëm. Mirë që "gomari" na ka "ngordhur" por nuk na lënë rehat as "mizat" politikanë!. Përpara se të ndjekim një "sekuencë" të talljes, Uskana, nuk e ka gabim kur thotë: "Varfëria ekziston, jo se nuk kemi mundësi të ushqejmë të varfrit, por sepse nuk mund të ngopim të pasurit."! Ja të ndjekim Qeverinë: Fill mbas mbledhjes së Këshillit të Ministrave sipas "Regjisë" së "Kryeregjisorit", na dalin në "Sfilatë" të gjithë Ministrat për ti dhënë "sihariqin" e madh, qytetarëve që qëndroni "gojëhapur para ekraneve të televizorëve Ata, dalin një e nga një të entuziazuar për "sihariqin" që do të jepnin, për rritjen e pagave dhe privilegjeve të tjera për administratën, duke filluar me Shëndetësinë që "kujdesin për jetën e qytetarëve e ka prioritet", por që nuk ngopen Mjekët, si ai Mjeku "buldozer"! Është zbuluar një "vatër infeksioni" tek Onkologjiku. Jo mor jo, "Vatër infeksioni" është tërë sistemi shëndetësor në këtë vend ku Shteti ngop me përralla. Këtë, e di c' do qytetar që e ka hequr mbi kurriz këtë pangopësi të punonjësve, mjekë e infermierë "humanë"! Të dhëmb në shpirt, për të sëmurët kanceroz që "Perëndia" I ka "vlarë", por edhe më e dhimbshme është kur Mjeku "human", një bastard e vret jo një herë, por tre e katër herë. I vrasin pacientët me mungesën e ilaçeve,

me shitjen e ilaçeve të tyre, me sorollatjen nëpër Klinika private, me ilaçet e skaduara që dërgojnë sekserët e shtetit. Gjithçka dinë qytetarët në këtë shëndetësi me punonjës partiakë e të korruptuar deri në palcë, vetëm Shteti nuk e di! Për Arsimin. Një farë Ministre, Manastirliu, apo "Qershia mbi tortë", mbasi e "ndriti" këtë shëndeti, shkoi të japi eksperiencën e saj në arsim se si mund të "konvertohen studentët e Universiteteve. në Klientë për të blerë Diploma. I takon edhe këtyre "manastirllinjve" rritja e pagës mesatare deri në 950 euro, për të "shkuar sa më pranë Europës"! Nuk ka gjë që Shefja e Kabinetit të saj është e dënur për korrupsion, mbasi "përgjegjësia, është personale"! Ministri i Mbrojtjes na dha "sihariqet" për rritjen e pagave dyfish, duke filluar që nga ushtari i katërt, apo i fundit në rresht, e deri tek Gjenerali që nuk ka asnjë ushtar në vartësi. Nuk besoj të jetë kush kundër rritjes së pagave të zjarrfikësve që luftojnë me flakët, me policët e burgjeve përballë kriminelëve në Ministrinë e Drejtësisë etj, etj që bëjnë sakrificë sipas procesit të punës. Por jo, rritje pagash do të kenë ata që vjedhin, që shpërdorojnë që "tundin zinxhirin". Po halli i atyre "Gjeneralëve", të Luftës e të punës që luftuan me pushtuesit, që edukuan e stërvitën qindra e mijëra bij të popullit, që hëngrën dheuan me grushta e thyen shkëmben, e ndërtuan rrugë e fabrika, h/centrale e hapën toka të reja. që u rra bretku maleve ditë e natë dhe nuk pretenduan për asgjë nuk kanë sot një ilac me rimbursim, sepse nuk kanë gjë në dorë, dhe vetëm në prag zgjedhesh Kryekomandanti u jep 2 kg domate falas si shpërblim. Këta "Gjeneralë" në pension, që bënë sakrificë të mëdha, askund nuk i mbajnë sytë përveçse nga Shteti që jo vetëm nuk u jep, por edhe tallet!. Ata le të "ngopen me shprehjen migjeniane" Hajt, Zoti ju dhashtë..! Të pangopurit e Sistemit more të nderuar pensionistë, nuk e kanë mendjen tek juve që me pensionin nuk merrni dot as aspirina, që bukën e përditshme e matni me "korricka" që turizmint nuk ja dini emrin sepse "këtë vit, shteti pret 15 milionë turistë dhe këta, duhen ushqyer nga kurrizi juaj dhe me të ardhurat e tyre Shteti do të mbushi arkën dhe do të mburret!. Të tjerat, do t'i themi në pjesën e dytë, por më parë le të japim një hapësirë publicitare: "Tuj, Tuj, Tuj, Tuj, ... Ula, ... Ula Ula... Ula, Ula Ula..."

k o m e n t e & a n a l i z ë

Pellazgët krijuan Plakën e Skulaken, ja pse organizimi i faltores së qendrës në Dodonë me degë vartëse në hapësirën dodoniane nuk është pluralizëm Dodonash por një e vetme


-Dodona e largët [Nëna e Madhe] Perëndi pellazge mbretëron mbi Dodonën në Kamnikun Neolitik në rrugën romake 21 km pas Përmetit dhe jo në Dëshnicë të tij-

Nga Sami **DAKE**, studiues i Dodonës Nënë

Shkrimi im i datës 21 qershor 2024 në gazetën 'Sot' i ndjekur nga rreth njëzet mijë lexues online synonte që autorët e Dodonës në Dëshnicë të Përmetit të shpreheshin qartë për kë Dodonë pretendonin, për të mos u ngatërruar lexuesi i thjeshtë që mund të hamendësojë, nisur edhe nga kërkesa e tyre publike e dt 03.06.2024 për debat në mediat e shkruara e vizive. Zjarllëk i madh e pllakosi këto ditë të nxehta vere komshiun e mirë G.Voda që pas tre dite flet përçark. Ndjesë i kërkoj se mos u lëndua. Shumë me tërsëllëm e nisi 'përgjigjen e detyruar' dhe përfundimisht shuhet si flaka e kashtës dhe e mbyll me respekt si komshi i mirë. Shigjeta në Thembër të Akilit, në pikën e dobët që qyteti prehistorik Dodonë nuk ndodhet në Dëshnicë por në Kamnik e alarmoi dhe u trondit shumë. Të shkuara të harruara! Besova në sineritetin që deklarohej në shkrimin "E vërteta për Dodonën dhe Epirin" se 'sot nuk paraqesin interes për të lexuar libra' dhe mendova se do ish i lexuar si vullnetmadhi Mateli, por u zhgënjëva. Herodoti, babai i historisë thotë: "Pellazgët krijuan Plakën e Skulaken". Ai shkruan "që për fat të keq nuk kemi parë debat në mediat vizive e të shkruara" dhe mendova se do ta mirëpriste sugjerimin ta cilësojnë Dodonën që pretendojnë në Dëshnicë të Përmetit, në kohë e hapësirë. Qyteti prehistorik Dodonë është Kamniku Neolitik që nuk dinte asgjë për zbulimet e jashtëzakonshme arkeologjike, i shpallur monument kulture kategori e parë. Matelit i jam referuar dhe e kam sugjeruar ta sjellë Dodonën në rrugën romake 21 km pas Përmetit. Katër kushtet -lumë, shpat mali, -në fund e kufi me fushën dhe 70.7 km në veri të Janinës janë në Kamnikun Neolitik. Ai në heshtje e ka pranuar timen dt 29.09.2022 "pse qyteti mitologjik me tempullin mëmë Dodonë nuk ndodhet në Përmet..." botuar në gaz. 'SOT'. Dodona vlerë universale e njerëzimit. Qyteti prehistorik i perëndisë Dodonë i shquar për faltoren hierore, qendër politike e hyjnore e Botës së Lashtë, është propozur pesë mijë vite të shkuara. Dodonë ku ngjizet njerëzimi ka vetëm një i përjetësuar në shumë kuptime. Historia e jashtëzakonshme sa e lashtë e stërmadhe po dhe e manipuluar e vështirë të konceptohet. "Që paska një 'Dodonë Plakë' në Kamnik dhe 'ca bija' gjetiu, nuk që dëgjuar më parë, një përgjigje e detyruar për zotin Sami Dake' më shtyhu ta risqaroj publikun dhe komshiun e mirë që është rrëmbyer nga mos njohja e kësaj historie të cilën e pranon vetë. Mendova se 12 vite ishte kohë e mjaftueshme ta konceptonte madhësinë e historisë më të lashtë mbi Dhe, Dodonën Pellazgjike. Shkrimin që replikoj jo vetëm mediokër për këtë ngjarje, por dhe studiues të çështjen Dodonë nuk do ta bënin pa më



lexuar dhe kuptuar. Dodonë ka vetëm një me degë të shtrira në hapësirën dodoniane ku ushtronte veprimtarinë. Organizimin perfekt të faltores hierore Dodonë e sqaron akademiku Ali Eltari (Lapi) te "Pellazgët Krijuesit e qytetërimit Botëror" fq 65. "Rol të madh ka luajtur krijimi i orakujve nga qendra shpirtërore e Dodonës. Dodona Pellazgjike kishte faltore lufro apo lushie në të gjitha vendet e populluara, dy faltore të tjera të mëdha e më të vogla se e qendrës ku kish pellazgë në Armeni e Egjipt. Ato mbanin lidhje të forta e mbikqyrje nga qendra shpirtërore



në Dodonë. Në ndihmë e vartësi të faltores hierore në epokën e Zeusit janë ngritur Orakuj. Autorë të ndryshëm ata i quajnë Dodona bija. Rilindasit Orakullin në malin Tomor e bënë nacional si shprehje të etnosit shqiptar. Fenë e trashëgiminë kulturore e shpirtërore ideologji kombëtare me mitologji pagane. Sami Frashëri shprehet se Dodona e vjetër nuk është diktuar ende. Sazan Guri në librin TOMORI thekson 'Ky Mal është Mali i Dodonës'. Dodona e vjetër afër me Tomaras - in e sotëm të argumentuar me një toponim Dhodhanë apo fshat Mrakull dhe se ka krahinë e popull suliot-sulovë. (fq 137) Ato prova në Kamnik janë fare periferike. Nuri Çuni "Tek Abaz Aliu" në fq 9 shprehet: "Teza e hipoteza nga më të ndryshmet janë hedhur, por deri më tani nuk është gjetur tempulli më i vjetër i Europës, Dodona. Ka mendime se Dodona mëmë ka qenë në Tomor dhe bijat në Janinë, Volos afër Selanikut, Itali. Ai në Kamnik është befasuar nga qeramikat ende mbi tokë dhe rrënjën e lisit të Mirë. Kryegjyshata ka vendosur 7 gushtin pelegrinazh te Lisi i Mirë por nuk ja dashka zemra ta shënojë në kalendrar. Fjalori Enciklopedik Shqiptar thotë: 'DODONA qytet dhe qendër e rëndësishme kulti në Epirin antik. Lashtësia lidhet me Pellazgët, me një periudhë shumë më të hershme nga ajo kur u vendosën Helenët në gadishullin Ballkanik dhe themeluan orakullin e tyre në Delf'. Ai thotë Dodonë pellazgjike [faltore e vjetër] dhe orakull Dodonë që nuk janë e njëjta ngjarje. Historianët e lashtë thonë: 1- Faltore më e vjetër, më e parë, tempull më i lashtë mbi Dhe ku lindi feja. 2- Orakull më të vyer për njerëzinë.


"Kamniku Neolitik Dodona"

Dy ngjarjet i analizoj te 'Qytetërimi e feja lindën në Dodonë' në Vëllimin e Parë të cilin e titulloj 'Kamniku Neolitik Dodona'. 'Dodona në Dëshnicë të Përmetit', Delf e Tomor ma imponuan që vëllimin e dytë ta titulloja Kamniku Neolitik Dodona Plakë (maket) dhe si zbulova se në vitin 1018 fillon të quhet Kolonja te drafti me ISBN shtoj edhe Kolonja që lexuesi im të mos ngatërrohet. Kërkoj nga ata ta cilësojnë Dodonën që pretendojnë në Dëshnicë. Dodona pellazgjike (Nëna, Plaka, e vjetra) është faltorja në qytetin prehistorik kurse Dodona iliro-epirioete janë orakujt bija Dodonë. Mesazhet Dodonë sa larg mjegullnajash vijnë po edhe aq tej kohëve moderne do të shkojnë. Dodonën koncept shumë i gjerë historik, gjeografik e filozofik se konceptojnë dot Ju që e studioni e jo më lexuesi i thjeshtë apo me grada shkencore. Skulakja kush hyjni është? Reagimi flakë për flakë do të mbetet si flaka e kashtës. Draftet e para të Matelit dhe autorë shqiptarë që shkruajnë për Dodonën e pellazgët i kam studiuar. Orakulli i Lisit të Mirë mijëvjeçar është simboli kyç dhe ADN-ja e Dodonë në të cilin sistemova fenomene e objekte arkeologjike të propozura në tokë, gjurmë e toponime, burime të shkruara e kujtime, etj. Vëllimi i tretë dhe 'Dodona në

një logjikë të pranueshme' dhe 'vënien e çështjes në shtratin ballafaques', etj i përdorur për retorikë se e pranon që nuk ke njohuri. Kur nuk di pse debaton? Pse nuk flet Mateli? Integriteti s'të cenohet se fundja njeri publik do që të bëhesh. Besoja se do të kishe mësuar diçka nga Mateli ndaj tu drejtova që të kërkoj falje se të paskam cënuar. Dodonë Plaka, Nëna, Gratë, e Vjetër, e re për analogji siç quhesh Ti gjyshi, Gëskë, Ximi, etj. Dr. Mantheiu Aref, Un. i Sorbonës, Paris për 'Qytetërimin helen, mashtrimi më i madh në historinë e njerëzimit' shkruan 3000 faqe. Çështja shqiptare po zien ngado. Dodona Plakë Kolonja plotëson zbrazësi të mëdha në historinë e njerëzimit. Shkruani 'Lexuesi i thjeshtë mund të hamendësojë', 'cilido të hedhë dritë për të vërteta të propozura ose të diskutueshme' apo 'shkuarja drejt të vërtetave që hanë diskutim siç është çështja e vendndodhjes e etnisë së Dodonës'. Pse merrni zjarr që qyteti prehistorik Dodonë është Kamniku Neolitik dhe jo Dëshnica e s'më kundërshtoni me fakte e argumente. Dodona e shenjtë pavarësisht cilësimit të detyruar Plaka që unë i bëj është Një. Ajo është zbulimi historik më i lashtë mbi Dhe.

Dodonat vartëse janë bija të Dodonës Kamnik

Dodonat vartëse janë bija të Dodonës Kamnik. Dodonën e ka lënë testament Homeri që jetoj kur nuk kish grekë e helenë dhe orakull në Delf. Parësore kam poemat Iljada e Odisea, Punët e Ditët, 'Prometeu i lidhur' të analizuara historikisht. Përshkrimet e Homerit, etj për Dodonën janë në terrenin konkret në Kamnik. Ato përputhen me fenomene e objekte arkeologjike, gjurmë e toponime, imazhe e gojëdhëna, etj. Qëndrimin si shqiptar e shpreh me studimin tim kurajoz. Koha dhe publiku do ta gjykojë analizën time shkencore. Pasardhës i të parëve tanë kamniklinj e kolonjarë që mbrojtën me gjak etninë shqiptare dhe tempullin më të lashtë mbi Dhe rriskova për Dodonën Pellazgjike. Egoja e monopolit të së vërtetës u ka turbulluar arsyen e fjalorin dhe pengoni pranimin e qytetit prehistorik Dodonë. Nuk ma ndjen të replikoj me ju për kështjellat, etj. Lexuesit serioz i kërkoj ndjesë për fjalorin e padëshiruar por të hodha ca gurë nga gërmadha që më gjuajte. Kundërshtarët më të ashpër e di shumë mirë që janë rivalët që shkruajnë për Dodonë vend e pavend. Dodona ka një mijë vite që i është fshirë emri e lavdia. Uroj të shiten libra që brezat e sotëm e të ardhshëm të krenohen me historinë madhështore Dodonë. Shqiptarët i siguroj me përgjegjësi të plotë para ligjit e Zotit se Tempulli më i lashtë mbi Dhe janë rrënojat në majë të Shkëmbit të Larmë Kamnik. Ata që duan të replikojnë të mos kursehen, por jo pa më studiuar se flas për zbulim historik. Qyteti prehistorik Dodonë i pagëzuar Kolonjë në vitin 1018 është Kamniku Neolitik. Kujt nuk i vjen mirë le të pijë uthull. Në mos sot, mot a për ca vite Dodona Kolonja do pranohet dhe rifillojë gërmimet arkeologjike.



malësitë e Kolonjës' e autorit Josif Risto nuk ish hedhur në fondin e librit. Do gjej kohën t'i studioj. Pyetjen për reciprocitet bëja vehtes. Unë falënderoj autorët nga të cilët mblodha të dhëna se pa ata nuk do t'ia arrija. Zbulimet në Kamnik çelin Muzeun Historik Kombëtar. Nuk të falet ty e asnjë shqiptari të mos e dijë ku nis historia jonë. Apelin tu shkojmë në fund të vërtetave mbi vendndodhjen e Dodonës dhe etninë e Tempullit më të lashtë mbi Dhe e gallamos me mllef nga egoja o në Dëshnicë ose asgjëkund në Shqipëri. Dodona është në Kamnikun e provuar shkencërisht dhe as në Tomor e Dëshnicë. 'Njerëzillëkun', 'gjërat e kanë

k o m e n t e & a n a l i z ë

www.sot.com.al

Referendum kryeministor pas referendunit zgjedhor?!

Nga Bardhyl BEJKO

O bjektiviteti i opozitës për të ardhur në pushtet është një kërkesë legjitime. Rotacioni politik me votën popullore është shtylla kurizore e demokracisë, që alternon forcat politike për t'i lënë stafetën njëra-tjetër. Kjo është demokracia. Shqiptarët e kanë zgjedhur këtë sistem prej tridhjetë e katër vitesh qysh se përmbysën sistemin komunist në 1990-ën. Dhe gjatë këtyre viteve kanë provuar pushtetin e të djathtës dhe të majtës. Kanë bërë diferencën dhe kanë llogaritur me saktësi matematikore treguesit që dallojnë nga e djathta në të majtë. Kanë ballafaquar: Nivelin e demokracisë. Zhvillimin ekonomik. Lirinë e medias. Pavarësinë e gjyqësorit. Reformat e ndërmarrja. Ecurinë drejt Bashkimit Europian dhe gjithçka tjetër sensitive që tregon, ku ishim e ku duam të shkojmë. Këtu nuk përjashtohet cilësia e zgjedhjeve të përgjithshme dhe ato vendore, apo raportet serioze që kanë evidentuar problematikat pa përjashtuar këtu konstatimet e atyre që kanë marrë pjesë në organizimin dhe kontrollin e proceseve zgjedhore, pa harruar dhunën zgjedhore dhe mungesën e kontrollit të opozitës të proceseve të cilat në jo pak raste kanë qënë skandaloze, të vjedhura, të përgjakura, të pandershme. Kujtojmë këtu zgjedhjet e majit të vitit 1996, ku kërciti dajaku dhe komisionerët e mazhorancës së kohës larguan nga

komisionet zgjedhore kolegët e tyre të opozitës, të cilët u intimiduan dhe u përjashtuan nga kontrolli dhe numërimi, situatë që çoi në kaos me fitore gati mijë për qind nga PD. Duket se janë të largëta në kohë këto bëma, po memoria kombëtare nuk ka harruar asgjë përkundrazi i ka të freskëta dhe të gdhendura në kujtesë. Aq më tepër që janë të njëjtët protagonistë. Pa folur këtu për korrupsionin galopant, i cili duket se ka zënë pak kore, po e keqja mbetet atje, gati të shpërthejë sapo të gërvishet pak. Megjithatë demokracia pranon rotacionin me votën e qytetarëve. Është vullneti i popullit që vendos. Debatet post zgjedhjeve, komentet janë thjesht propagandë për të justifikuar humbjen dhe për të lehtësuar pozicionin politik të liderëve, të cilët nuk njohin kurrë humbjen dhe aq më pak dorëheqjen me përjashtime të rralla. Demokracia nënkupton si fitoren edhe humbjen. Në vendet me demokraci solide humbësi i jep dorën fituesit dhe largohet në shtëpi për t'i dhënë fund politikës. Gjithësesi, rotacionet politike janë lokomotiva e demokracisë funksionale. Në këtë kuadër edhe opozita jonë nuk është e qortueshme për kërkesën këmbëngulëse për të ardhur në pushtet pasi në demokraci ekziston detyrimi që opozita të mbrojë këtë qëllim dhe të garantojë ndryshimin. Po çfarë po ndodh me opozitën shqiptare dhe cila është devisa e saj për të arritur qëllimin përballë mazhorancës që ka ambicien për një mandat të katërt për të ndryshuar Shqipërinë? E fokusuar në prob-

lematikat e thella midis opozitarëve për tre vite, luftën opozita e zhvendosi brenda vetes. Jo për parimësi. As për t'u bërë më luajale apo më e qëndrueshme dhe më e fortë. Përkundrazi. I tërë qëllim ishte asgjësimi i palës përballë. Vula dhe sigla u bënë epike dhe gati komike. E tërë vëmendja u fokusua tek simbolet se selia u mor forcërisht dhe PD e vulës u sistemua në zyra të tjera. Nga një shtëpi politike u bënë dy. Secila në kërkim të legjitimitetit. Gjykata vendosi më në fund t'ia japë vullën PD drejtuar nga Berisha. Në gjykimin e opinionit të gjerë shoqëror, kjo ishte e papritur. Dhe lufta vazhdon për ta rigjykuar këtë vendim. Gjatë këtyre ditëve sikur është fashitur dueli mes dy pjesëve të PD-së. Ka rinisur edhe merkatoja e deputetëve. Beteja është zhvendosur në pjesën që drejtohet nga Berisha, i cili ka deklaruar ambicien për të qënë kryeministri i ardhshëm në rast fitoreje. Po këtu ka plasur lufta. Jo pak individë brenda saj kërkojnë që Berisha të mos jetë kandidati për kryeministër. Arsyet dihen. Dhe hidhen hipoteza të ndryshme disa prej tyre edhe të papranueshme që tingëllojnë si kapitullim kandidaturash. Gazmend Bardhi kërkon një kandidat ekstra shqiptar. Kryeministri i ardhshëm, deklaroi ai, duhet të jetë nga diaspora. Me fjalë të tjera si njëqind e katër vite me parë të importohet një Fanol për t'i dorëzuar pushtetin. Ky propozim kundërshtohet nga Arçita Malltezi e cila nuk pajtohet dhe e quan ide të rrezikshme. Nuk mungojnë zërat edhe për kandidat të brendshëm. Po në një pikë fokus-

ohen propozuesit. Jo Berisha për kryeministër. Arsyja ambalazhohet me marifet po shkaku është se është non grata nga SHBA dhe Britania. Po edhe në "arrest shtëpie". Këtu për të qëndruar mbi debatin opozitar është propozuar një zgjidhje ndryshe, tepër origjinale. Puro shqiptare. Dhe propozimi është një vetëpropozim nga pretendenti për kryeministër. Berisha u drejtohet demokratëve që në përfundim të zgjedhjeve të përgjithshme të bëhet një referendum për kryeministrin e ri. Pra një referendum kryeministor pas atij zgjedhor! Historikisht drejtuesi i fushatës zgjedhore, fituesi, është edhe kryeministri i ardhshëm, ai që do marrë timonin për të qeverisur. Nuk ka kuptim që pasi të fitohen zgjedhjet të bëhet një tjetër referendum për t'u pranuar për të drejtuar qeverinë. Kjo është e pakuptueshme dhe e panjohur në demokraci. T'i fiton. T'i kërkon të fitosh një referendum për t'u pranuar kryeministër i Shqipërisë. Referendumi zgjedhor që të ka dhënë fitoren me votë nuk ka pse dublohet nga një referendum tjetër për të të pëlqyer si kryeministër. Ah, po të jetë halli tek dënimi non grata, atëherë ky referendum nuk është më kryeministor po botëror se i kundërvihet jo thjesht shqiptarëve po dy shteteve që konsiderohen, boshti i globit tonë, SHBA dhe Britania. Dhe një referendum i tillë nuk është referendum për karrigen kryeministore por karshillëk për të thënë, se mua më zgjedhin qytetarët e Shqipërisë as dua t'ia di për ata të Amerikës dhe Britanisë!

Nga Fatos ÇOÇOLI

G jykata Kushtetuese është një trupë gjyqësore tejet e rëndësishme dhe themelore e shtetit tonë. Përfaqëson organin që zgjidh mosmarrëveshjet kushtetuese dhe bën interpretimin përfundimtar të saj. Kjo gjykatë i nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe gëzon pavarësi të plotë organizative, administrative dhe financiare. Detyra e saj është të sigurojë respektimin e Kushtetutës dhe të drejtave themelore të qytetarëve. Dhe të respektoj Kushtetutën dhe të drejtat e qytetarëve, do të thotë, në radhë të parë, të respektosh frymën e saj. Fryma e Kushtetutës është mbrojtja e interesave themelore të qytetarëve. Interesa të tilla janë e drejta e pronës, e drejta e kujdesit shtetëror, në rast se je i pamundur ekonomikisht, e drejta e fjalës së lirë, e drejta e një pensioni dinjitoz, e me radhë. Prandaj dhe Gjykata Kushtetuese, mendohet nga të gjithë ne si qytetarë, se mbahet nga taksat tona, pikërisht për të kontrolluar me ndershmëri, profesionalizëm dhe përkushtim institucionet e shtetit, nëse këto e kanë respektuar si duhet frymën e Kushtetutës, parimet e saj, dhe pastaj nenet e Kushtetutës. Por në radhë të parë, frymën e Kushtetutës, interesat tona jetike. Me procesin e vetingut, Gjykata Kushtetuese natyrshëm gati u zhbë gati tërësisht dhe u desh një kohë që gjatë, që ajo të plotësojë me anëtarë dhe të risillej në funksionim. Si qytetarë, për shpresat e larta të reformës në drejtësi dhe të rezultateve nga vetingu, kemi pritur me durim që kjo strukturë

Kushtetuesja dhe pensionet

themelore e Shtetit të jetë një trupë gjyqësore, pikërisht në mbrojtjen e frymës së Kushtetutës. Për fat të keq, nuk po e shohim të tillë. Rasti me flagrant i shkeljes se frymës së Kushtetutës dhe dëmtimit të interesave tona jetike si qytetarë, ka të bëjë me ligjin e ri të tatimit mbi të ardhurat. Ligji nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" hyri në fuqi më 1 janar 2024. Ndryshimet në këtë ligj ju drejtohenin kategorisë së 25 mijë profesionistëve të lirë, të regjistruar pranë tatimeve si të vetëpunësuar. Këta të fundit, në 5 vitet e fundit 2019-2023, kishin qarkulluar 3.3 miliardë euro, me një fitim mesatar 75-90 për qind, duke i paguar Shtetit si detyrim vetë sigurimet shoqërore mbi pagën minimale, ose 1 për qind të të ardhurave të tyre. Sipas të dhënave të tatimeve, bazuar në deklarimet vullnetare të tyre, profesionistët e lirë për vitin 2023 kishin realizuar 510 milionë euro fitim. Me hyrjen e ligjit të ri, por sidomos, me marrjen prej tyre në prill 2024 të njoftimeve të tatimeve se duhej të parapaguanin tre këstet e para të tatimit mbi fitimin, sipas parashikimeve të ligjit të ri, kjo kategori u revoltua keqazi, e mësuar në afro tetë vite në një pozicion gati parajsë fiskale. Një pjesë e profesionistëve të lirë të regjistruar në organet tatimore, lëvizën me shpejtësi. Pranë Gjykatës Kushtetuese, në muajt shkurt-prill 2024, u depozituan tre ankesa, dy prej të cilave nga shoqata të avokatëve të lirë dhe të kontabilitëve të lirë. Gjykata Kushtetuese i pranoi tre

ankesat dhe më 18 qershor 2024 i dëgjoi argumentet e hartuesve të tre ankesave. Dëgjoi edhe argumentet e hartuesve të ligjit të ri për tatimin mbi të ardhurat. Sipas këtyre të fundit, ligji synonte të vendoste më shumë drejtësi në sistemin tonë tatimor, duke taksuar më drejt të ardhurat nga puna, pavarësisht formës së organizimit. Fryma e Kushtetutës sonë, njëlloj si e shumë kushtetutave të tjera të një shoqërie të civilizuar që synon ndërtimin e shtetit të së drejtës, është që kush fiton më shumë, ka për detyrë të kontribuojë më shumë në arkën e përbashkët, pra në Buxhetin e Shtetit. Dhe ky kontribut i shtuar realizohet përmes mekanizmit të taksës mbi fitimin. Hartuesit e ligjit të ri i shpjeguan Gjykatës sonë Kushtetuese se kategoria e profesionistëve të lirë ndryshonte jo pak nga ajo e biznesit të vogël tregtar dhe prodhues, pasi, duke patur shpenzime të vogla, ka fitim të lartë, nga 70-95 për qind e të ardhurave (xhiros) të saj. Dhe vërtet, profesionistët e lirë ndryshojnë shumë nga bizneset e tjera të vogla, si prodhues të vegjël, tregtarë të vegjël, ambulanti, etj., që fitojnë nga 5-20 për qind të të ardhurave të tyre, pasi këto të fundit kanë shpenzime të larta të blerjes së mallrave që rishesin apo përpunojnë, si dhe kosto të tjera fuqie punëtore, etj. Ky shpjegim nuk piu ujë të Kushtetuesja jonë. Më 27 qershor 2024, ajo vendosi që të 25 mijë profesionistët e lirë nuk kishin pse t'i paguanin tatim fitimi shtetit për këtë vit dhe deri në vitin 2029.

Edhe pse fitimin për vitin 2023, sipas të dhënave të Ministrisë së Financave, e kishin patur 510 milionë euro! Kësisoj, Kushtetuesja jonë i mohoi Buxhetit të Shtetit për të pesë vitet 2024-2029 arkëtimin e të paktën 380 milionë euro (15 për qind e 510 milionë eurove në vit është baraz me një tatim 76 milionë euro në vit. Shumëzuar me pesë vite, bëjnë 380 milionë euro). Në mënyrë indirekte, Kushtetuesja u mohoi kështu të 717 mijë pensionistëve tanë shumicën nga ky tatim 380 milionë euro në pese vjet, i cili mund dhe do të përdorej, kryesisht për të ndihmuar shtimin e pensione. Tek shumica e të nëntë anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, arësytimet mbi cënimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike, për shkak të mosrespektimit të parimit të sigurisë juridike, si dhe cënim të parimit të proporcionalitetit, dolën më të forta se morali i pagimit për Shtetin të shumë me teper se 35-40 eurove në muaj sigurime shoqërore mbi pagën minimale, që profesionisti i lirë i cakton vetes dhe i paguan tani! Dhe i paguan 35-40 euro, nga mesatarisht 1 mijë e katërqind euro fitim mujor që realizon tani. Hartuesit e ligjit u përpoqën që këtë qytetari, profesionist i lirë, që mesatarisht fiton një mijë e katërqind euro në muaj sot, t'i vinin një detyrim-tatim, si kontribut për Shtetin, prej mesatarisht 210 euro. Ose 15 për qind e fitimit të tij. Në emër të një sistemi më të drejtë tatimi. Po ta kishte pranuar Gjykata Kushtetuese këtë moral dhe frymë reale të Kushtetutës, pensionistët tanë do të kishin nga fundi i këtij viti, fonde më serioze, për të parë të rritur në mënyrë më dinjitoze pensionin e tyre.

Demokratët euroatlantikë një realitet i ri për Shqipërinë

Nga Qamil GJYZE

S ituata aktuale politike në Shqipëri dhe rajon, kërkon forca politike dhe koalicionet me formë dhe përmbajtje euroatlantike, për t'i dhënë fund korrupsionit dhe antishetit 34 vjeçar. Ngjarjet e fundit që ndodhën në opozitë P.D., si rezultat i një vendimi absurd të gjykatës së apelit, promovuan një grupim të ri "Demokratët euro-atlantikë". Nuk është i rëndësishëm vetëm emërtimi, por edhe thelbi i P.D-së, një forcë të djathtë, që në 34 vite vetëm euro-atlantike nuk ka qënë as në formë as në përmbajtje. Në fillimet e saj PD, Berisha dhe drejtuesit e kohës premonin se P.D. do të jetë forcë Euroatlantike, por koha e vërtetoi se nuk ishte e tillë. Zhvillimet politike në PD, kanë prezantuar metoda pseudo-demokratike, sidomos mbas vitit 2008 dhe sidomos mbas 9 Shtatorit, ngjarje të zhvilluara në selinë e PD-së. Në historinë politike botërore euroatlantike, nuk është parë e

dëgjuar të sulmohet selia e një partie me vare dhe sopata, përveç rastit në "Capitol Hill"! Berisha dhe mbështetësit e tij vetëm lëvizje Euroatlantike nuk janë dhe nuk kanë qënë. Berisha non-grata në USA dhe Angli, përfaqëson një PD familjare, që po e përdorë për qëllime personale dhe për të shpëtuar nga drejtësia e pavarur SPAK, në kurriz të ndryshimit dhe integritetit të Shqipërisë. Një forcë euroatlantike duhet të punojë për drejtësinë e pavarur, ekonominë e tregut të lirë, mediat e lira dhe jo për gjykatës e prokurorë që zbatojnë urdhra politikë, firma piramidale, shkatërrimi i pronës së përbashkët, privatizimin i keqtrajtimi i pronës dhe budallallëqe që Sali Berisha dhe berishistët i kanë si mendësi të tyre duke e trajtuar shtetin si pronë private. Janë pikërisht këta mendësi, ose metoda qeverisëse që po përdorë edhe sot bashkëpunëtorit i Berishës, Edi Rama dhe Rilindja. Prandaj demokratët euroatlantikë duhet t'i japin fund tranzicionit 34 vjeçar dhe klasës politike të korruptuar, pa ide, autoritare,

megallomane, në ide dhe programe pa frymë Euroatlantike. Programi që prezantoi PD dhe Zoti Basha me 1 Qershor është programi i I-rë i djathtë në 34 vite me përmbajtje Euroatlantike. Ekonomia, taksat, familja, të rinjtë, teknologjia e informacionit, reforma e kontrollit të Shtetit, institucionet e sigurisë, dalja nga kriza janë trajtuar në këtë program, me asistencë euroatlantike. Programi do të prezantohet me qytetarët, grup moshat dhe kam besim se do të ndikojë tek votuesit, për ndryshimin që të gjithë e presim me padurim edhe të majtët, shtresa gri, etj. Vetëm dyshja Berisha-Rama nuk janë të interesuar për këtë program dhe për një grup politik që përfaqëson euroatlantizmin mbasi duan të mbrojnë sundimin e tyre 34 vjeçarë të mbushur me korrupsion, skandale, në dëm të rinjve dhe bëjnë sikur zihen në parlament dhe media. Sali Berisha dhe Edi Rama vënë fatin e tyre politik, mbi qytetarët dhe ndryshimi i kësaj situatë që po i largon shqiptarët nga vendi duhet ndryshuar,

duke mbetur më pak se 2 milionë qytetarë, pavarësisht se manipulojnë censusin. Luzim Basha duhet ta drejtojë këtë lëvizje Euroatlantike, biles edhe koalicioni opozitarë duhet të këtë formë e përmbajtje. Basha po zhvillon disa emisione televizive me shumë nivel dhe së fundi ishte në Gjirokastër, në qarkun e shpopulluar nga emigracioni dhe politikat e Ramës dhe sundimi i berishistëve në këtë qark në 34 vite. Në statusin e tij Basha shkruan: "Gjirokastër, me drejtuesit politik të qarkut, të përqendruar te alternativa që kemi gati për shqiptarët, të bindur se vlerat, programi dhe ekipi ynë janë zgjidhja e duhur për një ndryshim të vërtetë. Shqipëria meriton më shumë se korrupsioni asfiksues për ekonominë, që prodhon vetëm varfëri dhe shpopullim. Të rinjtë shqiptarë meritojnë më shumë se politikanët nën ethe dhe SPAK, që vendosin interesat personale mbi interesat e tyre. Një qasje e tillë është një model euroatlantik, një realitet i ri për Shqipërinë që duam të gjithë.

Regjisori thotë se vepra në skenë për herë të parë u këndua nga sopranoja Edith Mihali

NIKOLIN GURAKUQI: Opera moderne “Zëri njerëzor” e kompozitorit francez Francis Poulenc, që e solla në skenë për Ditën e Muzikës

Kryevepra botërore janë vënë në skenë tonë me regji nga Nikolin Gurakuqi. Regjisori Nikolin Gurakuqi “Mjeshtër i Madh” e filloi aktivitetin e tij në Teatrin Kombëtar të Operës dhe Baletit në vitin 1979. Pas specializimit në Francë i dedikohet tërësisht regjisë, ku përgjatë aktivitetit të tij ka sjellë në skenë vepra të ndryshme, por një prej tyre është dhe “Zëri njerëzor”. Shkruar nga kompozitori francez Francis Poulenc, cilësohet si një vepër intime, që i përket periudhës së impresionizmit francez. Një histori dashurie e shkruar nga kompozitori i njohur i shekullit të XX, Poulenc, që përcjell te publiku dashuri dhe dramë. Në intervistën për gazetën “SOT” regjisori Nikolin Gurakuqi shprehet se është një vepër kontemporane franceze e kompozitorit Francis Poulenc, që e solla vite më parë në skenë për Ditën Ndërkombëtare të Muzikës. Regjisori tregon se këtë vepër e ka vënë për herë të parë në vitin 2002, për ta rivënë sërish në vijim, por e ka vënë dhe në Tetovë. Regjisori tregon se për herë të parë në skenë tonë kjo vepër u interpretua nga sopranoja Edith Mihali. Por kjo vepër është mes dhe të tjerave që regjisori ka sjellë të autorëve francezë. Në vijim të aktivitetit të tij disa javë më parë regjisori Nikolin Gurakuqi ishte dhe në Universitetin e Tetovës. Në Tetovë u promovua libri “Mbi regjinë dhe aktrimin e kënduar në teatrin muzikor” i Luigj dhe Nikolin Gurakuqit. I pranishëm për disa ditë në Tetovë, regjisori Nikolin Gurakuqi zhvilloi gjatë tre ditëve masterklas për studentët e Artit Muzikor dhe Artit Dramatik. Regjisori Nikolin Gurakuqi është autor i shumë veprave të vëna në skenë në TKOB, të Universitetit të Arteve, të disa qyteteve të tjera si Durrësi, Shkodra dhe jashtë Shqipërisë.

-Në aktivitetin tuaj si regjisori ju keni sjellë në skenë vepra të ndryshme të autorëve shqiptarë dhe të huaj. Por më 21 qershor u shënuar dhe Dita Ndërkombëtare e Muzikës. Si regjisori për ju sa ka rëndësi kjo ditë?

Unë këtë festë të muzikës e kam kujtuar dhe festuar me vënie në skenë të operës “Zëri njerëzor” vite më parë. Dhe pothuajse çdo vit kam bërë ndonjë



Opera ishte një novitet për kohën, si për sa i përket në Shqipëri që nuk ishin vënë opera të shekullit njëzet pasi ishin vënë vetëm opera klasike, etj, dhe unë kisha disa vite që vija në skenë opera kontemporane, opera moderne. I vija edhe në Akademinë e Arteve. Gjuha muzikore e kësaj opere është moderne, por ka dhe një tendencë melodie. Kryesisht është opera recitative...

aktivitet, por në vitin 1994 që e kam filluar kam bërë një spektakël me muzikë franceze. Sapo kisha ardhur nga Franca dhe bëra një grand spektakël me këngë franceze. Në atë koncert në Teatrin Kombëtar të Operës dhe Baletit morën pjesë këngëtarët më të mirë të muzikës sonë të lehtë, përmend këtu këngëtarin Manjola Nallbani, këngëtarin Aleksandër Gjoka, Ardit Gjebrea dhe të tjerë artistë. Një spektakël që u mirëprit shumë dhe u organizua në bashkëpunim me RTSH dhe Teatrin Kombëtar të Operës dhe Baletit. Por në vijim çdo vit e kam festuar Ditën Botërore të Muzikës me aktivitete të ndryshme, opera, koncerte, spektakle, muzikë klasike, muzikë moderne.

-Në skenën e Teatrit Kombëtar të Operës dhe Baletit me regjinë tuaj vite më parë u shfaq opera “Zëri njerëzor” e kompozitorit francez, Francis Poulenc. Një opera që u soll në skenë me interpretimin e një artisteje si Edith Mihali. Kanë kaluar vite, por si u prit nga publiku vepra e autorit francez Poulenc?

Vepra e autorit francez Francis Poulenc që është opera me një këngëtar erdhi në skenë në vitin 2002 me interpretimin nga sopranoja Edith Mihali, që u mirëprit nga publiku. Një opera, ku artistja është në një dialog me të dashurin e vet, i cili po ndahet prej saj. Një opera kontemporane që unë e kam rivënë sërish pas disa vitesh dhe e kam rivënë përsëri si një opera Holl me piano me katin e dytë të Teatrit Kombëtar të Operës dhe Baletit. Por e kam vënë dhe në Tetovë të Maqedonisë së Veriut me teatrin e Tetovës. Opera ishte një novitet për kohën, si për sa i përket në Shqipëri që nuk ishin vënë opera të shekullit njëzet pasi ishin vënë vetëm opera klasike, etj, dhe unë kisha disa vite që vija në skenë opera kontemporane, opera moderne. I vija edhe në Akademinë e Arteve. Gjuha muzikore e kësaj opere është moderne, por ka dhe një tendencë melodie. Kryesisht është opera recitative.

-Pse e zgjodhët veprën e autorit francez për ta sjellë atë kohë në skenë?

Unë kam vënë dhe vepra të autorëve francezë që ishin të panjohura më parë. Kisha kohë që hulumtoja dhe kam bashkëpunuar me Ambasadën Franceze edhe për vepra të tjera. Përsëmbull operën “Carmen” nga kompozitori Georges Bizet e kam vënë me tekst në gjuhë frënge në versionin origjinal. Kam vënë si regjisori në skenë operën “Peshkatarët e perlave” po të Bizet, etj. Por një nga veprat është dhe “Zëri njerëzor”.

-Jeni regjisori i shumë veprave të vëna në skenë në TKOB, të Universitetit të Arteve, të disa qyteteve të tjera si Durrësi, Shkodra dhe jashtë Shqipërisë: si: opera, opereta, spektakle. Por ju gjithmonë keni shprehur dhe rëndësinë e veprave shqiptare në skenë tonë. Sa ka rëndësi krijimtaria kombëtare për ju në skenë tonë?

Duhet të kemi më shumë vepra shqiptare në skenat tona. Veprat shqiptare duhet t'i mbrojnë

Festa e Muzikës

Festa e Muzikës e njohur gjithashtu edhe si Dita Ndërkombëtare e Muzikës festohet edhe në Shqipëri. Qëllimi është që Festa e Muzikës të institucionalizohet edhe në Shqipëri, duke krijuar një traditë të përhershme dhe një hapësirë të lirë për çdo muzikant, qoftë profesionist apo amator. Festa e Muzikës është krijuar nga Jack Lang, ish- Ministër i Kulturës i Francës në 21 qershor 1981

dhe festohet në të gjithë botën në formën e një festivali muzikor. Festa e parë e Muzikës u zhvillua në Francë dhe që prej herës së parë, ajo është kthyer në një fenomen ndërkombëtar dhe festohet në të gjithë botën, në të njëjtën ditë, në më shumë se 460 qytete në 110 vende, përfshirë Francë, Gjermani, Itali, Egjipt, Siri, Marok, Afrikë e Jugut, Australi, Vietnam, Kongo, Kili, Nepal, Japonia, etj.

vetë autorët, kompozitorët. Në një teatër opere kemi që duhet të vijojë me vënie e veprave shqiptare. Italianët kanë qindra teatro, por ne kemi një. Opera është një vepër muzikore letrare. Unë e kam treguar që kam vënë vepra shqiptare në skenë, si “Borana” të Avni Mulës, “Dhoma” e Ermir Dergjinit produksion modern shqiptar.

-Promovimit i librit tuaj “Mbi regjinë dhe aktrimin e kënduar në teatrin muzikor” në Fakultetin e Artit Dramatik

Gjatë promovimit të librit u kënaqëm shumë. U bë edhe një masterclass, ku u kënaqën studentët dhe unë. E veçanta e atij masterclass ishte se Universiteti i Tetovës i dha një rëndësi shumë të madhe. Më bënë një pritje të shkëlqyer edhe rektori i atij universiteti edhe dekani i Fakultetit të Arteve, si dhe vetë studentët që frekuentuan maksimalisht masterclass-in tre ditor. Por e veçanta në këtë masterclass është se morën pjesë si ata të muzikës edhe ata



në Tetovë ishte një aktivitet i organizuar dhe moderuar nga mexosopranoja e njohur Besiana Mehmedi. Në panel morën pjesë personalitete të botës shqiptare si Meriton Ferizi drejtor i Operas së Kosovës, Adelina Paloja, soprano e operas së Kosovës dhe pedagogu vokali, sopranoja e njohur Marjana Leka, dirigjenti Edmond Doko, etj. Libri “Mbi regjinë dhe aktrimin e kënduar në teatrin muzikor” është promovuar dhe në Tiranë më parë që u mirëprit, por një pritje e veçantë ishte dhe në Tetovë për ju. Çfarë ju fal kjo kur artistët mblidhen për artin, librin dhe krijimtarinë?

të dramës. Dhe realizuam së bashku një mbrëmje artistike me këngë dhe kërcime, sa që publiku në sallë u entuziazmuar jashtëzakonisht.

-Shkrimi i librave merr një pjesë të kohës suaj. A keni diçka tjetër për të cilën po shkruani?

Unë kam, por është ende shpejt për ta promovuar. Unë i kam të mbaruar dy libra me poezi, por po shkruaj një tjetër libër për profesionin. Libri që po shkruaj është në vazhdim i atij librit që promovuam më parë mbi regjinë dhe teatrin muzikor, por merret me aspekte të tjera.

Intervistoi: Julia VRAPI

Artisti dhe orkestra e tij rrëfen 15 vite histori të muzikës

Artisti Dren Abazi i shoqëruar nga Zig Zag Orchestra një koncert me këngë nga 15 vite karrierë muzikore

Nga Julia VRAPI

Artisti Dren Abazi dhe Zig Zag Orchestra vijnë me një koncert në Tiranë. Koncerti sjell për publikun këngë nga 15 vite karrierë muzikore të artistit të njohur. Dren Abazi është këngëtar-kompozitor, po ashtu, ai është themeluesi i Zig Zag Orchestra, një grup i njohur në Kosovë, Shqipëri, dhe vende të tjera të Ballkanit, që mbrëmjen e 4 korrikut do të jenë për publikun me koncert te stadiumi "Selman Stërmasi" në Tiranë. Sipas njoftimit të organizatorëve, artisti premton dy orë koncert me muzikë live. Dren Abazi dhe orkestra e tij rrëfen 15 vite histori të muzikës së shpirtit. "Si një surprizë unike, Dren Abazi, çdo herë që troket në Tiranë me muzikën e tij, kërkon të sjellë meloditë e tingujt e shpirtit, fjalët që rrëmbejnë zemra dhe performanca që kthehen në muza që i rrëfejnë atij për klipin e radhës...




Dren Abazi, çdo herë që troket në Tiranë me muzikën e tij, kërkon të sjellë meloditë e tingujt e shpirtit, fjalët që rrëmbejnë zemra dhe performanca që kthehen në muza që i rrëfejnë atij për klipin e radhës...

përmes interpretimit Dren Abazi dhe orkestra e tij. Merrni miq, në mos, mjafton shpirti dhe zemra që kërkon muzikë", thuhet nga organizatorët për këtë koncert. **Artisti dhe krijimet muzikore** Artisti Dren Abazi u bë i njohur që me produksionin e parë që publikoi. Kënga "Jorgjica" tërhoqi vëmendjen e të gjithëve teksa interpretohej nga ai dhe Zig Zag Orchestra. Pastaj me një ndër kryeveprat e muzikës shqiptare i thërriste shqiptarët drejt një shtegu artistik, ku "i dehur jam" nënkuptonte pas edhe "zjarr edhe akull". Prej më shumë se 15 vitesh, këngët e tij vijnë të zgjojnë të njëjtën ëndërr në publik. Me krijimet e tij të mëvonshme, ai do të shndërrohet në "mbretin e natës" që për pak vite arriti të

lërë "pa frymë" ata që kërkonin muzikën e mirë mbrëmjeve. Orkestra kompozon dhe performon muzikë trans-etnike dhe multikulturore. Që nga viti 2009, bendi ka performuar në disa koncerte dhe festivale në mbarë Evropën. Në vijim të aktivitetit muzikor, në vitin 2015 artisti i njohur Dren Abazi dhe Zig Zag Orchestra performuan në Jazz festivalin e famshëm në Sienne dhe në Sunset Festival në Paris. Po ashtu ai ka performuar edhe në festivalin Fete de la Musique i njohur edhe si Make Music Day në Paris. Koncerti që do të zhvillohet këtë mbrëmje të muajit korrik i shtohet gjithashtu aktivitetet e tjera që janë zhvilluar gjatë këtij sezoni veror në kryeqytet për publikun.

Forumi për Mbrojtjen e Trashëgimisë: Kafeneja po përdhos Akropolin e Butrintit

Parku kombëtar arkeologjik i Butrintit është një nga zonat më të rëndësishme të trashëgimisë sonë kulturore, por Forumi për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore sërish ka reaguar për dëmtimet që ndodhin në park. Një postim në rrjetet sociale FMTK ndërsa ka ndarë foto dhe i është drejtuar ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Blendi Gonxhja, tregon dhe abuzimet që po kryhen në park. "I nderuar zoti ministër i Kulturës Blendi Gonxhja. Kjo është pamja nga Akropoli i Butrintit sot në datën 29.06.2024. Makina e kompanisë së sallameve, të cilës kolegja juaj Kumbaro i dha me koncesion një godinë historike për ta shndërruar në kafe, është parkuar mbi monumentet e kulturës. Mund ta shikoni i nderuar z. ministër se si kjo makinë e kompanisë së sallameve qëndron e parkuar mbi një kishë mesjetare e gërmuar nga profesoresha e Sorbonës, Etleva Nallbani. Makina që furnizon kafënë e Kumbaros e bën përditë këtë ritual në sytë e të gjithëve vizitorëve dhe administratës shtetërore. Në fakt parkimi i përditshëm i kësaj makine mbi rrënojat antike është simbolika e përdhunimit, përcudnimit dhe talljes publike që Ministria e Juaj, AADF, BMF dhe të tjerë të ngjashëm i bëni pasurive të trashëgimisë kulturore shqiptare", shprehet Forumi për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore. FMTK ndërsa shpreh kritika për ish ministren Mirela Kumbaro thotë se personalitete të ndryshme kanë respektuar trashëgiminë kulturore në Butrint, por kafeja atje po përdhos Akropolin. "Që në krye të herës kur ministrja e Kulturës Kumbaro vendosi t'i jepte miqve të saj godinën historike të rojtarit të Butrintit për ta shndërruar në kafene, ishte e qartë se nuk kishte asnjë dhembshuri apo krenari për të ruajtur këtë trashëgimi. Kafeneja e Kumbaros, siç njihet sot nga punonjësit e Butrintit jo vetëm ka privilegjin të shesë ujë dhe pije me çmime stratosferike, por ka privilegjin që çdo ditë të parkojë makinën e saj mbi rrënojat antike në Akropol. Ndërkohë që njerëz fisnikë si presidenti Mejdani i zbriti makinën në hyrje dhe u fut me këmbë në Butrint, apo kryetarë shtetesh dhe personalitete të ndryshme e kanë respektuar shenjtërinë e kësaj kryevepre të trashëgimisë sonë, Kumbaro dhe kafeneja e saj përdhos përditë Akropolin e Butrintit", shprehet Forumi për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore. Në rrafshin ndërkombëtar, rëndësia e qytetit antik u njoh dhe u konfirmua si e tillë në vitin 1992, kur ai u përfshi në listën e pasurive botërore të UNESCO-s



Punimet restauruese në Teatrin Kombëtar të Kukullave

Punimet restauruese në Teatrin Kombëtar të Kukullave po vazhdojnë në kuadër të programit EU4Culture. Në Ditën Ndërkombëtare të Parlamentarizmit, programi EU4Culture shprehet se ndërtesa do të ketë përmirësime. "Pas kryerjes së funksioneve të ndryshme ndër vite, në vitet 1960, ndërtesa u shndërrua në Teatrin Kombëtar të Kukullave, rol që vazhdon ta kryejë edhe sot e kësaj dite. Ndërtesa

po i nënshtrohet punimeve restauruese në kuadër të programit EU4Culture. Me përfundimin e tyre, Teatri Kombëtar i Kukullave do të ketë përmirësime në përputhje me standardet bashkëkohore të performancës audio-vizuale, me një skenë dhe auditor multifunksional", thuhet në faqen e programit ndër të tjera. Përmes programit EU4Culture janë restauruar dhe të tjera objekte në vendin tonë.

Karnavalet mbyllin Javën Kulturore Braziliene

Javët Kulturore Ndërkombëtare sollën për herë të parë në Shqipëri, Javën Kulturore Braziliene. Ministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Blendi Gonxhja shprehet në rrjetet sociale se java u përmbyll me shfaqjen spektakolare të karnavaleve braziliene në Vlorë. "Vetëm një hap larg detit, në Lungomaren e bukur të Vlorës, ky manifestim kulturor organizuar nën kujdesin e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe

Inovacionit solli ritmet, ngrohtësinë dhe ngjyrat e Brazilit, me perkusionistë të talentuar, balerina dhe kërcimtarë profesionistë të Capoeira. Pjesë e paradës shumëngjyrëshe të karnavaleve braziliene të famshme në të gjithë botën, u bënë edhe pushues e turistë të shumtë në Vlorë", shprehet ministri. Nën kryetarja e Bashkisë Vlorë, Irena Toshkallari theksoi se ky organizim i sjell Vlorës një tjetër dimension turizmi.

"Bëhu trim pinguini vogël" shfaqet për fëmijët te Parku Rinia

Shfaqja "Bëhu trim pinguini vogël" u shfaq për fëmijët te Parku Rinia, Tiranë. Regjia dhe koreografia Semela Skënderasi, performues Valentina Myteveli, Erta Sina, Denis Duro, Semela Skënderasi. Shfaqja për fëmijë e titulluar "Bëhu trim pinguini i vogël" ka në qendër pinguin Pip - Pip, i cili ka frikë nga uji. Skenografia Beqo Nanaj, kostumet Sofi Kara, teksti Valentina Myteveli dhe

video art Renato Aliçkollli. Shfaqja "Bëhu trim pinguini vogël" është dhënë dhe më parë në skenë për fëmijët. Kjo shfaqje që u dha për fëmijët këto mbrëmje vere vjen në vijim dhe të atyre më parë. Në programin e Teatrit Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivgli" pjesë e aktivitetit artistik janë dhe realizime shfaqjesh të ndryshme për fëmijët, që jepen si në skenën teatrore, por dhe në hapësira jashtë.

Jasir Asani gjithnjë e më pranë firmës me Las Palmas në Spanjë

Merkato e verës mund të prodhojë surpriza të mëdha për lojtarët e përfaqësueses tonë, pasi kanë marrë oferta të çmendura nga klube të njohura në top-ligat europiane, klube që do ta certifikojnë karrierën e tyre të spikatur me një notë më të lartë se deri më tani. Kështu, një prej tyre, Jasir Asani, është gjithnjë e më pranë transferimit në La Liga. Las Palmas është skuadra që e kërkon prej muajsh dhe e do me çdo kusht anësorin ofensiv të kombëtares së Shqipërisë. Gëangju u bë pengesë në janar, duke kërkuar një shumë më të madhe seç ofronte skuadra spanjolle. Pikërisht mungesa e marrëveshjes për këtë lëvizje

bëri që Asani dhe klubi korean të prishnin marrëdhëniet mes tyre. Futbollisti shqiptar nga Shkupi u dënua nga Gëangju dhe për muaj me radhë nuk u grumbullua nga skuadra! Las Palmas nuk hoqi dorë dhe në merkaton e verës është paraqitur sërish tek koreanët, me një tjetër ofertë. Duke qenë se kontrata e Asanit përfundon në fundin e vitit, Gëangju nuk dëshiron ta humbë me parametra zero. Dhe është i hapur për të dëgjuar propozimet. Klubi iberik ka ofruar një shumë që arrin shifrën 1 mln euro për kartonin e 29-vjeçarit, ndërkohë që marrëveshjen me lojtarin e ka arritur prej ditësh. Asani ka udhëtuar drejt

Koresë së Jugut në fundjavë, aty ku ka takuar trajnerin dhe ka marrë miratimin e këtij të fundit për këtë transferim. Fillimi i javës së ardhshme do të jetë shumë i rëndësishëm për këtë operacion. Asani do të bëjë dhe një takim me drejtorin e klubit, për të mbyllur përfundimisht një herë e mirë këtë histori. Sulmuesi i djathtë është gati të hedhë hapin e madh të karrierës me transferimin në një nga ligat kryesore të Europës. Nëse gjithçka mbyllet me sukses gjatë këtyre ditëve, Asani do të bashkohet menjëherë me skuadrën për të nisur përgatitjet për sezonin e ri. Që do të nisë në mesin e muajt gusht.



Sulmuesi kuqezi kërkoj sërish ndjesë, duke thënë se ishte kapluar nga emocionet

Daku ulet me këmbë në tokë, u tregon rusëve çfarë ndodhi me shpërthimin e tij në European

Adriatik BALLA

Sulmuesi kuqezi, Mirlind Daku, mori altoparlantin në duar dhe nisi një këngë fyese ndaj serbëve e verimaqedonasve në European. Momenti u incizua dhe më pas Daku u dënua me dy ndeshje moslojë nga UEFA. Kishte reagime të shumta edhe në Rusi. Klubi i tij, Rubin Kazan, ka njoftuar se do ta dënojë futbollistin. Daku kishte kërkuar falje përmes një postimi, ndërsa të dielën mediami rus "Sport-Express" publikoi një intervistë me 26-vjeçarin. "Natyrshisht, kjo javë ishte shumë e vështirë. Jam përballur me presion që nuk e kam pasur asnjëherë. Isha në qendër të një skandali, për të cilin jam i turpëruar. Nuk kam dashur të nxis një situatë të tillë, pa përmendur që kjo ngjalli valë reagimesh në media. Çdo gjë doli nga kontrolli. Pas gjërave si kjo, gjithnjë filloj të stresohem. Këto mendime dhe përvojë nuk më lëshojnë", ka thënë Daku, sipas gazetës ruse.

Përmbajtja e intervistës

Daku bëri një shpjegim të situatës. "Pas ndeshjes së parë në Evropian me Italinë, mbrojtësi ynë, Elseid Hysaj, ka pranuar shumë kritikë nga tifozët. Jo vetëm



tifozët por edhe mediat kanë bërë presion ndaj tij. Pas ndeshjes me Kroacinë, kam dashur ta mbështes atë dhe kam shkuar së bashku me të te tribuna e tifozëve, që tifozët ta pranojnë atë, ta përkrahin dhe që të ndajmë momentin e gëzimit me të. Ata më pas i dhanë atij altoparlantin dhe unë isha afër. Më pas altoparlanti ishte në duart e mia dhe unë i thash ato fjalë. Në ndeshje si ajo, tifozët shpesh lejojnë veten të bëjnë thirrje ofenduese ndaj tifozëve të vendeve tjera. Kjo atmosferë të shoqëron gjatë ndeshjes dhe të mbërthen. Ndikon te të gjithë në stadium. Ajo ndeshje kishte fund emocional – shënuam golin e barazimit në minutën e fundit dhe unë bëra debutimin në Evropian. Kështu që emocionet ishin shumë

të mëdha. Por kjo nuk më justifikon. Menjëherë më pas e kam kuptuar se çka kam bërë: kam thënë gjëra të papërshtatshme. Isha i shokuar që lejova emocionet të më kaplojnë dhe që lejova veten të bëj gjëra të tilla. Më e rëndësishmja, nuk është dashur të them fjalë të tilla për asnjë popull. Është thjeshtë e papranueshme. Është akt i tmerrshëm dhe nuk më vendos në pozitë të mirë. Pas asaj që ndodhi federata serbe nuk ka dërguar ankesë zyrtare në UEFA. Nuk kishte ankesë specifike ndaj meje. Por e përsëris që situata nuk më vendos në pozitë të mirë. Jam pishman dhe kërkoj falje ndaj të gjithëve që janë lënduar nga ky veprim", vijoi Daku.

Qëndrimi karshi klubit

Daku theksoi se ka raporte të

"Futbollisti gjilanas i ka kërkuar falje ekipit, menaxhmentit të ekipit dhe stafit të trajnerëve. Ka thënë se ka ndier vazhdimisht përkrahjen e tyre. Ka pranuar që ka gabuar, ndërsa ka shtuar se vetëm me sjelljet e tij mund të dëshmojë që kjo mund t'i ndodhë çdokujt..."

mira dhe madje miqësore me lojtarët serbë të Rubin Kazanit. Futbollisti gjilanas i ka kërkuar falje ekipit, menaxhmentit të ekipit dhe stafit të trajnerëve. Ka thënë se ka ndier vazhdimisht përkrahjen e tyre. Ka pranuar që ka gabuar, ndërsa ka shtuar se vetëm me sjelljet e tij mund të dëshmojë që kjo mund t'i ndodhë çdokujt. Ai e kupton vendimin e klubit për ta dënuar. Thotë se është logjike. Ai pritet të kthehet së shpejti në Rusi. Por edhe një transferim në ndonjë vend tjetër nuk përjashtohet. "Më është dhënë një pushim i shkurt pas grumbullimit me ekipin kombëtar. Duhet të fokusohemi në punë. Do të mundohem t'ua dëshmojë të gjithëve se kjo nuk do të më ndodhë në të ardhmen", ka thënë Daku.

Legjionarët/ Indrit Tuci shkëlqen me Spartën e Pragës

Lojtarët shqiptarë që po luajnë në Europë po rrisin kreditet e tyre, duke u shfaqur gjithnjë e më të respektuar, më autoritarë dhe me më shumë minuta në këmbët e tyre. Një pjesë i janë ngjitur ekipit përfaqësues dhe kanë kapur majat e karrierës së tyre. Ka të tjerë që po paraqiten në nivel të lartë dhe shpresojnë të kapin grumbullimet e Kombëtares. Indrit Tuci vijon

përgatitjet për sezonin e ardhshëm me klubin çek të Spartës së Pragës, teksa pasditen e të shtunës ka shënuar një gol spektakolar në miqësoren ndaj suedezëve të AIK. Sulmuesi shqiptar u aktivizua titullar dhe luajti gjithë pjesën e parë, duke qenë se në pjesën e dytë trajneri i klubit çek vendosi të ndërrojë të gjithë skuadrën. Kur kronometri shënonte minutën e 27-të, Tuci

lëshoi një goditje spektakolare nga kufijtë e zonës, duke dërguar topin në trekëndëshin e portës së suedezëve dhe duke u dhënë avantazhin çekëve. E nëse Tuci po shfrytëzon mundësinë për të forcuar pozitën në formacion, shqiptari tjetër i Spartës së Pragës, Qazim Laçi nuk është paraqitur ende në grumbullim. Mesfushori ishte pjesë e Shqipërisë në Euro 2024



dhe do të bëjë pushimet, për t'u bashkuar me ekipin çek vetëm pas 15 korrikut.

MESFUSHORI

Ylber Ramadani mund të ikë nga Leçe, ka oferta nga klube të mëdha

Ylber Ramadani në modë. Mesfushori kuqezi, pasi zhvilloi kampionat shumë pozitiv në Itali me modestët e Leçes, tregoi një formë të mirë edhe në European. Ramadani ishte i ftuar në Kosovë në një emision, teksa pranoi se ka oferta dhe se mund të ndërrojë mjedis. "Ka patur oferta, por nuk mund të flas pa u konkretizuar. Kam oferta, pasi kam bërë sezon të mirë. Pa u arrit marrëveshja nuk mund të flas", tha ai për "Euro Dueli". Ramadani luajti në 3 ndeshjet e grupeve në European, atë ndaj Italisë, Kroacisë dhe Spanjës.

VLERËSIMI

Mediat italiane elozhe Granit Xhakës

Zvicra fitoi ndaj Italisë 2-0, për të kaluar në çerekfinale të Euro2024. Freuler dhe Vargas realizuan golat në këtë sfidë. Mediami italian, "Tuttomercatoeb", shkruan se Granit Xhaka dhe Freuler e dominuan ndeshjen. "Freuler, përveç golit të hapjes, e certifikoi paraqitjen me një ecuri të vazhdueshme, së bashku me Xhakën që nuk i la lojtarët tanë të preknin topin. Formë e shkëlqyer fizike dhe tani në çerekfinale zvicranët duan të vazhdojnë kështu", shkruan "Tuttomercatoweb".

DEKLARATA

Munishi: Duka mund të bëhet president i UEFA-s

Tekniku kosovar Ismet Munishi, në një prononcim televiziv tha se parashikon që Armando Duka do të bëhet president i UEFA-s. "Ne duhet të pranojmë që nuk kemi pasur njeri që na prezanton më fuqishëm në futboll se Duka. FSHF e ka organizuar në nivele fantastike, pasi asnjë proges, asnjë kualifikim nuk arrihet rastësisht. Nëse dëgjoni deklaratat e Dukës nëpër vite, është përmirësuar shumë edhe në këtë aspekt. Nuk do të çuditesha nëse Duka bëhet nesër presidenti i UEFA-s", tha Munishi.

Shpendi rrëfen emocionet e sezonit të parë me Çezenën në Serie B

Në Itali luan një kontigjent i rëndësishëm i futbollistëve që janë pjesë e skuadrave tona kombëtare. Sulmuesi i kombëtares U-21 të Shqipërisë, Kristian Shpendi, ishte protagonist absolut i ngjithjes së Çezenës në Serie B, me 20 gola në në kampionat, 1 në Kupën e Italisë dhe 1 në Superkupë, duke dhënë edhe 6 asistime. Një formë e cila tërhoqi vëmendjen e disa klubeve, mes të cilëve edhe Parmës, që sezonin e ardhshëm do të konkurrojë në Serie A. Në një intervistë të dhënë së fundmi për mediet italiane, shqiptari u shpreh se kaloi një sezon perfekt dhe se i detyrohet shumë klubit

të Çezenës. "Ishte një sezon perfekt. Kur skuadra filloi të ecë, edhe unë fillova të shënoja me vazhdimësi. Dy vjet më parë unë fitova kampionatin dhe Superkupën me Primavera-n, por të ishe pjesë e ekipit të parë ka një vlerë tjetër në rrugëtimin tim, unë dhe vëllai im i detyrohemi Cesena-s"-deklaroi Shpendi. Ndërsa i pyetur për të atin, sulmuesi i "Shpresave" tha: "Ai mbaronte turnin në punë, megjithatë gjithmonë gjente forcën apo kohën të na linte të luanim dhe na ndoqi kudo duke hequr dorë nga shumë gjëra. Sulmi ndaj Rinaldit pas ndeshjes ndaj Olbias? Ai reagoi keq, ai nuk nuk

e mendoi mirë çfarë po bënte, por ishte i pari që kërkoi falje. Ai episod nuk më ndikoi aspak dhe nuk do të më bënte të ndryshoja mendimin tim për të", theksoi Shpendi. Lojtari është nga pikat e forta të përfaqësueses U-21 dhe besohet se mund të jetë në vitet në vazhdim një nga pikat e forta të Kombëtares kuqezi. Mbetet të shihet nëse Silvinjo (pasio të konfirmohet si trajner i Kombëtares), do ta ftojë atë në radhët e ekipit të parë në fazën kualifikuese në Ligën e Kombeve. Mementalisht Shpendi po synon të përmirësohet dhe të rrisë potencialin e tij me skuadrën e vet në Itali.



Ikona e Partizanit dhe Kombëtares në kohë të vështirë u nda nga jeta në moshën 81-vjeçare

Shuhet Bejkush Birçe, "Gjenerali" i futbollit shqiptar

Adriatik BALLA

Një nga emrat më të fuqishëm të futbollit tonë, Bejkush Birçe, u nda dje nga jeta në moshën 81 vjeçare. Ishte padyshim ndër kuadrot më të aftë e më autoritarë të futbollit tonë, multidisiplinor si sportiest e si trajner, njeri të cilin e karakterizoi gjatë gjithë jetës profesionalizmi, atdhetarizmi dhe humanizmi. Bejkush Birçe, është konsideruar në media edhe si "gjenerali" i futbollit shqiptar, për shkak të kontributit të tij të çmuar në rritjen e cilësisë sportive në kampionatin shqiptar dhe në ekipin përfaqësues që e drejtoi në vite shumë të vështira. Homazhet për Bejkush Birçen do të zhvillohen ditën e hënë në ambientet e stadiumit "Air Albania", duke nisur nga ora 11:00.

Duka: Humbëm një personalitet të futbollit

"I pikëlluar pas lajmit të ndarjes nga jeta të Bejkush Birçes! Kemi humbur një nga njerëzit me më shumë kontribute në futbollin shqiptar, si lojtar, trajner e drejtues në FSHF. Kemi humbur një njeri me karakter të fortë, një mik dhe një familjar shumë të mirë. Në emrin tim dhe të komunitetit



të futbollit shqiptar, dua t'i shpreh ngushëllimet e mia familjes, së afërme dhe miqve, të cilët kanë humbur një njeri shumë të dashur për ta. U prehsh në paqe Bejkush Birçe!", shkruan Presidenti Duka në statusin e tij.

Qëndrimi i klubit "Partizani"

Legjenda e futbollit shqiptar, Bejkush Birçe u nda nga jeta ditën e djeshme. Për këtë lajm të trishtë ka reaguar edhe ish-klubi i tij ku ka luajtur, Partizani. Në faqen zyrtare shkruhet: Familja e kuqe dhe futbollit shqiptar humbin një kolos. Me keqardhje të thellë mësuam sot lajmin e trishtë të ndarjes nga jeta në moshën 81

vjeçare të ikonës së klubit tonë dhe futbollit shqiptar Bejkush Birçe. Komuniteti i futbollit dhe familja e kuqe humbet një nga njerëzit me më shumë kontribute në futbollin shqiptar, si lojtar, trajner e drejtues. Birçe pjesën më të madhe të karrierës së tij e kaloi si futbollist dhe më pas si trajner te Partizani skuadër me të cilën fitoi dy tituj kampion radhazi në vitet 1979 dhe 1981 si dhe një trofe të Kupës së Shqipërisë. Klubi i Futbollit Partizani dhe veçanërisht presidenti Gazment Demi i përcjellin ngushëllimet më të sinqerta familjes dhe të afërmeve, për këtë humbje të madhe", shkruhet në

"Ai qëndroi deri në fund një zë i fortë në mbrojtje të klubit, stemës së tij dhe trashëgimisë që Partizani kishte dhe ka në futbollin shqiptar..."

komunikatën e klubit të kuq. Theksojmë në fund se Gazeta "SOT" e ka intervistuar shumë herë legjendën e futbollit shqiptar gjatë 10-15 vjetëve të fundit, ku ka marrë mendime për futbollin në tërësi, por edhe për atë që ngjau me klubin Partizani pasi humbi infrastrukturën e tij si pasojë e prishjes së ambienteve të klubit dhe kthimin e këtyre ambienteve në truall ndërtimi. Për këtë çështje ai foli me autoritet, duke dalë në krah të klubit dhe duke akuzuar për prishjen e infrastrukturës më të madhe sportive që kishte ndonjë klub shqiptar deri në atë moment. Ai qëndroi deri në fund një zë i fortë në mbrojtje të klubit, stemës së tij dhe trashëgimisë që Partizani kishte dhe ka në futbollin shqiptar, një qëndrim prej profesionisti dhe dashamirësi të madh të futbollit.

LËVIZJA

Gripshi lë Ballkanin, i bashkohet Astanës në Kazakistan

Një ndër futbollistët më cilësorë të Ballkanit, Nazmi Gripshi, do të jetë pjesë e Astanës në Kazakistan në dy sezonet e ardhshme. 26-vjeçari durrsak ishte pjesë e klubit nga Theranda në 4 vitet e fundit, gjatë së cilave fitoi 3 tituj kampionë, 1 Kupë Kosove dhe 2 Superkupa. Mesfushori i avancuar garoi dy herë në fazën e grupeve të Conference League me skuadrën e drejtuar nga Ilir Daja. Gripshi ka dalë lojtar i lirë dhe ka gjetur marrëveshjen me rekordmenët e futbollit kazak me 7 tituj kampionë.

SHQETËSIMI

Ismajli i kërkoi sqarim, Silvinjo s'i dha përgjigje

Mbrojtësi Ardijan Ismajli e ka takuar gjatë Europeanit trajnerin Silvinjo dhe i ka kërkuar sqarime se pse nuk aktivizohet, por braziliani ka preferuar të mos i japë një përgjigje të prerë e të qartë dhe ka bërë një zgjedhje ku i ka lënë të kuptohet se mes tij dhe Ajetit tekniku ka zgjedhur Ajetin dhe këtë e vërteton fakti se në të tri ndeshjet në grup, Silvinjo e zgjodhi Ajetin krah Gjimshitit në Europeanin e Gjermanisë. Por një "sqarim" i tillë e ka futur në krisje raportin me Ismajlin.

SURPRIZA

Çelsi mund ta shesë Brojën, shkak holandezi

Një tjetër klub ka dalë në skenë për të ardhmen e Armando Brojës. Evertoni ka gati 30 mln paund për kartonin e sulmuesit shqiptar, të cilin e pret një pagë prej rreth 5 mln paundësh në sezon. Por shërbimet e Brojës i janë ofruar bardhezinjve të Njukasëllit, po në Premier League. Aleksander Isak është objektivi i Çelsit në sulm dhe për të mbërritur tek ai londinezët janë gati të "saktifikojnë" 3 futbollistë, mes të cilëve edhe Brojën, lojtar që nuk mundi të marrë 100% të minutave në European.

Statistika/ Shqipëria, një nga 4 tifozëritë më të mëdha në European

Kombëtarja është eliminuar nga Euro 2024, me kuqezinjtë që morën vetëm 1 pikë në 3 ndeshje. Por pavarësisht kësaj tifozët shqiptarë pushtuan çdo qytet ku Kombëtarja luajti ndeshjet e saj. Fillimisht Dortmundin më pas Hamburgun dhe në fund Dusseldorf, tifozat kuqezi mbushën rrugë, sheshe dhe tribuna. Si kurrë më parë, në Gjermani ishin mbi 95.000 tifozë shqiptarë të cilët kanë përkrahur Kombëtares nga shkallët e stadiumit. Mediat gjermane kanë publikuar listën e kom-

bëtareve me mbështetjen më të madhe të tifozëve në fazën e grupeve në Euro 2024. Kombëtarja shqiptare lë pas ekupe me emër, teksa kalohet nga Turqia, Gjermania dhe Kroacia. Kështu lëmë prapa ekupe si Anglia, Franca, Spanja, Italia, Zvicra, Polonia apo Portugalia. Lista e plotë e kombëtareve me më së shumti tifozë të pranishëm në Euro 2024: Turqia: 130,000, Gjermania: 125,000, Kroacia: 103,000, Shqipëria: 95,000, Rumania: 92,000, Skocia: 82,000, Holanda: 80,000, Serbia: 73,000, Polonia: 70,000, Anglia:



65,000, Austria: 60,000, Danimarka: 60,000, Gjeorgjia: 60,000, Ukraina: 53,000, Belgjika: 50,000, Hungaria: 46,000, Sllovenia: 44,000, Franca: 41,000 etj.

kulturë

Usher nuk dëgjon kritikët, por gjithmonë fokusohet tek karriera e tij

Këngëtari i njohur Usher synon që të fokusohet gjithmonë tek vetja dhe karriera e tij. Ai ka thënë se njerëzit nuk duhet të përfshihen në atë që të tjerët mendojnë për ata. “Unë nuk besoj se çfarë mendojnë të tjerët për mua. Unë i inkurajoj njerëzit të bëjnë të njëjtën gjë dhe të mos përfshihen në atë që njerëzit e tjerë mendojnë për ata”, ka thënë Usher në një intervistë për “Extra” duke folur

për qasjen e tij ndaj jetës. Usher ka nisur një jetë të re në Las Vegas në vitin 2023, dhe ylli fitues i çmimeve tani thotë se i është dhënë një mundësi e re. Usher performoi në fillim të këtij viti në “Super Bowl” dhe këngëtari më parë kishte deklaruar se ky ishte një moment historik në karrierën e tij. Ai ka shpjeguar se performanca e tij në stadiumin Allegiant në Las Vegas ishte një

“testament i përkushtimit”. “Unë nuk e kam shijuar këtë moment i vetëm. Të gjithë fansat e mi që sjell me vete, çdo person që kishte lidhje me muzikën, krijimtarinë, të gjithë janë pjesë e këtij momenti festiv”, ka deklaruar ai për Entertainment Tonight. Usher Raymond IV, i njohur profesionalisht si Usher njihet si një figurë me ndikim në muzikën bashkëkohore R&B dhe pop.



FJALEKRYQI SOT

1	2	3			4	5	6			7	8	9	10		11
12				13					14						
15			16					17						18	
		19				20							21		
	22					23						24			
25					26					27					
28				29					30						31
32			33					34						35	
		36						37					38		
39						40						41			

HORIZONTAL

1- Ish presidenti i SHBA Xhorxh ... (2001-2009) 4- I thuhet tepsisë prej bakri me buzë të kthyer 7- Janë parazitë të vegjël 12- Kafshë e egër e pyjeve tona 13- Ajo është burimi i të gjitha të mnirave materiale 14- Ish futbollisti anglez i viteve 1985 Kigan 15- Theodhori i këngës 17- Është lidhëz që shpreh një dëshirë për miratim 18- Gëlltit ose ... 19- Një lagje e vjetër në Shkodër afër kalasë 20- Medikament që lufton malarien 21- Jo shumë 22- Ajo e Arkimedit 23- Kamberi Aktor 24- Grup këngëtarësh prej tre vetash 25- Një opera e Puçinit 26- Lluakaçi, aktor estrade 27- Një opera e Pjetër Mankanit 28- Profil metalik 29- Një qytet bregdetar në jug, i pashquar 30- Është gjini e letërsisë artistike që përpunohen e përshtaten për tu vënë në skenë 32- Pohojnë rusët 33- I thatë, lungë me qelb 34- Potere 36- Ato mund të jenë elektromagnetike 37- Është gaz i plogët dhe i rrallë, përdoret në llambat për ndriçim 38- Pije alkoolike që përdornin më parë piratët 39- Një hotel luksoz në qendër të Tiranës 40- Njomësia që mban në vetvete toka 41- Nasi i shkrimeve.

VERTIKAL

1- Ymeri aktor 2- Nevojë e ngutshme për ushqim 3- Në kimi quhet procesi kimik për përfitimn e elementeve me anë të bashkimit të substancave 4- I thonë ndryshe drerit apo drenushës 5- Gjika e skenës tek filmi “Vetmi” 6- Përemër vektor 7- Një shtet pothuajse në zemër të Europës 8- Shkencëtari rus për trurin Pavlov 9- Stacioni ndërplanetar rus në hapësirë 10- Kidman, aktore australiane, në inic 11- Veshje dimërore 13- Arshi..., gjuhëtar dhe akademik shkodran 14- Degë e muzikës në Institutin e Lartë të Arteve 16- Është kafsha më elegante e Savanës 17- Kështu quhej më parë Egjipti 18- Plotëson nevojat për një marshim 20- Lloj peshku liqeni me pika të kuqe në trup 21- Diçka parësore, e dorës së parë 22- Një ndër shfaqet e para të baletit shqiptar 23- Pagesë mbi vlerën e faturës 24- Autobus mbi shina 25- ... Shtylla, ish Kryetar i Kuvendit (1958- 1963) 26- Një qytet në verilindje të vendit 27- Një shtet në Lindjen e mesme 29- Përpjekje për të mashtrua, dredhi për mashtrim 30- I thonë ndryshe dërrasës së zezë 31- Një gazetë e përditshme 33- Aktori i Hollywood-it, Xheki ... 34- Dert, anglisht 35- Rrethi çiklistik i Francës 36- Valët Galaktike 37- Natasha aktore në inic.

SUDOKU

	8														
9				6	8										
		1	3		7									6	
5	7				2			3							
4														5	
	9		8						4	2					
8			5		4	6									
			2	3										4	
														5	

			4		7										
2						1	7	6							
				6			4	5							
	6		7			8									
4													7		
		2			8		9								
7	8			1											
5	9	6											8		
				6		3									

						1						8	5		
8									7						
3			5	4											
	6							9							
	4		6								5	3			
	3			2				9					4		
		2													
						1						8	6		
												1	4	5	

Sondazhi për “Eurovision”, zviceranët kundër organizimit

Një sondazh i bërë në Zvicër, nga rreth 25.000 zviceranë, 49 për qind e tyre kanë thënë se nuk duan që vitin e ardhshëm “Eurovisioni” të organizohet në shtetin e tyre. Këtë sondazh e ka bërë mediumi zviceran, Blick, ku shumica e qytetarëve u shprehën kundër, ndonëse Nemo e fitoi sivjet këtë garë, e sipas rregullit shteti fitues duhet ta organizojë vitin pasues. 46 për qind të anketuarve thanë se janë pro mbajtjes së “Eurovisionit”, por 5 për qind nuk shprehën ndonjë mendim. Ende nuk dihet se në cilin qytet do të mbahet “Eurovisioni”, por Zyrihu dhe Gjeneva kanë aplikuar. Nemo me këngën “The Code”, përfaqësuesi i Zvicrës u shpallu fitues i “Eurovision 2024”. Në këtë edicion të 68-të, Zvicra u votua me 365 pikë nga votat e jurisë, ndërkohë iu shtuan 200 pikë nga votat e publikut.



Nuk para rrezohem...

Nuk para rrezohem... Ama kur rrezohem sigurohem që ta përqafoj me mish e me shpirt asfaltin në rrugë.

Dy policët bien në pusëtë

Ishin dy policët në orën 2:00 të natës, duke ecur rrugës për në shtëpi. Por ata bien në një pusëtë të ujërave, por përpiqet polici i parë për të dalë dhe nuk mundet dot. Ndërsa tjetri i thotë provoja edhe një herë nëse nuk dalim hajde të ikim në shtëpi.

Ëndrra

Nipi sapo ngrihet në mëngjes nga shtrati drejtohet tek gjyshi, të cilit pasi i dhuron puthjen e mëngjesit, i thotë tepër i gëzuar: -Gjyshi, gjyshi këtë natë kam parë një ëndërr tepër të bukur. Ti më dhurove dhjetë euro. Gjyshi, për të mos mërzhitur nipin i thotë: -Në rregull, meqenëse kohët e fundit je sjellë tepër mirë me mua, atëherë mund ti mbash lekët dhe të blesh të gjitha gjërat që dëshiron.

kulturë

Për të rritur numrin e banorëve, në qytetin suedez Goetene po shitet tokë për vetëm 8 cent për metër katror. Është një qytet me 5000 banorë që po përpiqet të zgjidhë çështjen e plakjes së popullsisë dhe rënies së natalitetit, shkruan CNN. "Absolutisht kushdo mund të blejë një nga parcelat. Nuk ka rregulla apo kërkesa lidhur me atë se kush mund të blejë një parcelë", ka thënë kryetari i bashkisë Goetene, Johan Mansson. Ai nuk specifikoi nëse kërkesa është të ketë vendbanim në Suedi apo nënshpëtim suedez, por supozohet se vetëm ata që jetojnë ligjërisht në Suedi do të mund të blejnë tokë, siç thotë ligji.

Goetene, ku një metër katror tokë shitet 8 cent



Përgjigjet e fjalëkryqit

A	N	I	L	A	M	E	R	I	T
S	V	E	N	D	A	L	I	U	
P	P	K	O	R	D	A	S	K	
A	R	I	N	I	K	T	K	A	
K	E	N	A	N	I	T	R	A	T
F	A	R	A	D	R	I	N		
R	E	T	I	N	5/A	E	M	E	R
I	K	I	I	1/K	A	A	R	I	
M	T	A	L	2/E	T	E	I	T	
E	S	P	I	3/R	A	L	E	E	
L	O	T	I	N	K	A	S	E	M

35 telefona nuk do të marrin më përditësime të WhatsApp

Janë 35 telefona nga markat e njohura, duke përfshirë Samsung, Motorola, Sony dhe Apple, që nuk do të marrin më përditësime të WhatsApp, ka zbuluar një raport i ri. Në përditësimin e saj të fundit, platforma në pronësi të Meta-s ka ndryshuar kërkesat minimale të sistemit, duke prekur përdoruesit me telefona më të vjetër. Lista përfshin: Samsung: Galaxy Note 3, Galaxy S3 Mini, Galaxy S4 Mini, Galaxy Ace Plus, Galaxy Core, Galaxy Express 2, Galaxy Grand, Galaxy Note 3 dhe Galaxy S4 Zoom; Apple: iPhone 5, iPhone 6, iPhone SE, iPhone 6S dhe iPhone 6S Plus, etj.

Fjalëkryq i shifruar

5	7	6	13	9		7	8	4	5	7
2		14	4	11	1	8	2	12		5
11	14		9	2	11	1	9		3	2
8	1	3		10	4	9		5	2	5
4	12	7	8		9	7	6	15	10	7
	4	8	2	3		8	15	11	7	
4	11	4	3	1	6/S		10	2	9	7
11	7	12		10	4/A	9		8	12	11
4	8		11	4	8/T	4	11		10	2
4		9	4	12	1/I	14	4	10		6
8	7	6	8	1		4	3	4	12	1

1			2	3		4	5			6
			7		8					
		9						10		
11	12			13				14	15	
16			17				18			
	19					20				
21					22					
23				24						25
26			27						28	
		29						30		
	31						32			
33						34				
35					36		37			38
39				40		41		42		
		43	44				45			
			46							
47								48		

HORIZONTAL

1- Është ai që kryen një punë në vendin tënd
4-Lloj peshku liqeni me shumë hala 7-Jurist që merret me identifikimin e dokumentave
9- Shkëmbinj me ngjyrë hiri në të bardhë, përdoret për të prodhuar xhamat 11-Njëllor si egoja 13-Një firmë e njohur karburanti në Itali 14-Organizatë terroriste baske 16- Piktori shkodran Idromeno 18- Lëng i hidhur që prodhon mëlçia 19- Poeti dhe piktori Maks... 20-Një gjarpër shumë i rrezikshëm 21-Lopatat e lundëtarit 22- Kripë e kaliumit shërben për prodhimin e plehrave kimike, sapunit etj. 23- Profil metalik 24- Taksë apo detyrim që i paguhet një shteti tjetër që e ka mundur në luftë 26-Përemër vector 27- Janë konstruksione betoni për ndërtim 28- koraca në makina 29- Është fsht i Fierit 30- Një prift ortodoks 31- Marçello..., ish-futbollist kilian 32- Lloj të qethure 33- Rracë e përzierë 34- Figurë tek letrat e bixhozit 35- I thonë edhe masat, copë çeliku për të ndezur eshkën 37-... Liza, (Xhokonda) pikture e Leonardo da Vinçit 39- Bakër ose... 40- Zakon, adet, huq 42- Lojë në fushën e shahut 43- Ai i llampës magjike 46- Kështu quhej më parë vendi ynë 47- Ai vërteton identitetin 48-Piktura të shenjtoreve në dru.

VERTIKAL

1-Vegël muzikore karakteristike greke
2- Koço i muzikës 3- Një ndër shfaqjet e para të baletit shqiptar 4- Disponojmë 5- Kafshë e egër e pyjeve tona 6- Shkretëtirë e gjerë në qendër të Afrikës 8- Edmondi tek filmi "Si gjithë të tjerët" 9- Jam në hall, në mëdyshje apo në ... 10- Një fshat i Vlorës 12-Tregim i gjatë që përshkruan ngjarje nga jeta 15- Ai i Pojanit, pa të fundit 17- Tase e volejbollit 18- Ato janë determinonte në zgjedhje 20- Lloj peshku liqeni me pika të kuqe në trup 21- tip automjeti francez 22- Aktorja amerikane me origjinë greke Irene ... 24- Çardak apo ... siç i thonë shkodranët 25- Tufë kafshësh 27- Lloj vaji për motorët që del nga kullimi naftës 28- ... virusi që po bën kërdinë 29- Faith, këngëtare dhe aktore amerikane 30- Krijim letrar ironizues 31- Janë 114 kapitujt e Kuranit 32- Zotëroj 33- Ato banojnë në manastire 36- Aktori i Hollywood Kabir ... 38- Është lëng frutash 40- I plotfuqishëm i një vilajeti në kohën e sulltanit 41- Një shtet në Lindjen e Mesme gjiton me Jordanin 44-"Mbreti" i Shekspir 45- Patrioti ... Pjetër Gega.

HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI

Dashi
21 mars - 20 prill
Vërtet do ëndërroni shu më sot, por ama nuk do i shkëpusni asnjë moment këmbët nga realiteti prandaj nuk do ju ndodhin probleme.

Demi
21 prill - 21 maj
Sot do jeni të gatshëm të bëni çdo gjë që dëshironi, dhe madje për të arritur majat të përbaleni me këdo.

Binjakët
22 maj - 21 qershor
Në punë do keni goxha energji, por duhet të reflektoni dhe të gjeni mënyrën e duhur si t'ia dilni mbanë.

Gaforrja
22 qershor - 22 korrik
Gjatë kësaj dite mëngjesi do jetë pak i turbullt dhe shumë mendime do ju qarkullojnë në mendje.

Luani
23 korrik - 22 gusht
Në punë nuk duhet të nxitoheni shumë, sepse në fakt gjërat do ju ecin më së miri dhe kolegët kanë besim tek ju.

Virgjëresha
22 gusht - 22 shtator
Në punë Dielli do ju bëjë më të matur dhe më këmbëngulës. Nëse keni vënë disa objektiva sot do i arrini.

HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI

Peshorja
23 shtator - 22 tetor
Duhet të reflektoni shumë gjatë kësaj dite para se të hidhni hapa, sepse nesër pasojat mund të jenë të rënda.

Akrepi
23 tetor - 21 nëntor
Gjatë kësaj dite do ndiheni më të lirë dhe më në humor. Edhe rrugët e zëna më në fund do lirohen.

Shigjetari
22 nëntor - 21 dhjetor
Gjatë kësaj dite do dini si të "luani" dhe do dilni përherë të fituar. Keni mësuar nga gabimet dhe nuk doni t'i përsërisni më ato.

Bricjapi
22 dhjetor - 21 janar
Në punë do e shprehni hapur pakënaqësinë me ato që do arrini dhe mundet të konfliktoheni me kolegët.

Ujori
22 janar - 19 shkurt
Në punë vërtet do e keni të vështirë të përmbyllni disa kontrata, por do ecni goxha përpara me projektet që keni nisur.

Peshqit
20 shkurt - 20 mars
Besoni më shumë tek vetja. Këtë kohë me maturi dhe këmbëngulje patjetër që do arrini atë që ju doni.

Anglia përmbys Sllovakinë në minutën e fundit dhe kualifikohet pas 120 minutash, Spanja "vallëzon" me Gjeorgjinë e kap çerekfinalen

Anglia barazoi në kohën e rregullt 1-1, por shënoi në shtesë dhe u kualifikua përballë Sllovakisë, kurse Spanja mundi thellë 4-1 "hirushen" e Europianit, Gjeorgjinë

Adriatik BALLA

Ditën e djeshme u luajtën dy ndeshje emocionuese në raundin e 1/8 të finales së Kampionatit Europian të Gjermanisë, ku Anglia u kualifikua me shumë vuajtje pas 120 minutash, ndërsa Spanja përmbysi Gjeorgjinë edhe pse u gjend në disavantazh. Momente të bukura por që tregojnë se Anglia ende nuk është ngjitur në lartësinë e kualitetit të saj, të përbërjes së yjeve që ka në grup. Në fakt, dje Anglia ishte një minutë larg mbylljes me turp të aventurës në Euro 2024, por në limitet e ndeshjes, britanikët barazuan ndeshjen ndaj Sllovakisë dhe në fund fituan pas kohës shtesë me rezultatin 2-1. Sllovakët kishin kaluar në avantazh prej minutës së 25 me anë të Ivan Shranz. "Tre Luanët", provuan gjithçka deri në minutën e 95 teksa u dalën më herët edhe nga shtylla



pas një goditje të Declan Rice. Mirëpo, u desh një roveshatë e Jude Bellingham që Anglia të mbetej pjesë e këtij Europiani duke e dërguar kështu ndeshjen në kohën shtesë. Të entuziazmuar në maksimum nga goli në fundin e lojës, britanikët shënuan menjëherë edhe golin e përmbysjes në fillimin e pjesës së parë të kohës shtesë. Harry Kane u gjend i lirë në zonë dhe me

gjithë kuadratin e portës në dispozicion, nuk mund të gabonte. Në pjesën e dytë shtesë, Anglia menaxhoi më së miri avantazhin dhe pavarësisht vuajtjes, ia doli të kualifikohej për në çerekfinale aty ku do të përballlet me Zvicrën. Sakaq, përfundon në 1/8-tat aventura e Sllovakisë në Euro 2024 që gjithsesi la shenjë sidomos pas kësaj sfide me Anglinë. Sa i takon

duelit mes Spanjës dhe Gjeorgjisë mund të thuhet se diferenca në fushë e spanjollëve ndaj rivalit të tyre ishte e madhe. Por, gjithsesi, spanjollët u gjendën shpejt në disavantazh, pasi në minutën e 18-të Normand dështoi të largonte topin dhe shënoi autogol. Ky gol bëri që Spanja të vuajë në organizim për shumë minuta. Gjithsesi, falë sulmeve të tërbuara të saj ia doli të barazojë brenda pjesës së parë, me anë të Rodrit në minutën e 39-të. Pjesa e parë mbyllet 1-1, por në pjesën e dytë Spanja do të shtonte ritmin e "vallëzimit" të saj në fushë. Gjen golin e dytë me anë të Fabian Ruiz në minutën e 51-të, e një të tretë me anë të Uilliams në minutën e 75-të, duke siguruar kualifikimin në 8-shen më të mirë. Por Spanja s'do të ndalej me kaq, pasi në një kundërzbritje në minutën e 83-të do të gjente golin e katërt me anë të Olmos. Kualifikim me meritë i saj në çerekfinale.

Fakti/ Gjermania shpërblehet, deri në finale 1 mln euro për lojtar


Shumë federata i mbulojnë me euro lojtarët e tyre nëse arrijnë të fitojnë titullin europian. Natyrisht më të motivuara në këtë drejtim janë federatat e vendeve të vogla, por nuk mbeten pas edhe organizatorët e Europianit. Kështu, secili nga 26 lojtarët e Gjermanisë do të marrin bonusin e 100 mijë eurove nga Federata e Futbollit të Gjermanisë. Marrëveshja ishte arritur para nisjes së Evropianit. "Sky Sport" i Gjermanisë ka shkruar

se secili lojtar do të marrë po ashtu nga 150 mijë euro nëse shkojnë deri në gjysmëfinale, 250 mijë euro nëse përfundojnë në vendin e dytë dhe nga 400 mijë euro nëse e fitojnë Kampionatin Evropian. Më pas, paratë e mbledhura do t'u jepen për bamirësi fondacioneve për të pastrehët. Duhet thënë se Gjermania, si pritëse e Europianit, ka pasur një valë të nxehtë të qarkullimit të parave nga fluksi i madh i tifozëve.



SULMUESI

Baloteli thumbon Italinë, hedh foton ku theu Gjermaninë 12 vjet më parë



Italia kthehet në shtëpi, duke dështuar në Europianin e Gjermanisë, e kjo ka nxitur me sa duket disa "ish"-ë të përfaqësueses axurre të tregojnë qëndrimin e tyre me foto që dëshmojnë një situatë tjetër, situatë kur Italia ishte fuqi e madhe e futbollit në Europë dhe në botë. Kështu, sulmuesi Mario Baloteli ka postuar golin ikonik të shënuar kundër Gjermanisë në

gjysmëfinale të "Euro 2012", afro 12 vjet më parë. Më 28 qershor ishte 12 vjetori i fitores së Italisë ndaj Gjermanisë në Varshavë të Polonisë. Baloteli i kishte shënuar të dy golat për italianët në fitoren 2:1. Ai kishte shënuar për 1:0 me kokë pas harkimit të Antonio Kasantos në minutën e 20-të, ndërsa në minutën e 36-të, kishte realizuar me gjuajtje shumë të fuqishme.

Pas golit të dytë, festa e Balotellit ishte e veçantë. Postimin në Instagram, Balotelli e bëri në ditën kur Italia u eliminua nga Zvicra, në një të tetën e finales së Evropianit 2024. Baloteli së fundmi ishte anëtar i skuadrës Adana Demirspor në Superligën e Turqisë. Nga dita e sotme ai do të jetë futbollist i lirë dhe në kërkim klubi.

NJOFTIM

Agjencia e Lajmeve



kërkon

- gazetarë webi dhe
- grafik dizajner

Kontaktoni në adresën:
gazetasot@yahoo.com
gazetasotnews@gmail.com

MERKATO

Daglas Luiz nga dje është pjesë e Juventusit

■ Më në fund është zyrtarë dhe Daglas Luiz është lojtari më i ri i Juventusit. Mesfushori brazilian pas shkëlqimit në Angli me fanellën e Aston Vilës i ngjitet Serie A, me fanellën e Zonjës së Vjetër. Për të arritur deri te Daglas Luiz, Juventusit është pajtuar të paguajë 50 mln euro te Aston Vila, me katër këste. Gjithashtu për Luiz do të paguhet edhe 1,5 mln euro të tjera në formë bonusesh. 26-vjeçari ka nënshkruar kontratë afatgjate me Juventusin



deri më 30 qershor 2029. Faqja e Joves e ka prezantuar lojtarin dhe i ka uruar mirëseardhje në "Allianz Stadium".

LËVIZJA

Zhao Feliks braktis Barcelonën, kthehet tek Atletiko

■ Përmes një njoftimi zyrtar, klubi i Barcelonës ka bërë me dije për mediat se Zhao Feliks nuk do të vazhdojë më me blaugranat. Klubi katalanas ka konfirmuar se lojtari portugez nuk do të jetë pjesë e klubi për sezonin e ardhshëm, pavarësisht huazimit 1-vjeçar. Feliks u zyrtarizua tek Barcelona në ditën e fundit të afatit kalimtar të verës më 2023. Gjatë periudhës së tij me blaugranët, Feliks ka zhvilluar 44 ndeshje në të gjitha



garat, ku ka shënuar 10 gola e ka kontribuar me 6 asistime. Nga sot, Feliks do të rikthehet tek klubi i tij, Atletiko Madrid.